



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. (shtyrë nga mbledhja e datës 02.10.2020).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:32.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 8. Përfaqësues të ILD-së.*
- 8. Përfaqësues të medias.*

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. (shtyrë nga mbledhja e datës 02.10.2020).

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Duke qenë se të gjithë anëtarët janë të pranishëm, po fillojmë mbledhjen e radhës të KLGJ, datë 14 tetor 2020.

Siç jeni në dijeni, në këtë rend dite janë 11 çështje, për të cilat kërkohet vendimmarrja e KLGJ-së dhe më konkretisht:

Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (shtyrë nga mbledhja e datës 02.10.2020).

Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës: “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}”; “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Shkodër”; “Për

komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z.{...}”; “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Korçë”;

Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës: “Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë”; “Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë”; “Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë”; “Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë”.

Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës: “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për katër pozicione të lira”

Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës: “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për dy pozicione të lira”.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së mbarimit të statusit të magistratit, për z. {...}”.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr. 5, datë 20.12.2018, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi caktimin me short të mandatit 3-vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtarë””.

Opinion “Mbi kandidatin, që ka aplikuar për t’u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor” (kandidate {...}).

Shqyrtimi i projektvendimeve për kualifikimin për në formimin fillestar në Shkollën e Magistraturës, për magistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2020-2021: për kandidatët, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 241, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën e Lartë, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimin nr. 85, nr.86 dhe 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Jemi dakord me rendin e ditës?

Po, zonja Kadi!

Brunilda Kadi: Atëherë, në lidhje me pikën 6 dhe 7 të rendit të ditës, kërkoj që të shtyhen shqyrtimi i tyre sepse materialet për këto dy pika të rendit të ditës na kanë ardhur vetëm dje pasdite dhe unë nuk kam mundur t'i trajtoj, t'i lexoj dhe të kem një ide të qartë për t'u shprehur në lidhje me këto dy pika.

Për pikën 9, 10 dhe 11, duke qenë se ato zhvillohen me dyer të mbyllura, sugjeroj që të shqyrtohen në fillim të rendit të ditës, për arsyet që i dimë të gjithë, që kanë lidhje me sigurimin e ambientit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, hedhim në votim propozimin e zonjës Kadi.

Brunilda Kadi: Ju lutem Kryetare, ndajini se janë dy të ndryshme: 6-7 për t'u shtyrë dhe 9, 10, 11 që të trajtohen të parat.

Naureda Llagami: Dakord. Fillojmë me propozimin e parë për shtyrjen e pikës 6 dhe 7.

Marçela Shehu: Kam përshtypjen që nuk mund ta hedhim në votim kërkesën për shtyrje, duke qenë se një nga anëtarët nuk ka pasur kohën e mjaftueshme për t'u njohur. Kështu që, edhe nga praktika që kemi pasur deri tani, nuk kemi shkuar në vendim, për sa kohë anëtari thotë që s'jam gati.

Naureda Llagami: Jo! –ne kemi edhe praktikë që kemi kaluar në vendim dhe e kemi marrë po me votim.

Marçela Shehu: Jo, jo! – nuk kemi disponuar me vendim për të vendosur a është njohur apo jo anëtari. Këtë po them.

Naureda Llagami: Po pra, edhe kur kemi pasur pretendime që anëtari ka qenë i panjohur e kemi kaluar në votim dhe e kemi marrë në shqyrtim.

Marçela Shehu: Hera e fundit që ka ndodhur, me sa e mbaj mend, është kërkuar nga ana ime lidhur me diçka që lidhet me buxhetin, për të cilin unë kërkoja kohë sepse nuk isha njohur dhe s'kisha pasur kohë të mjaftueshme, dhe në mbledhje është diskutuar nga anëtarët dhe kemi arritur në këtë përfundim, që për sa kohë anëtari thotë që dua kohë, atëherë nuk ia vlen që të marrim një vendim.

Brunilda Kadi: Kërkoj fjalën, për të sqaruar edhe për efekt të procesverbalit. Materialet kanë ardhur dje pasdite dhe sipas ligjit, që e njohim të gjithë, materialet duhet të vijnë të paktën 7 ditë përpara. Pjesën tjetër unë arrita ta lexoj. Këto të dyja, janë edhe të reja dhe kanë material voluminoz, nuk arrita dot. Pra në radhë të parë unë kërkesën e bëj në bazë të ligjit dhe pastaj edhe faktin, se kur kam mundur t'i lexoj, nuk kam kërkuar shtyrje.

Naureda Llagami: Më lejoni t'ju kujtoj që materiali 6 ka më shumë se 10 ditë që është në e-mail-et tona, të cilin e ka përcjellë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Ndërkohë që materiali 7 dhe dy-tre materiale të tjerë janë çuar dje me rendin e ditës, me idenë që i kemi diskutuar.

Brunilda Kadi: Ligji thotë për rendin e ditës, jo kur dërgohen materialet, se ne dërgojmë gjithë kohës materiale. Por që unë të përgatitem për rendin e ditës, materiali duhet të më sqarohet që është për këtë rend dite. Kështu që, ju sugjeroj ta lexoni edhe një herë dispozitën.

Naureda Llagami: Atëherë, në qoftë se është ky qëndrim që thoni që për rendin e ditës duhet që t'i përgatitim 7 ditë përpara, atëherë të gjithë çështjet që janë sot në rend dite do shtyhen në seancën tjetër sepse asnjëra nuk është bërë përpara.

Brunilda Kadi: Unë nuk kërkoja të shtyhen të tjerat, kërkoja për këto të dyja që jam e papërgatitur dhe kjo për arsye objektive dhe e sqarova. Për të tjerat, kush të kërkojë shtyrje, le të kërkojë.

Naureda Llagami: Atëherë, fole për pjesën e ligjit dhe unë po të kujtoj ligjin. Për sa i përket përmbajtjes së materialeve, materialet i kemi të gjithë në e-mail dhe janë punuar nga komisionet përkatëse dhe ju janë kaluar me e-mail. Materiali i pikës 6, me dijeninë time ka më shumë se 1 javë në e-mail-et përkatëse. Nëse ngre diskutimin që rendi është bërë vonë dhe i kemi përfshirë vonë në rendin e ditës, jam plotësisht dakord, rendi i ditës shtyhet dhe kalojmë vetëm me zhvillimin e seancës dëgjimore.

Brunilda Kadi: Atëherë, në lidhje me faktin, drejtori juridik dje ka nisur dy e-maile dhe ka thënë “ndjesë se nuk ka ardhur akoma” dhe materiali voluminoz që është vendimi i KPA-së në lidhje me zotën {...} është nisur madje më vonë sesa rendi i ditës

dhe ky nuk ka qenë as edhe në materialet e mëparshme, edhe sikur ta arsyetojmë në variantin që thatë juve.

Naureda Llagami: Dakord pra, në të njëjtën frymë jam edhe unë, që them që edhe zonja {...} nuk ka qenë tek materialet.

Kalojmë në votim, se mund të kemi qëndrime të ndryshme për sa i përket interpretimit të ligjit, kështu që unë propozoj që të kalojmë në votim lidhur me kërkesën e parë që bëri zonja Kadi.

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Në lidhje me kohën që kërkon për t'u njohur, ne kemi mbajtur qëndrim, kështu që unë votoj pro. Pastaj, nëse konkretisht ky material është shpërndarë në kohën.. nuk e di, nuk jam në dijeni.

Marçela Shehu: Jam dakord për sa kohë një nga anëtarët, zonja Kadi, thotë që nuk është njohur dhe nuk ka pasur kohën e mjaftueshme për t'u përgatitur.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Unë jam pro sepse vet kam mbajtur qëndrimin që nëse një anëtar pretendon që nuk ka informacion lidhur me një pikë të rendit të ditës dhe nuk ka studiuar materialet, duhet të shtyhet sepse ndryshe ai nuk voton dot.

Medi Bici: Edhe unë jam pro sepse anëtarja është në pamundësi objektive për të votuar.

Naureda Llagami: Atëherë, dy materialet 6 dhe 7 do kalojnë tek mbledhja e ditës së hënë.

Brunilda Kadi: Kryetare, më fal! - t'ju kujtoj, se nuk votuat.

Naureda Llagami: Unë jam kundër.

Kalojmë më pas tek propozimi i dytë që materialet 9, 10, 11 të zhvillohen përpara seancës dëgjimore.

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Pro.

Fatmira Luli: Para seancës dëgjimore të procedimit?

Këto janë materiale të shkurtra që s'i prishin punë askujt. Le të zhvillohen të parat dhe jam dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Kundër.

Propozimi nuk u miratua.

Naureda Llagami: Vazhdojmë me hapjen e seancës dëgjimore.

Të ftohen palët.

(Hyjnë në sallën e mbledhjes magistrati, z. {...} bashkë me avokaten znj. Marçela {...}, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani dhe Këshilltari pranë Kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Periand Teta.)

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Kjo seancë dëgjimore, siç e dini, vijon nga mbledhja plenare e datës 2 tetor 2020, në të cilën gjyqtari nën procedim, zoti {...}, kërkoi kohë për të përgatitur mbrojtjen efektive të tij. Këshilli, pasi shqyrtoi kërkesën e parashtruar nga gjyqtari, vendosi pranimin e saj duke shtyrë seancën për ditën e sotme.

Atëherë, paraprakisht verifikojmë prezencën. Nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është paraqitur vet zoti Artur Metani, Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Artur Metani: Dhe zoti Periand Teta, Këshilltar pranë Kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Naureda Llagami: Nga ana e gjyqtarit nën procedim është paraqitur vet subjekti, zoti {...}, i cili ka kërkuar që të asistohet në këtë procedurë nga avokati, znj. Marçela {...} (e cila ka licencë avokati me nr. 5902, lëshuar nga Dhoma e Avokatisë ën Korçë).

Çelim seancën dëgjimore.

Siç jeni në dijeni, në seancën e parë kemi ezauruar fazën e kërkesave paraprake, kështu që pa humbur kohë kalojmë në fazën e dytë që ka të bëjë me deklarinimin e hapur të shqyrtimit të procedimit disiplinor. Për më tej, ashtu siç e parashikon edhe ligji dhe rregullorja fillojmë me parashtrimet e palëve, duke filluar me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, ku i kujtoj që duhet të bëjë një parashtrim të shkurtër të argumentave, duke qenë se i ka parashtruar në raportin e tij hetimor dhe më pas do vazhdohet me subjektin. Për ju fjala zoti Metani!

Artur Metani: Faleminderit, Kryetare!

Unë i kam përgatitur parashtrësirat dhe i kam depozituar edhe me shkrim, por në mënyrë të përmbledhur për të respektuar parashikimin ligjor por edhe për të mos e bërë seancën e lodhshme, do parashtroj si më poshtë:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 313/7 prot., datë 02.04.2020 ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, për shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 102 pika 2 shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Në kuadër të hetimit disiplinor, rezulton se magjistrati {...} ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Magjistrati, subjekt i hetimi disiplinor, në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në kuadër të ushtrimit të detyrës me vendimin nr. 1/54 DA, datë 14.02.2019 ka vendosur: Pranimin e kërkesës së të dënuarit {...}, i datëlindjes 14.05.1974. me objekt: “Lirim me kusht”; Lirimin me kusht të të dënuarit {...} i datëlindjes 14.05.1974 për pjesën e mbetur pa vuajtur të dënimit me burgim të përjetshëm

të caktuar në mbështetje të Vendimit nr. 14, datë, 10.03.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke u vendosur në provë kërkuesi për gjithë jetën;

Urdhërohet i dënuari {...} që gjatë kohës së provës, të raportojë rregullisht para Shërbimit të Provës, Zyra vendore Tiranë, sipas rregullave që do iniciohen për këtë qellim procesi nga ky shërbim ligjor, si dhe të marrë në çdo rast lejen e këtij shërbimi për lëvizjet e shpeshta brenda ose jashtë vendit, së bashku me detyrimin për të informuar Shërbimin e Provës për çdo ndryshim të mundshëm të vendit të banimit apo vendqëndrimit, që duhet të realizohet vetëm mbi lejinin e këtij shërbimi;

Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të dënuarit {...}, i datëlindjes 14.05.1974, nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Drenovë – Korçë, vetëm nëse ndaj këtij shtetasi nuk ekzistojnë arsye ligjore që nuk mundësojnë ekzekutimin e këtij urdhri:

Në zbatim të nenit 60, pika 9 e Kodit Penal, i liruarit me kusht {...} i datëlindjes 14.05.1974, detyrohet që gjatë kohës së provës të mos shoqërohet me persona të dënuar dhe/ose bashkëpunëtorët e veprave penale për të cilat është dënuar.

Në zbatim të nenit 60, pika 10 e Kodit Penal, i liruarit me kusht {...} i datëlindjes 14.05.1974, detyrohet që gjatë kohës së provës të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë të çdo lloji, referuar këtij përcaktimi në Ligjin 74/2014 “Për armët”, i ndryshuar.

Vendimi 41-2019 - (1/54 DA), datë 14.02.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është ndryshuar me vendimin Nr. 79, datë 26.06.2019, të Gjykatës së Apelit Korçë dhe është vendosur: “Rrëzimi i kërkesës së kërkuesit {...} për lirim me kusht”.

Rezulton e provuar se nga ana magjistratit nuk janë mbajtur në konsideratë parashikimet e nenit 3, 64, 65 të Kodit Penal, nenit 152, 380, 383/1 /ç të Kodit të Procedurës Penale, nenit 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, si dhe parashikimet e vendimeve Nr. 4/2003, Nr. 2/2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në kundërshtim me parashikimet e nenit 3 dhe 65/3 të Kodit Penal, si dhe Vendimit Unifikues Nr. 4, datë 27.03.2003, të Kolegjeve të Bashkuara, nga ana e magjistratit, nuk është mbajtur në konsideratë plotësimi i kërkesës ligjore me natyrë objektive si koha e nevojshme e kaluar në vuajtje të dënimit me burgim prej 35 vite parashikuar nga nenit 65/3 i Kodit Penal, si dhe janë zbatuar gabim dispozitat të cilat lidhen me aplikimin e ligjin penal në kohë parashikuar nga neni 3 i Kodit Penal.

Magjistrati subjekt i hetimit disiplinor ka qenë kontradiktor në referimin e ligjit të zbatueshëm atë të kohës të kryerjes së veprave penale, fakt ky i konstatuar edhe nga Gjykata e Apelit Korçë gjatë kontrollit gjyqësor. Nga kontrolli gjyqësor i ushtruar nga gjykata më e lartë, është konstatuar se gjyqtari nuk ka qenë konsekuent për t'iu referuar ligjit të zbatueshëm atë të kohës së kryerjes së veprës penale, ka aplikuar dispozita favorizuese në lidhje me përmbushjen e afatit kohor për lirimin me kusht (25 vite), ndërsa për kriterin ndalues (nenit 78/a të K.Penal), ka zbatuar ligjin penal të kohës kur është paraqitur dhe shqyrtuar kërkesa.

Në kundërshtim me parashikimet e nenit 64/3 të Kodit Penal nga ana e magjistratit {...} nuk është mbajtur në konsideratë kriteri ndalues me natyrë objektive që nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje.

Së treti, në kundërshtim me parashikimet e nenit 64 dhe 65 të Kodit Penal, si dhe Vendimit Unifikues Nr. 2, datë 25.05.2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nga ana e magjistratit nuk janë zbatuar kërkesat mbi plotësimin e kritereve ligjore me natyrë subjektive, siç janë “arsyet e veçanta” apo “rastet e jashtëzakonshme”.

Në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, nuk evidentohen zhvillime të aktiviteteve trajnuese, nuk ka pasur programe rehabilitimi për të dënuarin në lidhje me kërkesat e ligjit nr. 8328/1998, duke u gjetur ky aspekt ligjor plotësisht i paezauruar me mosrespektim thelbësor të këtij ligji, si dhe në asnjë rast nuk është pasqyruar vlerësimi i sjelljes si “shembullore”, sipas kërkesave të nenit 65/3 të Kodit Penal.

Arsyetimi i bërë nga ana e magjistratit nuk është bërë në përputhje me provat e administruara në gjykim dhe në përputhje me faktet dhe rrethanat që janë provuar gjatë procesit gjyqësor.

Faktet dhe rrethanat janë parashtruar dukshëm në mënyra të shtrembëruar dhe vetëm për t'iu përshtatur plotësimi të kërkesave formale (me natyrë objektive) si dhe atyre me natyrë subjektive të nenit 64 dhe 65 të Kodit Penal.

Nga ana e magjistratit nuk është mbajtur në konsideratë krahas jurisprudencës së Gjykatës së Lartë në lidhje me këtë institut të së drejtës penale edhe vetë praktika e tij e ndjekur gjatë trajtimit të kërkesave me objekt “Lirim me kusht”.

Këto veprime/mosveprime të tij janë kryer në mënyrë drejtpërdrejtë, të vazhduar, të vullnetshme dhe të pajustificuar brenda të njëjtit proces, duke arritur në përfundimin se janë kryer me dashje direkte nga ana e tij.

Duke marrë në konsideratë natyrën e shkeljes disiplinore dhe rrethanat e shkeljes së kryer të cilat kanë të bëjnë me mosrespektim të rëndë dhe të vazhduar të legjislacionit material dhe procedural penal; pasojat e shkeljes disiplinore lidhur me lirimin e një të dënuari të rrezikshëm i cili përbën rrezik për komunitetin dhe shoqërinë në kundërshtim me parashikimet legjislacionit material dhe procedural penal; cenimin e imazhit të sistemit gjyqësor dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë; ekzistencën e rrezikut të shkaktuar nga shkelja disiplinore pasi sjellja e papërshtatshme nuk shtrihet vetëm tek magjistrati subjekt hetimi disiplinor, por rrezikon të ndiqet si shnegull edhe nga magjistratë të tjerë, si dhe krijon terren për sjellje të papërshtatshme në raste të tjera të ngjashme.

Duke pasur parasysh dhe në konsideratë sa më sipër, arrihet në konkluzionin veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit {...} përbejnë shkelje shumë të rënda disiplinore.

Në rastin konkret, në analizë të veprimeve apo mosveprimeve të gjyqtarit {...} rezulton se në bazë të rrethanave të kryerjes së detyrës, momenti subjektiv, si dhe pasojat e shkeljes disiplinore përbëjnë akte që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe për rrjedhojë e bëjnë atë të papërshtatshëm apo të padenjë për të vazhduar funksionin e tij si magjistrat.

Duke mbajtur në konsideratë faktin se masa disiplinore është e varur nga ekzistenca e përgjegjësisë disiplinore të magjistratit, në përputhje me parimin e ligjshmërisë, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e parashikuar nga ligji dhe e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit: duke u bazuar në kriteret objektive lidhur me rëndësinë e shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore: individualizmit dhe proporcionalitetit, pra që ndaj magjistratit të jepet ajo masë që është e domosdoshme dhe e dobishme për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij, në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer, vlerësohet se për veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit {...} që parashikohen si shkelje disiplinore nga neni 101, pika 1, shkronja “b” dhe neni 102, pika 2, shkronjat “a” dhe “b” të Ligjit nr. 96/2016 “Për

statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, që përbejnë "Shkelje shumë e rënde disiplinore" dhe që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, duhet të jepet masa disiplinore "Shkarkim nga detyra".

Për sa më sipër, kërkoj nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të administrojë provat e paraqitura nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në këtë procedim disiplinor dhe në mbështetje të nenit 105, pika 1, shkronja "dh"; nenit 111, pika 1; dhe nenit 146, pika 2, shkronja "a", të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të vendosë: "Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 102, pika 2, shkronjat "a" dhe "b", të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe caktimin ndaj tij të masës disiplinore "Shkarkim nga detyra".

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Metani!

Atëherë, fjalën po ia jap subjektit, z. {...} për të parashtruar pretendimet e tij.

{...}: Faleminderit!

E nderuar kryetare, Të nderuar anëtarë.

Pasi dëgjova parashtrimin e ILD-së me vështirësi evidentoj se fillimi i procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, konsiston në këto drejtime:

Nga ana e magjistratit janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat lidhen me: mosrespektimin e rëndë ose të përsëritur të legjislacionit procedural dhe material; zbatim të gabuar të legjislacionit procedural dhe material, si ato të konstatuara nga një gjykatë më e lartë si dhe parashtrim i shtrembëruar i fakteve dhe rrethanave në mënyrë të dukshme nga aktet e nxjerra.

Në mënyrë më specifike ILD ka konkluduar se: "Rezulton e provuar se nga ana e magjistratit nuk janë mbajtur në konsideratë: Parashikimet e nenit 3, 64, 65 të Kodit Penal; Nenet 152, 380, 383/1 të Kodit të Procedurës Penale; Nenet 9, 10 dhe 11 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të

paraburgosurve”, i ndryshuar, si dhe; Parashikimet e Vendimeve nr.4/2003, nr.2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Sipas ILD-së është marrë në analizë Vendimi nr.79, datë 26.06.2019 i Gjykatës së Apelit Korçë, vendim i administruar kryesisht nga ILD-ja, i cili ka ndryshuar Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke vendosur: Rrëzimin e kërkesës për lirim me kusht të paraqitur nga i dënuari, me cilësinë e kërkuarit në këtë gjykim.

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për sa u përket qëndrimi i ILD-së, me shumë keqardhje konstatoj se ndodhem para një procedimi disiplinor pa shkak të ligjshëm, që prej momentit kohor të fillimit të hetimit disiplinor. Kjo paligjshmëri referon në mungesën e shkaqeve dhe arsyeve referuese, faktike, ligjore, zbatuese, interpretative, ilustruese, krahasimore, etj., mbi rrethanat objekt procedimi disiplinor.

Veprimtaria e ILD-së në këto drejtime, për sa kundërshtoj në kuadër të mbrojtjes, paraqitet plotësisht me vlerësime jo ligjore, në disa raste tej kompetencës që ligja e kufizon në hetim dhe vlerësim, paraqitet si veprimtari tërësisht e njëanshme dhe e përmbushur vetëm formalisht, tej realitetit objektiv procedural dhe material në çështjen objekt procedimi disiplinor, si dhe pa asnjë pikë, apo këndvështrim lidhës, midis mënyrës së përmbushjes së detyrave funksionale të gjykatës dhe argumentit që kjo gjykatë ka parashtruar, analizuar, argumentuar dhe konkluduar në zgjidhje të rastit kërkimor.

Ne konkretizim të mbrojtjes sime si magjistrat nën procedim disiplinor, fillimisht parashtroj për ju si Këshill i Lartë Gjyqësor një situatë të shkurtër dhe parimore mbi rrethanat procedurale, vlerësuese dhe konkluduese të procesit gjyqësor me objekt “Lirim me kusht”, dhe në vijim, disa rrethana post-procesit gjyqësor të përfunduar në shkallë të parë të gjykimit, të cilat janë thelbësore dhe duhej të ishin hetuar dhe mbajtur parasysh nga ana e ILD-së në zgjidhjen e rastit objekt procedimi disiplinor, por që jo çuditërisht për mua si magjistrat janë shmangur dhe nuk behën prezente për këtë Këshill, në drejtim të objektivitetit në trajtim të këtij rasti dhe në drejtim të provueshmërisë së procesit hetimor disiplinor dhe vet ky proces disiplinor në shqyrtim paraqitet i metë, me qëllime të paracaktuara jo ligjore, në drejtim të procesit të rregullt ligjor, dhe me një tendencë të hapur specifike negative në trajtim të rastit për arsye tashmë jo dhe aq të panjohura.

Qëllimi im si magjistrat dhe pritshmëria nga kjo, si do evidentohet, lidhet me detyrimin që kam në këtë procedim disiplinor, që t'i mundësoj anëtarëve të këtij Këshilli të nderuar të kuptojnë në mënyrë të shpejtë faktike dhe konkrete që në fillim të shqyrtimit të këtij procedimi disiplinor se, çështja paraqet problematikë thelbësore në drejtim të trajtimit të saj nga ana e ILD-së dhe cilësimit të magjistratit si në shkelje të ligjit pa ligj.

Lirimi me kusht - rezulton ligjërisht dhe proceduralisht se, inicohet nga i dënuari, duke paraqitur kërkesën për shqyrtim para gjykatës kompetente, referuar sanksionit të nenit 477 të K.Pr. Penale.

Mbështetur në kërkesat e nenit 31/6, paragrafi i dyte, të Ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar me Ligjin nr. 10 024, datë 27.11.2008 edhe ky i ndryshuar së fundmi, sanksionohet se: Pas paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht, drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale paraqet në gjykatë një kopje të dosjes personale të personit të dënuar dhe një raport për të. në raport përcaktohen natyra e veprës penale të kryer, qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, ndonjë vepër e mëparshme penale, e kryer prej tij, gjendja fizike dhe psikologjike e personit të dënuar, si dhe dinamika e sjelljes së tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Ne këtë proces, gjykata merr në mënyrë të detyrueshme edhe mendimin e institucionit të Shërbimit të Provës, mbi rrethanat që kanë të bëjnë kryesisht me mundësinë dhe kushtet e rinteprimit të të dënuarit në jetën e lirë, në rast se pranohet kërkesa e të dënuarit për lirim me kusht, proces ky që realizohet nëpërmjet përpilimit të një Raporti të posaçëm nga ana e këtij shërbimi.

Cilësia në përmbajtje e të dy Raporteve respektive, në rastin kur ata paraqiten pozitive për të dënuarin, dikton parimisht dhe praktikisht, drejtpërsëdrejti në vendimmarrjen e gjykatës.

Për sa keni të faktuar, nga aktet e këtij procedimi disiplinor, gjykata ka administruar Raportin e Drejtorit të I.E.V.P Drenove Korçë, i cili mban nr.339/1 prot, datë 04.02.2019, me konkluzionin drejtuar gjykatës së çështjes, si: “ ... nisur nga sjellja e të dënuarit me përfaqësuesit e kësaj I.E.V.P-je, të dënuarit e tjerë, pjesëmarrja në aktivitete, edukimi i tij, marrëdhëniet me familjen, projektet e paraqitura prej tij për të ardhmen e tij jetësore në raport me kohën e vuajtjes së dënimit, i është arritur qëllimit të

rehabilitimit të tij, pra se gjatë kohës së vuajtjes së dënimit ky i dënuar ka shprehur në mënyrë të qartë rehabilitimin dhe ka arritur riintegrimin e tij.”

Gjithashtu, keni të faktuar nga aktet e këtij procedimi disiplinor se, gjykata ka administruar edhe Raportin e vlerësimit të të dënuarit, përpiluar nga Zyra vendore e shërbimit të provës Korçë, me nr.573/3 prot., datë 29.10.2018, i cili relatton për të dënuarin se “...perspektiva e riintegritit të tij në shoqëri është e mundshme”.

Natyrisht, përmbajtja konkluduese e të dy Raporteve është mbajtur parasysh nga gjykata në zgjidhjen e çështjes sipas përcaktimeve specifike investiguese mbi këto konkludime vlerësuese dhe çmuese në pjesën arsyetuese të vendimit.

Pas dhënies së vendimit nga gjykata e faktit, proces i shortuar dhe gjykuar nga ana ime si magjistrat, në faqen 28 deri 31 të volumit të provave të paraqitura për këtë Këshill, do të gjeni një informacion për referimin e veprës penale të prokurori, të datës 17 shkurt 2019, iniciuar dhe përpiluar nga Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, Tiranë, strukturë kjo në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

Sipas këtij akti, rezulton se kjo strukturë në datën 15.02.2019 ka marrë informacion se i dënuari me burgim të përjetshëm respektiv, është liruar me kusht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, si rezultat i një vlerësimi shembullor të tij të dhënë e vlerësuar nga I.E.V.P Korçë.

Nga verifikimi i kësaj praktike, si përshkruhet në përmbajtje të këtij akti, ku janë këqyrrur për sa relatohet i gjithë dokumentacioni që dispononte institucioni penitenciar për këtë të dënuar, relatohet se është verifikuar se: Sjellja e të dënuarit sipas vlerësimeve të Komisionit përkatës të I.E.V.P-së Korçë dhe I.E.V.P-ve të tjera dhe është vlerësuar thjesht “korrekte”; Nuk figuron në dosje asnjë dokumentacion i administruar që të konfirmojë se i dënuari ka mbaruar arsimin e lartë në degën respektive, përveç deklarimeve të vetë të dënuarit; Në dosje nuk figuron asnjë projekt i paraqitur nga i dënuari që të konfirmojë përshtypjet e lëna gjatë komunikimeve me këtë të dënuar, gjatë të cilave të këtë prezantuar projekte e qoftë edhe ëndrra për jetën; Konkluzioni se i dënuari është rehabilituar dhe integruar nuk ka as edhe një bazë, pasi si relatohet, nuk figuron që i dënduri të këtë qenë pjesë e planeve të përgatitjes për lirim, sipas V.K.M-së nr.437, datë 20.05.2015, neni 63, si dhe nuk është trajtuar ndonjëherë me leje shpërblyese, gjatë së cilës të jetë vënë në provë për të pasur të dhëna për komponentin e

integritit, për shkak se vuajtja e dënimit të tij është në nivelin e sigurisë së lartë. Aktivitetet që ofrohen për këtë kategori janë të kufizuara (gjykata e apelit përveçse ometon këtë paragraf në vendimin e saj, ka shmangur plotësisht konstatimin në vijim... Dua të tërheq vëmendjen e Këshillit, të çdo anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që në vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit, të gjitha sa lexova janë cituar, ndërkohë që akti burimor nuk ndodhet i administruar në procesin gjyqësor që ka shqyrtuar Gjykata e Apelit ... Edhe një herë, ka shmangur plotësisht konstatimin në vijim duke argumentuar të kundërtën e tij), çka domethënë se integriti i tyre është një proces më i gjatë e kërkon më shumë detaje për t'u demonstruar: Nuk rezulton se ky i dënuar të jetë përfshirë në programe të formimit profesional apo të punësimit, të cilat ofrohen tregues, ky i një motivimi të ulet për t'u integruar...; etj.

Konkludohet nga Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, Tiranë se: “Ky raport në procesin gjyqësor me objekt lirim me kusht ka një karakter determinant për gjykatën për pranimin ose jo të kërkesës, pasqyrimi i situatës sa më konkrete dhe reale dhe objektive në vlerësimin e sjelljeve dhe ky raport ndikon në krijimin e bindjes së gjykatës në dhënien e vendimit për lirim me kusht”.

Duke iu referuar ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, nenit 36/1 të tij, relatohet se kompetencat e drejtorit të institucionit janë të përcaktuara për përpilimin e Raportit për Lirim me kusht, duke konkluduar se: Drejtori i institucionit penitenciar paraqitet me tejkalim të kompetencave të tij, pasi është shprehur për rrethana, që sipas qëndrimit të Drejtorisë të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, i takojnë për vlerësim Institucionit të Shërbimit të Provës.

Ne përfundim kjo drejtori, ka konkluduar se nga ana e drejtuesve dhe punonjësve të I.E.V.P

Korçë, janë konstatuar elementë të veprës penale si në aspektin objektiv dhe subjektiv me pasoja konkrete, duke shkaktuar kështu mosfunksionimin e rregullt të aparatit shtetëror dhe strukturave ligjzbatuese.

Veprat penale të referuara në këtë rast “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, dhe vepra penale e “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, paragrafi i tretë i Kodit Penal, drejtuar të kallëzuarit, drejtorit të I.E.V.P-së Korçë.

Ndërsa në ngarkim të katër shtetasve, punonjës të këtij institucioni është referuar vepra penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Vendos nën vërejtjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, se tërësia e këtyre shkeljeve të pretenduara dhe të denoncuara, janë pjesë përbërëse e shkeljeve që më atribuohen si magjistrat në kuadër të këtij procedimi disiplinor nga ana e ILD-së, për sa i përket ekzistencës ose jo të faktit dhe trajtimit të tij në mënyrë fiktive apo të shtrembëruar qëllimisht.

Çështja është regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe, në përfundim të procesit hetimor rezulton se kjo prokurori ka kërkuar në gjykatë pushimin e procedimit penal, për shkakun se fakti nuk parashikohet si vepër penale, referuar sanksionit të nenit 328, pika 1, germa “b” të K.Pr.Penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, në mbështetje të Vendimit nr.41-2019-4032 (763 sp). datë vendimi 19.11.2019, të cilin e gjeni të administruar në faqet 16 deri 27 të volumit të provave, pas kthimit të çështjes gjyqësore për rigjykim, për sa rezulton për arsye procedurale, ka pranuar kërkesën e prokurorit, duke vendosur: Pushimin e procedimit penal, për shkakun se fakti i kallëzuar nuk përben vepër penale në veprimtarinë e Drejtorit të Institucionit penitenciar, si dhe të punonjësve të këtij institucioni. Kjo vendimmarrje paraqitet e formës së prerë.

Si magjistrat, mbaj qëndrimin se shkeljet që më drejtohen në kuadër të këtij procedimi disiplinor, nuk janë vërtetuar si të tilla nga Prokurori dhe as nga gjykata, të cilët kanë konkluduar se faktet e denoncuara nuk parashikohen nga ligji si vepër penale, duke u vërtetuar për këtë përcaktim ekzistenca e tyre dhe asnjë paligjshmëri të procesit të çmuarjes së tyre nga ana e Institucionit penitenciar për mënyrën se si këto akte i janë relatuar gjykatës.

Vlerësoj se ndodhemi para situatës së list-pendencës, ku shkeljet e pretenduara, si dhe në këtë procedim disiplinor, nuk mund të rivlerësohen më tej për të kundërtën e tyre, mbështetur në parimin se çështjet e zgjidhura nga gjykata, nuk mund të jenë të diskutueshme nga asnjë organ tjetër administrativ. Gjithsesi, kjo situatë mbetet për t’u vlerësuar nga ky Këshill i nderuar.

Për sa rezulton në përmbajtje të Vendimit nr.41-2019-2924 (961), datë vendimi 06.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, të cilin e gjeni të administruar në faqet

124 deri 131 të volumit të provave, përfaqësuesi procedural i Institucionit penitenciar në çështjen objekt procedimi disiplinor të magjistratit i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin nr.2460/2, datë 27.03.2019 “Për lirim nga detyra të punonjësit civil” të nxjerrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve sipas të cilit shkak i ndërprerjes së marrëdhënies së punës rezultoi “Për shkelje të theksuar në kryerjen e detyrës funksionale”.

Kjo veprimtari e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve rezultoi se është kontestuar nga ky përfaqësues procedural në gjykatë, duke kërkuar shpërblimet dhe dëmshpërblimet përkatëse, që rrjedhin nga zgjidhja e kontratës së punës.

Me vendimmarrjen e sipërcituar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, ka pranuar pjesërisht kërkimet e ish-punëmarrësit, por duke detyruar Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve t'i paguajë paditësit dëmshpërblim tre paga mujore bruto për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës si dhe dëmshpërblimin prej 15 ditësh pagë mujore bruto, për mosrespektim të afatit të njoftimit, në raport me kohën e tij të punësimit në këtë Institucion penitenciar. Edhe ky vendim paraqitet i formës së prerë.

Në vijim, nuk ekziston asnjë informacion, që ndaj Institucionit të Shërbimit të Provës Korçë, të jetë iniciuar ndonjë kallëzim apo procedim administrativ, që të lidhet me vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale si të përshtatshme ose jo, si ligjore ose jo, në lidhje me sa ky shërbim ka relatuar dhe konkluduar pozitivisht për të dënuarin respektiv dhe në kuadër të kërkesës se tij për lirim me kusht.

Më e rëndësishmja, përfaqësuesi procedural i Prokurorisë në këtë gjykim çështje, rezultoi të këtë qenë pothuaj inekzistent, për çdo rrethanë të shqyrtimit gjyqësor që konfiguroni këtë proces gjyqësor. Gjykata për këtë aspekt, ka qenë e detyruar të bëjë pjesë të parashtrimit në vendim faktin se: “Nga ana e përfaqësuesit procedural të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë nuk është paraqitur asnjë opinion gjatë shqyrtimit gjyqësor të kërkesës penale, lidhur me këtë qëndrim të kërkuarit të dënuarit {...}. Vetëm në diskutimin përfundimtar të çështjes është artikuluar qëndrimi për rrëzimin e kërkesës me shkakun se i dënuari nuk ka përmbushur afatin 35 vjet të vuajtjes së dënimit, por pa dhënë asnjë arsye lidhur me këtë qëndrim dhe në mënyrë thelbësore në lidhje me kundërshtimin e argumentave të parashtruara nga i dënuari për këtë aspekt juridik në çështje”.

Nuk rezulton që kjo sjellje procedurale e përfaqësuesit të Prokurorisë dhe vetë Prokurorisë si pjesëmarrës procedural ligjor në gjykimin e kërkesës penale të jetë bërë pjesë e ndonjë vlerësimi, kontestimi, apo investigimi, për cilësinë e përmbushjes, apo mospërmbushjes të detyrave funksionale të këtij subjekti, si dhe rezulton prezent kjo e fundit, në raport me karakterin e procesit dhe rolin e tij në proces si përfaqësues i shtetit.

Për sa u parashtrua nga ana ime si magjistrat, me aktet zyrtare gjyqësore të specifikuara dhe tej këtij karakteri akti, provohet se nga gjithë pjesëmarrësit proceduralë, të cilët rezultojnë të angazhuar proceduralisht dhe ligjërish, palë në gjykim ose strukturë mbështetëse e tyre, administrativisht, apo si kërkesë e ligjës, në lidhje me procesin gjyqësor për lirim me kusht, shkak dhe objekt procedimi disiplinor ndaj meje si gjyqtar, që po shqyrtohet aktualisht nga ky Këshill, vetëm unë si person në detyrë, nga gjithë këto subjekte, paraqitem aktualisht në pozitën procedurale dhe faktike të “shkelësit të ligjit” nga ana e ILD-së, si dhe i reklamuar si “i vetmi person përgjegjës”, për çfarë pretendohet se ka ndodhur dhe si “shkaktari i vetëm” i çdo pasoje, që artikullohet nga ky Inspektorat.

Është pikërisht kjo rrethana që ndërmora për të ilustruar dhe për të bërë të qartë dhe provuar paraprakisht këtij Këshilli të nderuar, faktin se, nuk mund të këtë asnjë mundësi teorike dhe jo më praktike, që të jetë prezente situata në këtë procedim disiplinor, si kjo e parashtruar nga ILD kundrejt personit tim si magjistrat në këtë gjykim çështje konkrete, kjo pasi në raport me llojin e gjykimit dhe karakterin e tij zhvillimor procedural, të gjithë aktorët proceduralë, për sa kanë relatuar, provuar dhe mbështetur për gjykatën në këtë gjykim çështje, janë gjendur dhe vërtetuar me veprimtari ligjore, pa asnjë pasojë në respektimin e ligjit, ndërsa vetëm gjyqtari i çështjes, i cili gjykon çështjen në kuadër të një gjykate të caktuar me ligj, duke përpunuar dhe vlerësuar proceduralisht burimin dhe cilësinë e provës mbi këtë informacion të përcjellë nga palët në proces, në përmbushje të detyrave dhe funksionit të tyre procedural ligjor, gjendet nën procedim disiplinor për shkelje të ligjit.

Kjo nuk është dhe nuk mund të jetë normale, për parimet e shtetit ligjor dhe të një procesi të rregullt ligjor.

Në vijim, në kuadër të mbrojtjes, po zbërthej në mënyrë të detajuar shkakun dhe arsyen e këtij anomarliteti në qëndrim e konkluzion të ILD-së, për të ekspozuar me fakte dhe prova se ku paraqitet, apo ekspozohet problematika që u relatua.

Po i qëndroj radhës së parashtrimit të shkeljeve të reklamuar nga ILD.

ILD ka parashtruar për këtë Këshill të Lartë Gjyqësor se nga ana e Gjykatës së Apelit janë konstatuar këto shkelje: Magjistrati ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e nenit 64/3 të Kodit Penal, ku pavarësisht provave të administruara si dhe fakteve të provuara në këtë proces gjyqësor. (a) nuk është përmendur, si dhe (b) nuk është analizuar fakti se kërkuesi, i dënuari respektiv, është dënuar dy herë dhe se rezulton të jetë përsëritës për vepra penale të kryera me dashje.

Lidhur me këtë vlerësim të Gjykatës së Apelit, ILD ka konkluduar në përfundim të hetimit disiplinor dhe mbështet qëndrimin si shkak dhe arsye të këtij procedimi disiplinor ndaj meje si magjistrati se kërkuesi i lirimit me kusht, i dënuari respektiv rezulton përsëritës për krime të kryera me dashje, duke menduar apo vlerësuar se ka gjetur veprimtarinë gjyqësore të magjistratit, në kundërshtim me sanksionin e nenit 64, pika 3 të Kodit Penal.

Kjo pasi ky nen sanksionon si “nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarit përsëritës për krime të kryera me dashje...”, ndaj magjistrati ka shkelur kriterin ndalues për aplikimin e këtij neni si dhe parashikimet e Vendimit Unifikues nr.2, datë 25.05.2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Referuar përmbajtjes së Vendimit të gjykatës së faktit, gjykata e përfaqësuar nga unë si magjistrat i gjykimit ka parashtruar specifikisht në përmbajtje të tij se... dhe janë në përmbajtje të vendimit në dy vende, që të mos i lexoj të plota, ku relatohen të gjitha dënimet e marra nga kërkuesi i dënuari respektiv si dhe në një analizë të mëtejshme janë përmendur përsëri të gjitha vendimet e të dënuarit përfshirë edhe bashkimin e dënimit të tyre.

Pra, konkludimi i gjykatës së apelit i mbështetur nga ILD se nuk është përmendur fakti nga ana e gjykatës që ai ka qenë përsëritës për kryerjen e veprave penale, nuk është i vërtetë. Pra nuk i përgjigjet realitetit të objektivave procedural.

Për sa rezulton, arsyetimi i Gjykatës së Apelit në përmbajtje të vendimit respektiv të kësaj gjykate, pavarësisht provave të administruara, si dhe fakteve të provuara në këtë proces gjyqësor, nuk është për mëndur fakti se, kërkuesi, i dënuari respektiv, është dënuar dy herë, rezulton i pambështetur në realitetin e aktit gjyqësor për këtë rrethanë fakti, të reklamuar si të munguar prej Gjykatës së Apelit, ndërkohë që

gjykata e faktit, pra unë si gjyqtar, kam parashtruar korrektësisht faktin e ekzistencës së dy vendimeve gjyqësore, datimin e tyre, si dhe bashkimin e tyre në një dënim të vetëm.

Për rrjedhojë, mbështetja nga ana e ILD-së e kësaj rrethane të ekspozuar fiktivisht nga Gjykata e Apelit Korçë, rezulton në kundërshtim me moralin, ligjin dhe qëllimin e procesit disiplinor dhe nuk mund të gjenerojë asnjë konkluzion mbi këtë fakt të munguar. Por gjeneron konkluzionin se nga ana e ILD-së vendimi gjyqësor i Gjykatës së faktit ose nuk është lexuar ose përmendja e kësaj rrethane është bërë qëllimisht për të gjeneruar konkluzione që duhet të mbështesin fiktivisht dhe pazgjidhshmërisht ndëshkimin e magjistratit {...} në këtë procedim disiplinor.

Lidhur me rrethanën e përmendur nga Gjykata e Apelit Korçë dhe mbështetur nga ILD-ja në këtë procedim disiplinor, që kërkuesi i lirit me kusht paraqitet si i dënuar përsëritës për krime të kryera me dashje dhe, për këtë aspekt, gjykata, pra unë gjyqtari i çështjes, nuk e kam analizuar atë si fakt, kjo pa asnjë indicie së nga lindi kjo rrethanë për të ushtruar këtë diskutim ën përmbajtje të vendimit të Gjykatës së Apelit. Për sa kohë nuk rezulton e reklamuar dhe debatuar në proces gjyqësor por vetëm e përmendur nën këndvështrimin e prekshëm disiplinor të paartikulluar specifikisht por të nënkuptuar nga ky Inspektorat se, duhet të kem shmangur qëllimisht faktin dhe analizën mbi faktin e munguar, në drejtim të mosrespektimit të nenit 64, pika 3 të Kodit Penal, për sanksionin: “Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarit përsëritës për krime të kryera me dashje... ”.

Parashtroj në kuadër të mbrojtjes time, një rrethanë shumë thelbësore që i takon këtij procedimi disiplinor se: Referuar përmbajtjes së Vendimit të Gjykatës së faktit, gjykata e përfaqësuar nga unë si magjistrat i gjykimit, ka zgjidhur rastin për gjykim, për sa rezulton, mbështetur në një arsyetim të zgjeruar dhe specifik, të orientuar në të drejtën pozitive vendase dhe atë ndërkombëtare, referuar specifikisht KEDNJ-së dhe praktikës së GJEDNJ-së, duke rezultuar e konkluduar qartë, se: Çdo i dënuar me burgim të përjetshëm duhet të këtë të drejtën e rishikimit periodik të këtij dënimi (pavarësisht nëse ka qenë ose jo i dënuar më parë për krime të kryera me dashje.)

Në fakt, si gjyqtar, për atë që përfaqësoj dhe shpreh në zbatimin e ligjit dhe, sipas rastit, edhe nevojës për interpretim të tij, në drejtim të kompetencës ekskluzive dhe unike, që ka gjykata në përgjithësi dhe vet gjyqtari në veçanti, për të realizuar këtë proces, gjithçka në funksion të dhënies së drejtësisë dhe respektimit të detyrueshëm sipas rastit të

legjislacionit pozitiv vendas dhe atij ndërkombëtar, reklamoj para Këshillit se, për asnjë rast, apo rrethanë nuk kam vendosur ndonjëherë në dyshim, apo të kem menduar në kulturën time juridike dhe atë të posaçme profesionale si gjyqtar, që neni 64 i Kodit Penal të këtë lidhje organike, apo ndërvarësie me nenin 65 të po këtij Kodi. Për rrjedhojë, çdo aludim mbi këtë rrethanë është i pavend.

Në kuadër të kësaj mbrojtjeje kam pasur dhe kam vështirësi për të krijuar mundësinë formale dhe të realizoj të drejtën që të paraqesë argumentin apo kundërgargumentat respektive në këtë drejtim të faktit të relatuar si shkelje disiplinore, sipas këndvështrimit të ILD-së, ndonëse është shumë e nevojshme ta prezantoj këtë, kjo pasi mbështetur në aktet që disponohen, provohet se çështja objekt shqyrtimi disiplinor për veprimtarinë time si gjyqtar në zgjidhje të saj, rezulton se është për gjykim para Gjykatës së Lartë mbi rekursin e prezantuar nga i dënuari.

Në përmbajtje të këtij rekursi, me rezulton nga njohja me aktet e këtij procedimi disiplinor se, ky aspekt është trajtuar nga i dënuari, në kundërshtim të qëndrimit të Gjykatës së Apelit Korçë.

Për rrjedhojë dhe në ilustrim direkt të kësaj rrethane, ajo paraqitet e debatueshme nga palët por jo nga qëndrimi i gjykatës (pra i imi) në zgjidhje të çështjes dhe e relatuar për zgjidhje ligjore nga Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, e cila do vlerësojë këtë qëndrim të Gjykatës së Apelit, si argument i përdorur nga kjo gjykatë për ndryshimin e vendimit të gjykatës së faktit dhe rrëzimin e kërkesës së të dënuarit për lirim me kusht.

Duke u mbështetur në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, specifikisht në nenin 102, pika 1, germa dh) sanksionohet se: "shkelja e detyrimit të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, që rezultojnë nga hetimi ose gjykimi, në proces ose i përfunduar”, përben shkak për fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit (dispozitë që është në fuqi në momentin që flasim).

Në këtë drejtim, ndalimi ligjor për veprimtarinë e magjistratit në drejtim të mospërhapjes së informacionit, që rezulton nga gjykimi në proces ose i përfunduar, mbështetur edhe në faktin shtesë të relatuar, se gjykimi konkret nuk ka përfunduar, kushtëzon dhënien e argumenteve nga magjistrati, të cilat kanë karakterin e informacionit

në këtë drejtim të faktit objekt dhe shkak thelbësor i këtij procedimi disiplinor, për sa kohë, rrethana specifike, nuk është pjesë integrale e çështjes së zgjidhur, pavarësisht nevojës të diktuar për t'i prezantuar ato në këtë seancë dëgjimore, për sa kohë nuk ekziston asnjë dispozitë ligjore, apo mekanizëm imunitar, që të legjitimojë magjistratin të përdorë apo të japë argumenta informues, apo trajtues të rrethanës, pa patur përgjegjësi disiplinore, qoftë edhe brenda karakterit disiplinor të kësaj seance.

Ndërkohë, në rast se magjistrati, në procesin e parashtrimit të mbrojtjes se tij, së paku para këtij Këshilli, përdor argumenta në kundërshtim të qëndrimit të Gjykatës së Apelit, për këtë aspekt juridik specifik, kjo vlerësohet nga ana ime si magjistrat se nuk është ligjore dhe vjen në një drejtim mbështetës se qëndrimit të të dënuarit në rekursin e tij, rrethanë që e konsideroj jo etike, jo profesionale dhe jo ligjore.

Por si magjistrat konstatoj se jam në gjendje, pa patur përgjegjësi disiplinore dhe në respektim të çdo parimi etik dhe ligjor, që të shkëputem nga rrethana e debatueshme dhe pa patur nevojën të bie në pozitat jo ligjore të kundërshtimit apo vlerësimit të një vendimi të një gjykate apeli edhe pse çështja është në shqyrtim dhe nuk paraqitet e përfunduar, për sa kohë ndodhet për gjykim përfundimtar në Gjykatën e Lartë.

Në këtë aspekt, argumenti që do paraqes, për të prezantuar që neni 64 i Kodit Penal, nuk ka lidhje me nenin 65 të po këtij Kodi, nuk do këtë lidhje me specifikën e rrethanës juridike të debatuar dhe zgjidhjes së çështjes objekt procedimi disiplinor në Apel dhe në Gjykatën e Lartë, duke dale tej këtij rasti, për formulimin: "Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarit përsëritës për krime të kryera me dashje... dhe duke u mbështetur vetëm në formulimin: "Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100".

Për çdo vlerësim të kundërt, ILD-ja që ka për kompetencë fillimin e hetimit disiplinor për këtë aspekt dhe vet ky Këshill është i lutur të më ndërpresë në çdo kohë ose të më autorizojë të jap argumentat.

Po jap argumentin: Neni 64/3 i Kodit Penal, sanksionon si: Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100.

Ndërkohë që neni 65/3 i Kodit Penal, sanksionon se: Nga ky rregull (për situatën sanksionuese të parashikuar nga paragrafi i 2-të i tij), përjashtohen të dënuarit për veprat penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c dhe paragrafi i tretë i nenit 100.

Në aspektin vetëm literal dhe semantik të këtyre parashikimeve ligjore, si gjyqtar çmoj se në rast se ndalimi i parashikuar nga sanksioni i paragrafit të tretë të nenit 64 të Kodit Penal, i formuluar si: “Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100”, do të ishte i vlefshëm për çdo lloj të dënuari, pra edhe për të dënuarit me burgim të përjetshëm, pyetja që shtrohet (të me falni për retoriken) është ajo se:

Për cilën arsye dhe logjikë sanksioni, këto ndalime për të njëjtat vepra penale, duhet të vendoseshin edhe në përmbajtje të sanksionit të pikës 3, të nenit 65 të Kodit Penal, për sa kohe ndodhen të sanksionuara në paragrafin e tretë të nenit 64 të po këtij Kodi?!

Përse duhej të dublohej i njëjti formulim ndalues sanksioni në dy dispozita ligjore në përmbajtje të Kodit Penal, përveçse nevojës së legjislatorit për qenien e tyre autonom?

Përgjigjja është një dhe e vetme pa asnjë interpretim të dispozitave dhe konsiston në faktin se, neni 64 i Kodit Penal, rregullon procesin e lirimit me kusht të të dënuarve që janë dënuar me burgim me afat të përcaktuar, kurse neni 65 i Kodit Penal, rregullon procesin e lirimit me kusht të të dënuarve, që janë dënuar me burgim pa afat të përcaktuar, pra vetëm të atyre të dënuarve me burgim të përjetshëm.

Për rrjedhojë, ky është vetëm një argument, pasi si magjistrat jam në gjendje të prezantoj disa të tillë, që provon pa asnjë ekuivok se neni 64 i Kodit Penal, nuk ka lidhje organike me nenin 65 të po këtij Kodi.

Ky argument i përdorur, buron dhe mbështetet nga sanksioni i nenit 29 të Kodit Penal, i cili për personat që kanë kryer krime parashikon vetëm tre lloj dënimesh kryesore: (1) Me burgim të përjetshëm; (2) Me burgim dhe; (3) Me gjobë.

Po ndal me argumentet e mëtejshme që diktohen nga ky sanksion i ligjit.

Në vijim parashtroj, se edhe vetë Vendimi unifikues nr.2/2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk ka ndonjë trajtim apo qëndrim të këtij rasti, si ky që po prezantohet nga ILD si veprimtari Gjyqësore e magjistratit në kundërshtim me ligjin, që të lidhet me unifikimin e praktikës gjyqësore në këtë drejtim.

Pra ky vendim Unifikues, as trajton dhe as zgjidh këtë aspekt juridik.

Për rrjedhojë, si magjistrat nuk jam në gjendje të kuptoj se:

Çfarë ka dashur të thotë apo të mbështesë ILD në raportin e saj drejtuar këtij Këshilli, kur shprehet kundrejt personit tim në detyrë, se ka gjetur veprimtarinë gjyqësore të magjistratit {...}, (citoj) në kundërshtim me sanksionin e nenit 64, pika 3 të Kodit Penal, pasi ky nen sanksionon si “Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarit përsëritës për krime të kryera me dashje”, ndaj magjistrati ka shkelur kriterin ndalues për aplikimin e këtij neni, si dhe parashikimet e Vendimit Unifikues nr.2, datë 25.05.2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë?

Pse nuk ekspozohen këto parashikime, si dhe të argumentohen ato nga ky këndvështrim disiplinor?

Në cilën mënyrë unë si magjistrat të realizoj të drejtën time për mbrojtje, mbështetur në këto rrethana të veprimtarisë vetëm deklarative të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të mbështetura nga ILD po në mënyrë deklarative, pa fakt, objekt dhe analizë dhe pa asnjë standard të arritjes së konkluzionit të reklamuar?

Për rrjedhojë, edhe për këtë rast shkak procedimi disiplinor, mbështetja nga ana e ILD-së e kësaj rrethane, të ekspozuar pa referencë në aktin gjyqësor unifikues dhe pa asnjë argument nga Gjykata e Apelit Korçë, rezulton në kundërshtim me moralin, ligjin, qëllimin e procesit disiplinor dhe nuk mund të gjenerojë asnjë konkluzion mbi këtë rrethanë të përmendur dhe arsyetim të munguar, por gjeneron konkluzionin se, nga ana e ILD-së, vendimi gjyqësor i gjykatës së apelit ose nuk është lexuar ose përmendja e kësaj rrethane është bërë qëllimisht për të gjeneruar konkluzione që duhet të mbështesin fiktivisht dhe pazgjidhshmërisht ndëshkimin tim si magjistrat.

Duke ju rikthyer kësaj arsyejeje që është relatuar, si prezantohet nga ILD, si shkak kryesor për të cilin si magjistrat ndodhem nën këtë procedim disiplinor para këtij Këshilli, vendos nën vërejtjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor se edhe pse ILD zhvesh përgjegjësinë si parashtron në raport, nga konkluzione që burojnë nga interpretimi i ligjit prej saj, kundrejt përgjegjësisë disiplinore të magjistratit, duke u mbështetur vetëm në konstatimet e gjykatës së apelit, mbi faktin apo rrethanën e vlerësuar prej kësaj gjykate të hierarkisë gjyqësore, si veprimtari në kundërshtim me ligjin të magjistratit, ky Inspektorat nuk është e mundur të mos këtë konstatuar se Gjykata e Apelit Korçë nuk ka paraqitur

qoftë edhe një argument të vetëm në arsyetimin e saj, se përse unë si magjistrat në zgjidhje të çështjes, duhej të isha mbështetur në sanksionin e nenit 64, paragrafi 3 të Kodit Penal. Kjo për gjithë sa është parashtruar.

Edhe pse si magjistrat, gjatë fazës së hetimit disiplinor, me shkresën nr. 102 prot., datë 24 prill 2020 të cilën ia kam përcjellë për dijeni edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor me aktin nr. 103 prot., të po kësaj date dhe që gjendet e administruar në aktet e këtij procedimi disiplinor, i kam kërkuar ILD-së të më sqaronte këtë rrethanë, nëse ajo përbënte ose jo shkelje disiplinore dhe/ose për çdo rast, të më jepte argumentet përkatëse që mbështesnin së paku qëndrimin paraprak të ILD-së, për të më mundësuar realizimin e mbrojtjes, por kjo u kalua në indiferentizëm të plotë nga ana e këtij Inspektorati në kundërshtim të përmbushjes së detyrës funksionale ligjore dhe të garantimit të një procesi të rregullt ligjor.

Në analizë përfundimtare, vlerësimi i kësaj rrethane, shkak dhe objekt i këtij procedimi disiplinor ndaj veprimtarisë sime gjyqësore si magjistrat në një çështje konkrete, se nuk kam zbatuar sanksionin e nenit 64, pika 3 të Kodit Penal dhe, nuk kam zgjidhur çështjen nga ky këndvështrim sanksioni, çmoj se për specifikat e parashtruara dhe të argumentuara, konkludimi nëse kjo përben ose jo shkelje të ligjës, nuk është në kompetencë vlerësuese të ILD-së, apo të vetë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sa kohë kompetenca për gjykim dhe vlerësim i përket Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, si gjykatë e mirëfilltë ligji.

Për rrjedhojë, mbështetur mbi çdo arsye ligjore, që buron logjikisht nga trajtimi specifik i shkeljes, kërkoj nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor që kjo shkelje që i atribuohet personit tim nën procedim disiplinor të mos vlerësohet, pasi rezulton një akuzë e pabazë, e pathemeltë dhe e paprovuar.

Lidhur me shkeljen disiplinore, që formulohet nga përmbajtja e raportit të ILD-së, se: Magjistrati, ka qenë kontradiktor në referimin e ligjit të zbatueshëm, atë të kohës të kryerjes së veprave penale, mbasi kur analizon kriteret ndaluese për lirimin me kusht, që parashikon neni 65 i Kodit Penal, për dy kushte të parashikuara nga e njëjta dispozitë, njëherë zbaton ligjin penal të kohës kur është kryer vepra penale dhe për kushtin tjetër, zbatohet ligji penal i kohës kur paraqitet dhe shqyrtohet kërkesa për librim me kusht (transferimi i të dënuarit), duke ilustruar këtë përmbajtje, si: Lidhur me këtë vlerësim të

Gjykatës së Apelit, ILD ka konkluduar në përfundim të hetimit disiplinor dhe mbështet qëndrimin si shkak dhe arsye të këtij procedimi disiplinor ndaj magjistratit se: (është ajo që citova).

Në vijim ILD konkludon se, kjo veprimtari gjyqësore e magjistratit vjen në kundërshtim me përcaktimet e Vendimit unifikues nr.4/2003 (që është pika tjetër që do të diskutohet) të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që ka sjellë si rrjedhojë edhe mosrespektimin e kërkesave të nenit 65/3 të Kodit Penal, i cili ka të bëjë me mungesën në çështje të një prej kushteve të domosdoshme për lirim me kusht të të dënuarit me burgim të përjetshëm, kryerjen e 35 viteve burgim.

Për këtë aspekt, ILD konkludon se magjistrati nuk ka zbatuar një vendim unifikues.

Për sa më atribohet si shkelje, po trajtoj sipas renditjes së tyre.... deklaroj para këtij Këshilli të nderuar se, kjo nuk i përgjigjet realitetit të faktit, qëllimit të këtij parashtrimi dhe nevojës të trajtimit të tij si fakt, në përmbajtje të arsyetimit të gjykatës si dhe gjendet shumë larg konceptit të arsyetimit të gjykatës dhe nevojës së procesit për këtë konkluzion.

Pra, si magjistrat nuk arrij të formuloj asnjë koncept perceptues të këtij konstatimi të Gjykatës së Apelit Korçë, i cili është mbështetur nga ILD, e cila e ka prezantuar si shkelje në kuadër të këtij procedimi disiplinor.

Referuar përmbajtjes së vendimit, provohet se cili ka qenë qëllimi i gjykatës për trajtimin e këtij aspekti. Po citoj përmbajtjen e vendimit për këtë aspekt qëllimor (është vetëm një paragraf) dhe nevojës së trajtimit të tij në zgjidhje të çështjes. Gjykata shprehet, se:

"Për sa mund të konstatohet, i vetmi diskutim juridik që mund të lindë është ai, nëse figura e veprës penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal në kohën e kryerjes së veprave penale, të njohura nga sanksioni i nenit 78-25; 78 të Kodit Penal shqiptar, referon ose jo në figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 78/a i Kodit Penal, që rezulton kriter ndalues për lirim me kusht të të dënuarit me burgim të përjetshëm, sipas përmbajtjes së dispozitës në momentin e paraqitjes së kërkesës për gjykim. Neni 78/a i Kodit Penal, rezulton dispozitë e re, që rezulton e tillë pas modifikimit të paragrafit të dytë të nenit 78 të po këtij Kodi."

Pra duhet t'ju tërheqë vëmendjen shprehja juridike “pas modifikimit” që ka përdorur gjykata në arsyetim, e cila lidhet specifikisht me argumentin e parashtruar në atë arsyetim gjyqësor, për t'iu përgjigjur situatës trajtuese, e cila referonte në ekzistencën ose jo të një inkriminimi të ri ndaj veprimit të kundërligjshëm, për të cilin ishte dënuar subjekti, kërkues i lirit me kusht dhe ekzistencës ose jo të fuqisë prapavepruese të normës së re, në rast se kjo e fundit, pra neni 78/a i Kodit Penal, që me ndryshimet e ligjit penal, rezulton produkt i modifikimit të nenit 78 të po këtij Kodi, aplikohet apo jo ndaj këtij subjekti (citohet gjykata):

"Çfarë ndodh kur ligji i ri apo i mëvonshëm ka dispozita favorizuese ose jo favorizuese? Është e padiskutueshme në doktrinë dhe në praktiken gjyqësore, që në rastin e një modifikimi dhe jo shfuqizimi, duhet të analizohet konkretisht cili nga dy ligjet, ku njëri është vazhdimësia e tjetrit, është më i favorshëm, duke verifikuar rast pas rasti rezultatet e mundshme, në analizën e natyrës, masës së dënimit, afateve të parashkrimit të veprës penale (dhe) të rrethanave.”

Sa më sipër, gjykata ka konkluduar, në trajtimin e kësaj rrethane, se: “Në rrethana të tilla, gjykata konstaton se si në rastin e kualifikimit të veprës penale nga përmbajtja sanksionuese e nenit 78 të Kodit Penal, të para ndryshimit të tij me ligjin nr. 144/2013, ashtu edhe pas këtij ndryshimi, ku rrethana cilësuese e vrasjes për gjakmarrje është hequr nga përmbajtja e paragrafit të dytë të nenit 78 dhe është rikualifikuar si një normë e re penale, e formuluar nga sanksioni i nenit 78/a të Kodit Penal, veprimet objektive të të dënuarit respektiv, nuk janë kualifikuar për asnjë rast si vrasje për gjakmarrje.”

Duke arritur në këtë konkluzion, gjykata nuk kishte përse të shprehej nëse do aplikonte ose jo aspekte të fuqisë prapavepruese të ligjit për këtë aspekt.

Për sa provohet, kjo rrethanë e pretenduar si shkelje, është thjesht një artificë, që nuk gjenerohet nga përmbajtja e arsytimit të gjykatës dhe qëllimit apo specifikës së rastit për trajtim ligjor.

Dhe për më tepër, përmbajtja e shkeljes respektive se "...magjistrati ndërsa ka aplikuar dispozitën favorizuese në lidhje me përmbushjen e afatit kohor për lirim me kusht, të specifikuar si afat 25 vet, nga ana tjetër, lidhur me kriterin tjetër ndalues, që referon tek neni 78/a i Kodit Penal, ka zbatuar ligjin e kohës kur është paraqitur dhe shqyrtuar kërkesa (e theksoj këtë përcaktim), pra “ka zbatuar ligjin e kohës kur është

paraqitur dhe shqyrtuar kërkesa”. Ky “zbatim” trajtohet si prezent ndërkohë që nuk është zbatuar asgjë në këtë drejtim dhe gjendet se është argument fiktiv, pasi gjykata në këtë rast, nuk e ka gjetur prezente atë situatë dhe jo më të këtë zbatuar ligjin e kohës lidhur me modifikimin e normës nga neni 78 tek neni 78/1 i Kodit Penal, si relatohet.

Përse gjendet ky përcaktim fiktiv i Gjykatës së Apelit Korçë dhe pse është mbështetur ai si ilustrim shkelje nga ILD-ja mbi këtë fiktivitet rrethanë në çështje, apo pse vetë Inspektorati nuk e ka verifikuar nëse kjo situatë qëndron apo jo, -nuk mund të shprehem.

Për rrjedhojë, mbështetur mbi çdo arsye ligjore që buron logjikisht nga trajtimi specifik i shkeljes, kërkoj nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, që kjo shkelje që i atribuohet personit tim nën procedim disiplinor të mos vlerësohet si e tillë, pasi rezulton një akuzë e pabazë, e pathemeltë dhe e paprovuar.

Lidhur me shkeljen e pretenduar vijuese ilustruese të ILD-së se, “...kjo veprimtari gjyqësore e magjistratit vjen në kundërshtim me përcaktimet e Vendimit unifikues nr. 4/2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që ka sjellë si rrjedhojë edhe mosrespektimin e kërkesave të nenit 65/3 të Kodit Penal, i cili ka të bëjë me mungesën në çështje të një prej kushteve të domosdoshme për lirim me kusht të të dënuarit me burgim të përjetshëm, kryerjen e 35 viteve burgim”, duke referuar se magjistrati nuk ka zbatuar një vendim unifikues, parashtroj:

Së pari, Vendimi unifikues nr.4/2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka gjetur trajtim në përmbajtje të arsyetimit të gjykatës, por rezulton se ai është i paaplikueshëm për rastin specifik të zgjidhur nga gjykata për lirim me kusht.

Për këtë aspekt, pas një trajtimi të plotë teorik dhe praktik, në arsyetimin e saj, gjykata ka konkluduar se (citohet vendimi):

“Por problematika lidhet me situatën në ngjarje se si mund të aplikohen këto parime në dispozita materiale që lidhen me fazën e ekzekutimit të dënimit, për sa kohë jurisprudenca teorike dhe ajo praktike nuk jep ndonjë përcaktim të qartë se si duhet të veprohet si dhe është rasti i nenit 65 të Kodit Penal.”

Në këtë drejtim, vendimi i mësipërm unifikues, nuk paraqitet specifik dhe nuk ka pasur për qëllim të unifikojë gjithë situatat juridike, si dhe është ajo e trajtuar për lirim me kusht.

Për sa mund të konstatohet në përmbajtje të Vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë, mungon arsyetimi se perse zgjidhja që i kishte dhënë gjykata e faktit çështjes së lirimit me kusht të një të dënuari, binte ndesh me këtë vendim unifikues.

Në terma të shpejtë, për të sqaruar anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, parashtroj se:

Gjykata e Apelit Korçë, për sa mund të kuptohet vetëm duke ditur thelbin, por jo pa e njohur atë, mban qëndrimin se neni 65 i Kodit Penal, edhe pse është një dispozite në përmbajtje të legjislacionit penal, shtrin efektet e tij në fazën e ekzekutimit të dënimit, pra pasi vendimi i dënimit ka marrë formë të prerë dhe paraqitet përfundimtar.

Si një dispozitë që shtrin efektet në fazën e ekzekutimit të dënimit të caktuar nga gjykata, neni 65 i Kodit Penal, relatohet si një normë e karakterit procedural, pavarësisht se është pjesë përbërëse e Kodit Penal. Si një normë e karakterit procedural, në rastin e ndryshimit të saj, si dhe është rasti i rrethanës në ligj që ishte 25 vjet dhe u ndryshua duke u rritur në 35 vjet, që një i dënuar me burgim të përjetshëm të kishte të drejtën e paraqitjes së kërkesës në gjykatë për lirim me kusht, gjykata duhej të kishte konstatuar se i dënuari nuk kishte arritur këtë kriter, pra kishte vuajtur më pak se 35 vjet burgim dhe duhej të kishte rrezuar kërkesën, duke mos pasur vend për aplikimin e normës më favorizuese për kërkuesin, pasi kërkesa e tij për gjykim drejtuar gjykatës, datonte e paraqitur për shqyrtim gjyqësor në kohën kur neni 65 i Kodit Penal, paraqitej i ndryshuar me 35 vjet dhe, në këtë rast, sipas Gjykatës së Apelit Korçë, kjo gjendet e fiksuar si mënyrë sjelljeje e detyrueshme për gjykatën, në mbështetje të Vendimit unifikues nr.4/2003, i cili unifikon... (nuk po e lexoj unifikimin pasi është i njohur dhe është në pjesën përmbajtëse të raportit të ILD).

Si magjistrat në hetim disiplinor, deklaroj se jam plotësisht dakord me këtë përcaktim unifikues, por jo me këtë koncept të deklaruar apo vetëm të cituar nga Gjykata e Apelit, pa asnjë argument që të mbështesë atë dhe aplikimin e tij në zgjidhje të rastit objekt gjykimi.

Rasti i trajtuar nga Gjykata e Lartë, lidhet me përfitimin që kërkonte i dënuari nga modifikimi i normës penale për të cilën paraqitej i dënuar, për sa pretendonte me parashikime më të favorshme për të dhe, gjithçka gjatë fazës së vuajtjes së dënimit, apo ekzekutimit të dënimit me burgim.

Në rastin e paraqitjes së kërkesës së një të dënuari për lirim me kusht, koncepti i aplikimit të normës penale më favorizuese ndryshon dhe nuk mund të diktohet nga ky vendim unifikues.

Dhe kjo sepse: Kërkuesi në këtë lloj procesi, paraqitet i dënuar, në rastin konkret me burgim të përjetshëm. Çdo ndryshim lehtësues i dispozitës penale për këtë lloj dënimi, apo çdo dënim tjetër gjatë kohës që i dënuari paraqitet me vendim përfundimtar dhe gjatë kohës së ekzekutimit të dënimit, nuk mund të sjellë për pasojë ndryshimin e masës së dënimit të caktuar për t'u vuajtur nga gjykata, pra ky është rasti që unifikon vendimi nr.4/2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Por, ky Vendim unifikues, nuk përmban këtë unifikim të praktikës gjyqësore, kur dispozita penale, nuk është një normë ligjore, mbi sanksionin e se cilës, i dënuari paraqitet si vuajtjes i dënimit me burgim. Pra neni 65 i Kodit Penal, nuk është dispozitë e karakterit të ndonjë figure vepre penale, objektin e mbrojtur të së cilës nga sjellja e kundërligjshme, ka cenuar i dënuari, i cili i është nënshtruar dënimit që marzhet e dispozitës parashikojnë.

Neni 65 i Kodit Penal është një dispozitë, e cila lidhet me të drejtën e të dënuarit për të reduktuar dënimin e caktuar nga gjykata, në kuadër të një mundësie rishikimi të dënimit të caktuar prej saj, lidhur me kohëzgjatjen e tij dhe kjo për përmbushje të aspekteve rehabilituese dhe riintegruese nga i dënuari. Ashpërsimi i kriterit kohor nga 25 vjet në 35 vjet, për kohën që duhet të vuajë i dënuari për të realizuar të drejtën e paraqitjes së kërkesës, sipas institutit të lirit me kusht, nuk lidhet me asnjë koncept të teorisë së drejtës penale, si ai i modifikimit të dispozitës penale, që rregullon Vendimi unifikues nr.4/2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Pra, plotësimi i kriterit ligjor nga i dënuari, për të vuajtur 25 vjet burgim apo 35 vjet burgim, si paraqitet ky kriter i ndryshuar për këtë masë të vuajtjes së dënimit, lidhet me kohën e vuajtjes së dënimit, që duhet të plotësojë i dënuari për t'i lindur e drejta për paraqitjen e kërkesës për lirim me kusht dhe si rezulton, nuk lidhet me ndryshimin e marzheve të dënimit të normës penale për sanksionin e saj.

E theksoj "për t'i lindur e drejta", pra një e drejtë specifike teknike, e individualizuar si kusht ligjor, që ka varësi me kriterin ligjor, që duhet të përmbushet në këtë masë të vuajtjes së dënimit prej 25 apo 35 vjet dhe jo si një e drejtë që mund të

pretendohet për realizim nga i dënuari si rezultat i modifikimit me natyre lehtësuese të marzhit të dënimit të normës penale për të cilën ai paraqitet i dënuar, e drejtë që nuk ka lidhje varësie dhe nuk paraqitet e kushtëzuar nga përmbushja e ndonjë kriteri ligjor kohor, për paraqitjen e kërkesës për realizimin e kësaj të drejte.

Pra mund të shihen qartë diferencat përkatëse, që ekzistojnë midis nenit 65 të Kodit Penal dhe dispozitave penale, të cilave iu referohet me zgjidhje dhe unifikim të praktikës gjyqësore Vendimi unifikues nr.4/2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Sa më sipër, interpretimi i ligjit penal në kohë dhe në hapësirë, apo rrethanat që kanë të bëjnë me aplikimin e ligjit me favorizues për të dënuarin, në rastin e ndryshimit të kriterëve apo kushteve ligjore të normës penale, si dhe është neni 65 i Kodit Penal, diktojnë një këndvështrim të ndryshëm në zbatim, nga ai i këtij vendimi unifikues.

Në përmbajtje të Vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë, nuk gjendet asnjë argument, i cili të sqarojë këto sa u parashtruan, qoftë edhe në drejtim të kundërt të këtij koncepti, mbi të cilin si magjistrat kam zgjidhur rastin për gjykim.

Edhe vetë ILD nuk jep asnjë argument të vetin, por vetëm mbështetet mbi konstatimin e Gjykatës së Apelit Korçë, në mënyrë empirike dhe pa patur parasysh asgjë nga këto, ndonëse si magjistrat gjatë fazës së hetimit të këtij procedimi disiplinor ju kam kërkuar të sqarohesha apo të më qartësonin se, ku mbështetej ky qëndrimi i Gjykatës së Apelit, por kjo nuk ndodhi.

Për rrjedhojë, mbështetur mbi çdo arsye ligjore, që buron logjikisht nga trajtimi specifik i shkeljes, kërkoj nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, që kjo shkelje që i atribuohet personit im nën procedim disiplinor të mos vlerësohet, pasi rezulton një akuzë e pabazë, e pathemeltë dhe e paprovuar.

Në analizë përfundimtare, vlerësimi i kësaj rrethane, shkak dhe objekt i këtij procedimi disiplinor ndaj veprimtarisë sime gjyqësore si magjistrat në një çështje konkrete, se nuk kam zbatuar Vendimin unifikues nr.4/2003 dhe, nuk kam zgjidhur çështjen nga ky këndvështrim unifikimi të praktikës gjyqësore, çmoj se për specifikat e parashtruara dhe të argumentuara, konkludimi nëse kjo përben ose jo shkelje të ligjës, nuk është në kompetencë vlerësuese të ILD-së, apo të vetë Këshillit të Lartë Gjyqësor,

për sa kohë kompetenca për gjykim dhe vlerësim i përket Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, si gjykatë e mirëfilltë ligji.

Në këtë rast, i referohem dhe qëndrimit të vetë Gjykatës së Lartë, në Vendimet nr.590, datë vendimi 20.12.2016, apo Vendimi nr.289, datë vendimi 18.04.2017 (të cilat i kam paraqitur në provat e mia), ku është mbajtur qëndrimi se është vetëm Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, gjykata që ka të drejtën të gjykojë dhe të vendosë nëse një vendimmarrje gjykate bie ose jo ndesh me një vendim unifikues të nxjerrë prej saj dhe jo Gjykata e Apelit, apo në këtë rast ILD-ja.

Duke qenë se ju si anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor jeni të njohur me përmbajtjen dhe argumentet përkatës të gjykatës në zgjidhje të çështjes, nuk e çmoj të nevojshme të bie në përsëritje, por po referoj për ju disa qëndrime të GJEDNJ-së, të cilat mbështesin këtë zgjidhje gjyqësore.

Kjo për gjithë ata, që për ndarjen e ligjit material nga ligji procedural, ndjekin kriterin formal të vendosjes së normës në kodin respektiv. Kjo logjikë dhe teknikë vlerësimi është e gabuar, nëse rast pas rasti, nuk vlerësohet drejt mbi thelbin dhe natyrën e rregullit ligjor.

Për këtë rast, si magjistrat, po ndaj një pasazh nga GJEDNJ-ja mbi këtë çështje, pra mbi fushën e zbatimit të nenit 7 të KEDNJ-së, nxjerrë nga Çështja Welch që ia u kam paraqitur si provë, të datës 9 shkurt 1995, e cila konkludon se: “Për ta bërë efektive mbrojtjen e ofruar nga neni 7, gjykata duhet të jetë e lirë që të shkojë përtej aparcencës dhe të vlerësojë vetë nëse një masë konkrete analizohet në themel si një “dënim” në kuptim të kësaj dispozite.”

Në vendimmarrjen objekt procedimi disiplinor, kam arsyetuar specifikisht konceptin ligjor se: “...një i burgosur, i dënuar me burgim të përjetshëm, që ka të drejtën të dijë çfarë i duhet të bëjë, në mënyrë që lirimi i tij të jetë i parashikueshëm dhe të dijë se, kush janë kushtet e zbatueshme”, nxjerrë nga dy Vendime të Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, në çështjen e paraqitur si provë “Vinter dhe të tjerët kundër Royaume Uni”, e vitit 2013 dhe Çështja “Viola kundër Italisë”, nr.2 e vitit 2019.

Në terma më të kuptueshëm, ndryshimi i kushtit ligjor nga 25 vjet burgim në 35 vjet të tilla, që një i dënuar me burgim të përjetshëm duhet të përmbushë për t’i lindur e drejta për të kërkuar lirimin me kusht, sipas nenit 65 të Kodit Penal, të para ndryshimit

dhe të pas ndryshimit të tij për këtë hark kohor të vuajtjes së dënimit, në rastin e argumentuar kur ky ndryshim nuk shoqërohet nga legjislatori me efektin ose jo prapaveprues të ligjit dhe të drejtës në përmbajtje të vetë normës penale, apo sipas teknikës legislative kjo fuqi prapavepruese nuk gjen rregullim në ndonjë dispozitë kalimtare të ligjit, si dhe paraqitet ky aspekt si i parregulluar në Kodin tonë Penal, ky ashpërsim afati në këto rrethana, konsiderohet nga GJEDNJ-ja si “dënim” në kuptim të nenit 7 të KEDNJ-së, që duhet të merret parasysht në çdo rast nga gjykata për të mos e lejuar dhe legjitimuar këtë situatë.

Pra, nuk konsiderohet e ligjshme, që një i dënuar me burgim të përjetshëm, nën kushtet e përcaktimit të mësipërm të GJEDNJ-së, bën çdo përpjekje për rehabilitim dhe riintegrim, për të përmbushur këtë kriter të ligjit dhe për të paraqitur kërkesën në afatin e përcaktuar nga ligja, në rastin konkret ish 25 vjet dhe, vetëm një ditë para përmbushjes së këtij afati, legjislatori e zgjat këtë afat në 35 vjet. I dënuari vijon të përmbushë detyrimet e tij në respektim të këtij afati dhe përsëri vetëm një ditë para kësaj përmbushjeje, legjislatori e zgjat përsëri këtë afat, pra duke e bërë këtë të drejtë për paraqitje të kërkesës, të paparashikueshme për të dënuarin dhe që ndikon drejtpërdrejt në përpjekjet e tij për të bërë të zbatueshëm kushtet e vendosura.

Përtej ilustrimit apo shpjegimit të rastit objekt procedimi disiplinor, si magjistrat më tërheq thellësisht vëmendjen fakti prezent se, si Gjykata e Apelit Korçë, edhe vetë ILD-ja, nuk pasqyrojnë, relatojnë, apo konkludojnë mbështetjen e këtyre shkeljeve të pretenduara si ligjore dhe më tej të artikuluar si disiplinore, duke mos iu referuar argumentave, apo qoftë edhe të një prej tyre, për sa gjykata dhe unë si magjistrat i çështjes, kam arsyetuar për zgjidhje të saj, me aplikimin e drejtpërdrejtë të KEDNJ dhe praktiken e GJEDNJ-së.

Natyrisht, kjo duhet të tërheqë edhe vëmendjen Tuaj si anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, se përse magjistrati ndodhet në këtë situatë procedimore, me relatime të shkeljeve dhe argumenta nga ana e ILD-së, tej realitetit objektiv procedural dhe material, apo faktik dhe konceptual, ku unë si magjistrat jam referuar dhe mbështetur në zgjidhje të çështjes.

Si magjistrat për këtë konstatim të dukshëm dhe të prekshëm, mbaj qëndrimin se ILD nuk ka asnjë argument për të mbështetur të kundërtën e tyre.

Lidhur me rrethanën e formuluar nga ILD, si (citohet): Në këtë drejtim të rrethanës së vlerësuar, ndryshe nga sa udhëzon Gjykata e Lartë në këtë Vendim Unifikues nr.2/2015, rezulton se nga magjistrati në rastin konkret nuk janë mbajtur në konsiderate prej tij... dhe referohen një sërë rrethanash nga ky këndvështrim koncepti, rrjedhojë e moszbatimit të këtij vendimi unifikues, të cilat do i analizoj në vijim:

Parashtroj, se: Ndryshe nga qëndrimi i Gjykatës së Apelit Korçë, qëndrimi mbështetur dhe nga ILD-ja për këtë aspekt, si dhe rezulton nga argumentet e paraqitura me sipër. Vendimi Unifikues nr.2/2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk gjen zbatim të detyrueshëm në çështjen objekt procedimi disiplinor pasi, për çdo rast të vlerësimit dhe unifikimit të praktikës gjyqësore, kjo vendimmarrje e karakterit unifikues, i referohet konceptit trajtues dhe zbatues të nenit 64 të Kodit Penal dhe për asnjë rrethanë, konceptit trajtues dhe zbatues të nenit 65 të po këtij Kodi.

Referuar sanksionit të nenit 1/c të Kodit Penal, zbatimi i ligjit penal me analogji është i ndaluar, aksiomë kjo që dukshëm nuk është mbajtur parasysh në formulimin e kësaj shkeljeje të pretenduar mbi këtë qëndrim.

Referimi i Gjykatës së Apelit Korçë, për zgjidhjen e rastit objekt gjykimi me pasojë ndryshimin e vendimit të gjykatës së faktit dhe, referimi i vetë ILD-së, për të mbështetur fillimin e hetimit disiplinor ndaj meje si magjistrat, tek ky Vendim unifikues, edhe në këtë rast nuk shoqërohet, apo mbështetet me argumentin se: Përse gjykata e faktit, ndryshe unë si magjistrat, duhej të zbatohet në mënyrë të detyrueshme këtë vendim unifikues, në zgjidhje të rastit objekt gjykimi?!

Në qëndrimin e Gjykatës së Apelit Korçë mungon plotësisht ky arsyetim i detyrueshëm, ndërkohë që edhe në qëndrimin e vetë ILD-së nuk konstatohet asnjë arsyetim i tillë autonom.

Rezulton se ILD e ka pranuar të mirëqenë këtë referencë shkeljeje të magjistratit, për sa kohë ka qenë si dhe është e detyruar ligjërisht në përmbushje të funksionit të vet, që të konstatonte apo konstatojë edhe në këto momente se: Ky qëndrim nuk mbështetet mbi asnjë arsyetim, duke u prezantuar si empirik dhe jo më pak pasoja për këtë boshllëk, në dukje “të harruar” në kuadër të këtij procedimi disiplinor.

Në procesin që formon, apo ekspozon konkluzionin, arsyetimi në drejtimin e mësipërm është parakusht absolut për të krijuar shtratin logjik të lidhjes shkak-pasojë,

midis faktit dhe lidhjes së tij si fakt me konkluzionin, natyrisht mbështetur në argumentet përkatës, të cilat duhej të ishin prezent, por nuk janë.

Pra, mungon tërësisht lënda apo argumenti që mbështet këtë qëndrim të ILD-së, që për sa rezulton formulohet nga koncepti prezent se: Për sa kohë e ka konkluduar Gjykata e Apelit unë si Inspektorat i Lartë i Drejtësisë po e marr të mirëqenë, duke më vendosur si magjistrat në procedim disiplinor për këtë rrethanë shkelje, në pamundësi absolute të konceptimit të shkeljes së pretenduar, si dhe në pamundësi objektive për t'iu përgjigjur me argumenta specifike kundërshtues kësaj situatë procedimore.

Po i referohem në këtë mbrojtje termit "qëndrim" dhe jo termit "konkluzion", pasi për të arritur në një konkluzion, si dhe ky që kërkohet të imponohet për këtë Këshill të nderuar se: Magjistrati nuk ka zbatuar një vendim unifikues të praktikës gjyqësore, ILD ka qenë e detyruar të specifikonte në mënyrë të qartë dhe pa shmangie se: për cilat arsye të trajtimit teorik dhe praktik, Vendimi unifikues nr.2/2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjendet i aplikueshëm edhe për rastin që sanksionon neni 65 i Kodit Penal, ndërkohë që për asnjë rast apo rrethanë në përmbajtjen thjesht formate të vendimit unifikues, ky nen, pra neni 65 i Kodit Penal, jo vetëm që nuk është përmendur, por as që është referuar dhe jo më të jetë argumentuar ndonjë qëndrim lidhës midis tij dhe situatës së unifikuar që rrjedh nga mënyra e zbatimit të nenit 64 të Kodit Penal.

Në kuadër të respektimit të një procesi të rregullt ligjor, kjo situatë pyetje specifike duhet të ishte e sqaruar nga ana e ILD-së, për të mos prezantuar për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe opinionin publik një akuzë të tillë të pabazuar, ndërkohë që si magjistrat në këtë procedim disiplinor vijoj të mbetem në pritje të një përgjigje nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, që prej datës 24 prill 2020, për sa jam drejtuar me aktin nr. 103 prot, të kësaj date z.Metani, për këtë cilësi funksioni dhe për dijëni edhe KLGJ-së.

Për personin tim në detyrën e magjistratit nën këtë procedim disiplinor e kam të qartë se është e pamundur nga ana e ILD-së të japë një përgjigje, kjo pasi mungesa e faktit të parashtruar në përmbajtje të vetë pyetjes është e vërtetuar, referuar specifikisht përmbajtjes së Vendimit Unifikues nr.2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Ndërkohë, i drejtohem këtij Këshilli të nderuar se, referuar sanksionit të nenit 1/c të Kodit Penal, në Republikën e Shqipërisë, zbatimi me analogji i ligjit penal është i

ndaluar, që do të thotë se aplikimi me analogji i Vendimit Unifikues nr.2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për çdo rast tjetër, tej rastit të unifikuar është rrjedhimisht i ndaluar.

Referuar këtij sanksioni ligjor dhe pasojave rrjedhojë të tij, sqaroj këtë Këshill të nderuar se si magjistrat e kam përdorur këtë vendim unifikues vetëm si referencë, duke e përdorur atë me shtrat orientues, për sa konceptet trajtuese të tij mund të ometoheshin në trajtimin dhe zhvillimin e kërkesës së të dënuarit me burgim të përjetshëm për lirim me kusht, referuar sanksionit të nenit 65 të Kodit Penal.

Pra, kam realizuar një implementim mekanik dhe vetëm konceptual të tij si vendim, për nocionet sqaruese të sjelljes praktike të gjykatës, dhe kjo vetëm në drejtim ndihmës dhe zhvillues të atyre aspekteve, më së shumti si mënyrë sjelljeje e gjykatës, për aq sa paraqitej ajo e nevojshme dhe e aplikueshme në rastin për gjykim.

Por, për këtë mënyrë sjelljeje të gjykatës, në kuadër të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, do analizoj dhe ilustroj specifikisht në vijim të kësaj mbrojtjeje në momentin e duhur, përveçse është shumë e ekspozuar objektivisht dhe subjektivisht në përmbajtje të vendimit specifik.

Mbështetur në kornizat e karakterit disiplinor të trajtimit të shkeljes së pretenduar nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë edhe njëherë se, si gjyqtar nuk kam zbatuar këtë vendim unifikues në trajtimin dhe zgjidhjen e një çështjeje konkrete, kërkoj nga ky Këshill i Lartë Gjyqësor të pranojë këtë situatë kundërshtuese fakti dhe ligji, për sa kam parashtruar, që lidhet me pathemelësinë e ILD-së në formulimin e saj si shkelje dhe kjo, e denoncuar për paligjshmëri qëndrimi që në momentin e fillimit të hetimit disiplinor ndaj meje si magjistrat, pasi ky Inspektorat si paraqitet edhe në këto momente në përfundim të këtij hetimi disiplinor, nuk ka patur asnjëherë dhe në vijim nuk mund të prezantojë asnjë shkak faktik dhe arsye ligjore, që të mbështesë dhe provoje këtë qëndrim të tij kundrejt veprimtarisë time gjyqësore si gjyqtar në zgjidhje të një rasti konkret objekt gjykimi.

Duke u mbështetur në faktin se zgjidhja e kërkesës penale për lirim me kusht, objekt vlerësimi i veprimtarisë sime si magjistrat në këtë proces disiplinor, është mbështetur në kërkesat e nenit 29, 145, neni 4, pika 3, neni 17, pika 2, dhe neni 122 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në lidhje me nenin 1/a të Kodit Penal dhe si veprimtari Gjyqësore konceptuale, trajtuese dhe zgjedhëse që mbështetet në parashtrim,

arsyetim dhe argumentim tej çdo shkakut dhe arsyeje që ILD referon se më atribuohet si shkelje dhe më ka sjellë në këtë procedim disiplinor, reklamoj për këtë Këshill të Lartë Gjyqësor se, kjo mënyrë sjelljeje e ILD-së, gjendet në kundërshtim flagrant të sanksionit të nenit 1/a të Kodit Penal, i cili sanksionon si:

“Kodi Penal bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në parimet e përgjithshme të së drejtës penale ndërkombëtare, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar”.

Për sa po e shpreh në mënyrë të përsëritur, ILD rezulton se paraqitet në shmangie të plotë, duke mos paraqitur asnjë rrethanë trajtuese dhe jo më kundërshtuese, e çdo lloji qoftë ajo, në raport me zgjidhjen e kërkesës penale për lirim me kusht, mbështetur nga sanksioni i nenit 65 të Kodit Penal, nga ana e gjykatës së faktit, që referon në dispozitat e sipërcituara ku është mbështetur gjykata, ose unë si gjyqtar i çështjes në zgjidhje të saj.

Neni 29 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon, si:

1. Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një veprë penale, e cila nuk

konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare.

2. Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale.

3. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese (theksohet pika 3), në një argument shtesë të më tepërt është: që në Kushtetutë, fuqia prapavepruese favorizuese e ligjit penal ishte i sanksionuar. Çdo artificë dhe ndërhyrje është specifike, siç është vendimi unifikues nr. 4/2003 i cili rregullon disa aspekte të posaçme pa rënë ndesh me nenin 3. Pra përsëri mbetemi tej/shumë larg perceptimit dhe akuzës që paraqet ILD-ja në rastin konkret.

Neni 145 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon, si:

1. Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.

3. Ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve passjell përgjegjësi sipas ligjit.

Neni 4, pika 3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon, si:

3. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.

Neni 17, pika 2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon, si:

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 122 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon, si:

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj. Specifikisht, kemi të bëjmë me statutin e...

E konsideroj të tepërt të argumentoj për këtë Këshill të Lartë Gjyqësor, apo të provoj për Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë se: Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, ku bën pjesë edhe neni 7 i saj, dhe mbi të cilin si magjistrat kam mbështetur zgjidhjen e kërkesës penale për lirim me kusht, paraqitet e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë dhe ka qenë dhe është pjesë integrale e të drejtës pozitive vendase. Për sa kam arsyetuar, argumentuar dhe konkluduar në këtë vendimmarrje gjyqësore objekt fillimi të procedimit disiplinor ndaj meje si magjistrat, rezultoj me veprimtari gjyqësore në përmbushje të detyrave të mia ligjore funksionale si gjyqtar, në respektim korrekt të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe parimeve të legjislacionit penal, sipas sanksionit të nenit 1/c të Kodit Penal, përfshirë dhe bazës se tij të sanksionuar në nenin 1/a të po këtij Kodi.

Edhe në këtë moment jam në mbrojtje të kësaj Kushtetute, në kuadër të këtij procedimi disiplinor, të filluar dhe përfunduar nga ILD, për sa provohet drejtpërsëdrejti dhe pa asnjë interpretim të ligjit, në kundërshtim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë Parimeve dhe Bazës së legjislacionit penal shqiptar.

Lidhur me këtë situatë, mbaj qëndrimin para Këshillit të Lartë Gjyqësor se fillimi i hetimit disiplinor dhe kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor, me pak fjalë i gjithë ky proces i Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, për këto aspekte hetimore dhe konkluzioni shkëlqesh drejtuar veprimtarisë sime gjyqësore si magjistrat, bie ndesh me nenin 100 të Ligjit 96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pika 1 (të gjitha gjerat e pikës 1); Bie ndesh me nenin 100 të Ligjit 96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pika 2, i cili sanksionon:

“2. Në balancimin e parimit të drejtësisë së hapur, parimit të konfidencialitetit, të drejtës për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat duhet të marrin parasysh veçanërisht: a) faktin që të garantohet mbrojtja e integritetit dhe figura e magjistratit nga akuzat e pabaza; b) rëndësinë që ka informimi i publikut në lidhje me akuzat e provuara në funksion të administrimit të drejtësisë”.

Në drejtimet e mësipërme, ilustruj për ju si Këshill i Lartë Gjyqësor, se Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka nxjerrë Vendimin “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit {...}”, në datë 1 ose 2 prill 2020 (data është e korrigjuar dhe nuk e kam të saktë), për sa fiksohet në përmbajtje të aktit të inspektorit me nr.313/7 prot. administruar nga ana Juaj si Këshill.

Mbështetur në aktet që Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, ka depozituar për këtë Këshill të Lartë Gjyqësor, me të cilat si magjistrat jam njohur vetëm në datën 22 shtator 2020, konstatoj se Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në momentin kur ka marrë vendimin për fillimin e hetimit disiplinor ndaj veprimtarisë time gjyqësore për një çështje konkrete, nuk ka patur në dispozicion Vendimin nr.41-2019-642 (1/54 DA), Datë vendimi 14.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, si dhe nuk ka patur në dispozicion as dosjen gjyqësore të çështjes të zgjidhur me këtë vendimmarrje nga gjykata e faktit dhe për më tepër as dosjen gjyqësore të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje në Gjykatën e Apelit Korçë.

Sa më sipër, rrethana që Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nuk ka patur në dispozicion Vendimin e plotë të arsyetuar nr.41-2019-642 (1/54 DA), datë vendimi 14.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë: - Faktohet nga përmbajtja e pikës 3.1

dhe pikës 5 të parashtrimit në përmbajtje të Vendimit “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit {...}”, si dhe pikës 3 të dispozitivit të këtij vendimi; Faktohet nga përgjigja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përmbajtje të akti/nr.313/33 prot., datë 11.05.2020 drejtuar magjistratit {...}, prej nga ku provohet se: Deri në momentin e marrjes së Vendimit “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit {...}”, në datë 1 ose 2 prill 2020, ky Inspektorat ka patur të administruar vetëm formatin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, të shpallur në seancë Gjyqësore të datës 14 shkurt 2020 (korrigjohet data) 14 shkurt 2019, me shkaqet kryesore mbështetëse, sipas zbatimit korrekt të kësaj veprimtarie gjyqësore të magjistratit nga sanksioni i nenit 384 të K.Pr.Penale, i cili rregullon se: “Vendimi shpallet në seancë nga kryetari ose një anëtar i trupit gjykues me anë të leximit të dispozitivit. Pas dispozitivit kryetari lexon vendimin e arsyetuar. Arsyetimi i vendimit mund të jepet me shkrim edhe në mënyrë të përmbledhur, duke treguar shkaqet kryesore mbi të cilat bazohet vendimi. Në këtë rast, gjykata u jep palëve në seancë vendimin e përmbledhur me shkrim”, si dhe është proceduar nga ana ime si gjyqtar dhe është proceduar që në vitin 2017 si çdo vendimmarrje të cilën e shoqëroj me vendim me shkaqet kryesore mbështetëse.

Në vijim, rrethana që Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka patur në dispozicion në momentin kur ka nxjerrë Vendimin “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit {...}”, në datë 1 ose 2 prill 2020, as dosjen gjyqësore të çështjes të zgjidhur me këtë vendimmarrje nga gjykata e faktit dhe për më tepër as dosjen gjyqësore të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje në Gjykatën e Apelit Korçë, provohet nga përmbajtja e pikës 3 të dispozitivit të këtij vendimi.

Në drejtimet e mësipërme provohet se vetëm në datë 02.04.2020 ILD me shkresën nr.313/9 prot ka paraqitur kërkesën para Gjykatës së Lartë për vendosjen në dispozicion të këtyre akteve, ndërkohë që këto akte i janë vendosur në dispozicion Inspektoratit vetëm në datë 27 prill 2020, në mbështetje të shkresës nr.710/1 prot. datë 08.04.2020 të Gjykatës së Lartë.

Vendos nën vërejtjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, se ILD ka administruar kryesisht Vendimin nr.79, datë vendimi 26.06.2019 të Gjykatës së Apelit Korçë, që sipas përmbajtjes së pikës 3.1 të parashtrimit në Vendimin “Për fillimin e hetimit disiplinor...” këtë veprimtari e justifikon si: "Ndërkohë Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në kuadër të

Inspektimit tematik të Gjykatave dhe të Zyrave të prokurorive pranë tyre, mbi trajtimin e kërkesave me objekt “Lirim me kusht”, është vënë në dijeni të faktit se vendimi 41-2019 – (mungon numri sepse nuk është patur në dispozicion vendimi i arsyetuar i plotë) (1/54 DA), datë 14.02.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, është ndryshuar me Vendimin nr.79, datë 26.06.2019 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe është vendosur: "Rrëzimi i kërkesës së kërkuarit “x” për lirim me kusht.

Në kuadër të procesit ligjor, duke e konsideruar parregullsi në këtë proces.

Për gjithë sa u parashtrua, konkludohet fare qartë se, ILD në momentin e nxjerrjes së vendimit për fillimin e hetimit disiplinor ndaj meje si magjistrat, nuk ka patur në dispozicion vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës, por vetëm vendimmarrjen me shkaqet kryesore mbështetëse, të shpallur në seancë gjyqësore, sipas sanksionit të nenit 384 të K.Pr.Penale.

Ndërkohë inspektorati i Lartë i Drejtësisë ka patur në dispozicion vetëm ankesën e Ministres së Drejtësisë dhe aktet bashkëlidhur saj, por nuk ka patur në dispozicion Vendimin e Gjykatës së Apelit Korçë, të cilin e ka administruar kryesisht, e theksoj kryesisht, nga një tjetër proces shqyrtues dhe tematik në përmbushje të detyrave funksional, proces i cili nuk lidhet me procedurën dhe vendimmarrjen për fillimin e hetimit disiplinor.

Kjo mënyrë e menaxhimit të procesit nga ana e ILD-së, vjen në kundërshtim me gjithë piken 1 të nenit 100 të Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi është cenuar e drejta për një provës të rregullt, sanksionuar nga germa a) e këtij neni.

ILD duke mos patur në dispozicion arsyetimin e gjykatës së faktit, nuk ka qenë e njohur me natyrën ligjore të zgjidhjes se çështjes.

Në vijim, duke administruar kryesisht vetëm vendimin e Gjykatës së Apelit Korçë dhe jo procesin që ka çuar në këtë vendimmarrje, nuk ka qenë në gjendje të verifikojë dhe ballafaqojë realitetin objektiv procedural dhe material për secilën zgjidhje të rastit kërkimor të gjykuar në të dy këto shkallë gjykimi.

Për rrjedhojë ka cenuar plotësisht parimin e ligjshmërisë në kuptimin që organi kompetent ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore si dhe parimin e mosdënimit të paligjshëm.

Fakti procedimor i ILD-së, në cenim të këtij parimi është i vërtetuar. Për sa kohë natyra ligjore e zgjidhjes së çështjes nga ana e gjykatës së faktit, për gjithë sa është parashtruar në këtë mbrojtje, është tërësisht e ndryshme nga natyra ligjore që prezanton Gjykata e Apelit Korçë në vlerësimin e zgjidhjen e saj, ku mungon plotësisht kundërshtimi, apo vlerësimi i kundërt me atë çfarë gjykata e faktit dhe unë si gjyqtar i çështjes kam parashtruar për zgjidhje dhe kam zgjidhur.

Në rast se ILD do të kishte në dispozicion së paku arsyetimin e gjykatës së faktit, do të kishte konstatuar se zgjidhja e çështjes nga Gjykata e Apelit Korçë, nuk kishte aspak lidhje konceptuale me zgjidhjen e çështjes nga gjykata e faktit.

Pra këto dy vendimmarrje ndahen diametrikisht për këtë koncept trajtues dhe zgjidhës, ku gjykata e faktit referon tek zbatimi i KEDNJ-së dhe përcaktimet e Statutit të Romes, sipas të cilës çdo i dënuar me burgim të përjetshëm duhet të ketë të drejtën e një rishikimi periodik të dënimit nëpërmjet institutit të lirimit me kusht brenda një afati minimum 25-vjeçar, kurse gjykata e apelit referon tek legjislacioni vendas, konkretisht neni 64, paragrafi i 3-të i Kodit Penal, duke mbajtur qëndrimin se i dënuari me burgim të përjetshëm nuk duhet të lirohet me kusht pasi rezulton përsëritës për krim të kryer me dashje, duke shmangur plotësisht referencat ligjore në trajtim dhe zgjidhje të rastit për gjykim të aplikuara nga gjykata e faktit.

ILD në këtë rast duhej të kishte konstatuar se gjykata e apelit nuk paraqiste asnjë argument se përse duhej të zbatohet neni 64-3 i Kodit Penal nga gjykata e faktit, për këtë rast kërkimi lirimi me kusht, ndërkohë që në qëndrimin e saj zgjidhës kjo gjykatë apeli nuk kontestonte për asnjë rrethanë, natyrën trajtuese ligjore të gjykatës së faktit mbështetur në të drejtën pozitive ndërkombëtare, e cila rezultonte dhe rezulton e aplikueshme si pjesë e së drejtës pozitive vendase dhe e detyrueshme për zbatim në zgjidhje të çështjes.

Për me tepër deri në këto momente, për sa parashtrova, si magjistrat nën procedim disiplinor, vijoj të mbetem pa shpjegim të detyrueshëm mbi rastin procedimor se: Çfarë përfaqëson kjo mënyrë sjelljeje e ILD-së edhe pas njohjes prej saj të natyrës zgjidhëse të çështjes nga gjykata e faktit, duke mbetur ky Inspektorat në të njëjtat pozita edhe në vijim, si dhe aktualisht.

Në përgjigje të kësaj situate, si magjistrat mund të ekspozoj për këtë Këshill të nderuar se, e drejta e Inspektoratit për të filluar procedimin disiplinor ndaj magjistratit, kur një vendimmarrje e tij cenohet nga një gjykatë më e lartë, si dhe është proceduar në rastin konkret nga Gjykata e Apelit, nuk mund të jetë e pakufizuar dhe gjithëpërfshirëse për çdo rast ngjarje juridiko-procedural e të këtij lloji.

Vendimet e gjykatave më të ulëta janë cenuar dhe do vijojnë të cenohen, por kjo nuk përbën të vetmin kusht dhe kriter ligjor për të qenë i legjitimuar ILD të fillojë hetime disiplinore ndaj magjistratëve, përveçse kur konstatohen shkelje të ligjit, që gjenden tej parimeve të sanksionuara me zbatim të detyrueshëm nga neni 100 i ligjit nr. 96/2016 për këtë lloj vlerësimi.

Kjo gjendje fakti, që lidhet me shkakun ligjor të trajtuar nga gjykata e shkallës së parë për zgjidhjen e kërkesës penale, për sa rezulton nuk është patur parasysh as nga ILD, e cila ndodhet në të njëjtat pozita me Gjykatën e Apelit Korçë.

ILD ka vepruar në kundërshtim me nenin 121/1 të Ligjit 96/2016, i cili detyron atë të shqyrtojë fillimisht nëse ankesa është ose jo e pranueshme, si dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 122 të po këtij Ligji, pasi rezulton qartë se aktet që kanë qenë bashkëlidhur ankesës në momentin e depozitimit të saj dhe deri në momentin e vlerësimit të paanshmërisë ose jo të saj si ankesë, nuk mbështesnin asnjë prej rrethanave të parashtruara në të, që të mundësojnë fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit.

Për sa rezulton, ankesa ka patur bashkëlidhur saj: Vendimin me shkaqet kryesore mbështetëse të gjykatës së faktit, që si u parashtrua nuk përmban arsyetimin e plotë të kësaj gjykate; Vendimin nr. 14 akti, datë 10.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vendimin nr. 104 akti, datë 02.03.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilat lidhen me procesin e njohjes së vendimit penal të huaj dhe llogaritjen e kohës së vuajtur me dënim nga i dënuari me burgim të përjetshëm, si dhe Vendimin unilikues nr.4/2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Asnjë prej këtyre akteve nuk mbështeste dhe nuk mbështet ankesën.

Asnjë prej këtyre akteve nuk ka qenë i vlefshëm për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë të përmbushë detyrimin që ka për të proceduar në mbështetje të sanksionit të neneve 100, 121 dhe 122 të Ligjit 96/2016.

Si magjistrat, të cilit i është njoftuar vendimi i fillimit të hetimit disiplinor, kam kundërshtuar paligjshmërinë e këtij procesi që në momentet më të para të tij, për sa referon përmbajtja e aktit me nr. 102 prot, datë 24.04.2020 drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilin ju si Këshill i Lartë Gjyqësor e dispononi dhe ju lutem t'i referoheni specifikisht asaj përmbajtjeje me argumentat në konkluzion se:

Nuk kam qenë në gjendje dhe nuk më është krijuar mundësia të perceptoj ligjshmërinë e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e hetimit disiplinor, pasi për sa është parashtruar në mënyrë specifike mungon specifikimi/relatimi i faktit të dyshuar dhe/ose vlefshmëria/analiza e tij, në përmbajtje të Vendimit "Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë" dhe për rrjedhojë nuk jam në gjendje të çmoj elemente të ligjshmërisë së procesit hetimor disiplinor apo nëse është respektuar ose jo apo do respektohet ose jo neni 6 etj., i KEDNJ-së, procesi i rregullt ligjor etj., ndaj meje si magjistrat.

Nuk kum asnjë mundësi/nuk më është dhënë mundësia të evidentoj specifikisht shkeljet që më atribuohen. apo të perceptoj korrektesisht përmbajtjen e tyre, pra sasinë dhe cilësinë e secilës prej tyre.

Nuk jam në gjendje të perceptoj, nuk më është saktësuar se cilat janë provat apo faktet në përmbajtje të tyre, që mbështesin paraprakisht dyshimin e arsyeshëm për fillimin e hetimit disiplinor dhe vetë nevojën për hetim disiplinor.

Nuk jam në gjendje, më është hequr e drejta të njihem me "akuzat" specifike paraprake, në mënyrë të qartë dhe pa mëdyshje, për të cilat dyshohem si në shkelje të ligjës dhe për rrjedhojë, nuk më është dhënë mundësia të çmoj dhe/ose ezauroj nevojën për një mbrojtje efektive dhe të vlefshme, mbështetur në praktikë transparente, të paanshme dhe të ndershme nga ana e ILD-së, jashtë ndikimeve personale, mediatike dhe/ose politike të personave në detyrë ose jo, që mund të kenë interes negativ dhe jo ligjor në këtë proces.

Në rrethana të tilla faktike, juridike dhe procedimore, për gjithë sa është parashtruar, konstatoj/konkludoj lidhur me përmbajtjen e Aktit zyrtar Vendimit "Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit {...}...", Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, nuk paraqitet me ruajtje të balancës për raportin fakt/analizë/konkluzion, duke i mëshuar vetëm konkluzionit, gjendet në inkoherencë mbi faktin, prezumimin e analizës mbi të si

fakt dhe me doza të forta të paragjyqimit të konkluzionit, në terma negativ, kundrejt veprimtarisë time gjyqësore të relatuar dhe/ose me koncept të pritshmërisë së zgjidhjes pozitive të Ankesës së Ministrisë së Drejtësisë-Ministrit.

Plotësimi dhe sqarimi i kërkuar nga ana ime si magjistrat nën hetim disiplinor dhe/ose në lidhje/funksion me këtë hetim disiplinor, i çdo grup situatë, nëpërmjet dhënies së përgjigjes sqaruese, dokumentuese, orientuese, faktike, konceptuale, të drejtpërdrejtë, transparente, në mënyrë të analizuar, reale dhe specifike, nga ana e ILD-së, për çdo pyetje specifike/konkrete të parashtruar, pa anashkaluar asnjë prej tyre, përveç sigurimit të kushteve dhe kriterëve për një proces të rregullt të hetimit disiplinor, do të rivendoste balancën midis faktit/analizës dhe konkluzionit, në raport me të drejtat e mia si magjistrat në këtë proces hetimor disiplinor, duke me mundësuar të vlerësoj ezaurimin/përmbushjen e detyrave të mia në këtë proces, si dhe për vetë ILD-në që me keqardhje konstatoj se nuk ka mbajtur parasysh asgjë nga këto që kërkohen për respektim të detyrueshëm nga ligji organik.

Gjithë sa më sipër janë artikuluar nga ana ime në datën 22 prill 2020.

Për sa rezulton, si magjistrat paraqitem edhe në këto momente në të njëjtën pozitë.

Sa më sipër ILD provohet se ka vepruar në kundërshtim me germën c) të pikës 1 të nenit 100 të Ligjit 96/2016, duke cenuar parimin e akuzës. Në kuptimin që çdo institucion shtetëror ose zyrtar duhet të veprojë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore, pasi prova të tilla nuk ka patur dhe për sa rezulton nuk ka.

Si magjistrat, ndaj të cilit kërkohet fillimi i procedimit disiplinor, konstatoj se ILD ka vepruar dhe po vepron në mënyrë të njëanshme dhe e intimiduar nga një presion politik dhe mediatik i pajustificuar në lidhje me rastin.

Rezulton se hetimi disiplinor ka nisur mbi ankesën e Ministrit të Drejtësisë, referuar sanksionit të nenit 119, pika 2, germa a) të Ligjit 96/2016.

Referuar sanksionit të nenit 120 të Ligjit 96/2016, në asnjë rrethanë nuk parashikohet që ankuesi në përmbajtje të ankesës të parashikojë apo propozojë për ILD-në, masën disiplinore që kërkon ndaj magjistratit, duke mos qenë kjo rrethanë kusht për vlefshmërinë e ankesës.

Duke iu referuar përmbajtjes së ankesës së Ministres së Drejtësisë, kjo rrethanë paraqet këtë formulim: “Në përfundim të procedimit disiplinor, Këshilli i Lartë Gjyqësor pasi të këtë shqyrtuar raportin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit të sipërcituar, të marrë masën disiplinore të “shkarkimit nga detyra”, në bazë të nenit 140 të Kushtetutës.

Për sa u citua kjo përmbajtje, ankuesi as që e vendos në diskutim se çfarë përfundimi do të këtë Raporti hetimit disiplinor dhe urdhëron këtë Këshill të nderuar të marrë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra ndaj "gjyqtarit të sipërcituar", e theksoj “gjyqtarit të sipërcituar”.

Kjo terminologji kërkimi, përveç gjuhës së urrejtës, përmban një mungesë të plotë etike ndaj meje si magjistrat dhe më tej, e cila është ekzekutuar më së miri edhe nga ana e ILD-së dhe që shpjegon mungesën e ndërveprimit të detyrueshëm të ILD-së me magjistratin gjatë fazës së hetimit disiplinor në respektim të kërkesave të nenit 129, 130 dhe 131 të Ligjit 96/2016, si dhe mosrespektimin e asnjë prej kërkesave të nenit 100 të po këtij Ligji.

Ilustroj se: Rezulton se Vendimi për fillimin e hetimit disiplinor, është mbështetur në sanksionin e nenit 123 dhe 124 të Ligjit 96/2016, ku neni 123 referon në fillimin e hetimit disiplinor mbi ankesë, kurse neni 124 referon në fillimin e hetimit disiplinor me iniciativën e vetë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Vendos nën vërejtjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, se në përmbajtje të Vendimit për fillimin e hetimit disiplinor, nuk ekziston asnjë rrethanë mbi të cilën të iniciohet perceptohet apo të argumentohet fillimi i hetimit disiplinor me iniciativën e vetë inspektorit. Pra kjo arsye nuk është prezent në këtë vendimmarrje përveç ekzistencës formale të nenit 124 të ligjës.

Neni 124 i Ligjit 96/2016 sanksionon, se:

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. Informacionet që përfitohen nga media ose nga ankues anonimë mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht nëse përmbushen kriteret e parashikuara në nenin 120, pika 1, shkronjat “b”, “ç”, “d” dhe “dh”.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos me vendim të arsyetuar për fillimin e hetimit me

iniciativën e tij, duke parashtruar rrethanat faktike të verifikueshme.

3. Rregullat e parashikuara në pikat 2 deri në 4, të nenit 123, të këtij ligji, zbatohen edhe në rastin e fillimit të hetimit me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në rrethana të tilla, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk rezulton të këtë patur të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer.

Vetë ankuesi, nuk ka vendosur në dispozicion të ILD-së asnjë provë të vlefshme për këtë proces besueshmërie se shkelja mund të këtë ndodhur, përveçse fillimi i hetimit disiplinor me iniciativë të vetë Inspektorit, të jetë mbështetur, duke konsideruar si burim të besueshëm vetë Ministrin e Drejtësisë.

Arsye dhe provë tjetër nuk ka që të justifikojë dhe mbështesë këtë mënyrë sjelljeje të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili nga aktet që administroj si magjistrat, nuk mund të provojë para këtij Këshilli të nderuar, ligjshmërinë e procesit nga këndvështrimi i nenit 124 të Ligjit 96/2016, duke cenuar në këtë mënyrë parimin e prezumimit të pafajësisë dhe atë të barazisë para ligjit, të sanksionuar nga germa d) dhe ç) të pikës 1 të nenit 100 të këtij ligji.

Në këtë kontekst është e qartë që si magjistrat as që mund të pretendoj respektimin nga ILD të parimit e dyshimit në favor të magjistratit, subjekt i procedimit disiplinor, sanksionuar nga germa dh) e pikës 1 të nenit 100 të këtij ligji.

Është shumë e rëndësishme të ekspozoj para Këshillit të Lartë Gjyqësor, besueshmërinë ligjore të Ankesës së Ministrisë të Drejtësisë dhe të vetë veprimtarisë shtetërore të personit në këtë detyrë, në lidhje me rastin objekt kërkimi për fillimin e procedimit disiplinor ndaj veprimtarisë sime gjyqësore si magjistrat.

Është fakt se si magjistrat, që prej momentit të zgjidhjes së çështjes, jam vendosur në një presion të paprecedent shtetëror dhe mediatik, në kundërshtim me çdo rregull të njohur, që lidhet me respektimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe moscenimit pa shkak dhe arsye të figurës së magjistratit.

I ndodhur në këto pozita i jam kthyer shumë herë procesit, për të verifikuar veprimtarinë time gjyqësore, por nuk kam gjetur asnjë problematikë e cila të justifikonte këtë reagim shtetëror si dhe atë reagim mediatic, që për asnjë rast nuk jam në dijeni të ketë patur ndonjë trajtim specifik juridik profesional ose jo, që mund të vendoste potencialisht në dyshim zgjidhjen e çështjes.

Më ka bërë shumë përshtypje fakti që Ministri i Drejtësisë edhe pse nuk kishte në dispozicion vendimin e arsyetuar të gjykatës së faktit, pra duke mos qenë i njohur me rrethanat ligjore të zgjidhjes së çështjes, në datë 20 shkurt 2019 sulmon padrejtësisht gjyqtarin në media dhe e konsideron zgjidhjen e rastit për gjykim si në kundërshtim flagrant të ligjit, ndonëse vendimi i gjykatës me shkaqet kryesore mbështetëse kishte referencë të qartë në nenin 7 të KEDNJ-së dhe praktikën e GJEDNJ-së.

Denoncoj këtë qëndrim të Ministrisë të Drejtësisë, pasi mbështetur në çdo parimi të shtetit të së drejtës, ndarjes së pushteteve dhe ndërvaresinë që rrjedh nga parimi kontrollo dhe balanco, ky qëndrim është vetëm politik dhe një ndërhyrje e hapur flagrante e pushtetit ekzekutiv në veprimtarinë e pushtetit gjyqësor, të cilin askush nuk mori guximin ta kundërshtonte.

Shkaqet dhe arsyet lidhen ekzaktësisht me përmbajtjen e Ankesës së Ministrisë të Drejtësisë drejtuar Inspektoratit.

Ministri i Drejtësisë ankon, se: Kërkuesi i lirit me kusht, paraqitet i dënuar për dy vepra penale. Kërkuesi i lirit me kusht nuk ka vuajtur 35 vjet burgim, për të patur të drejtën e paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht. Gjyqtari ka vepruar në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 4/2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pasi nuk mund të zbatonte normën e para ndryshimit të saj, kur kjo e drejtë për paraqitjen e kërkesës për lirim me kusht nga 25 vjet ishte ndryshuar në 35 vjet.

Duke ndjekur zhvillimet në media, jam njohur me një shkrim të portalit Bold News i cili referonte në faktin e përdorimit të Vendimit gjyqësor të dhënë nga ana ime si magjistrat, nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, shkrim të cilin e keni të administruar në provat e vendosura në dispozicion të këtij Këshilli nga ana ime si magjistrat.

Në këtë rast ky portal kishte të ekspozuar edhe rastin për gjykim, që referonte në një vendimmarrje të Gjykatës së Apelit të Hagës, Holandë.

Kam kryer procesin e njohjes me këtë vendimmarrje në faqen zyrtare të gjykatës (tuaj), e cila mban numrin (të cilin nuk po e citoj - numri i fundit 606/01, akt gjykimi i datës 12.02.2019, pra dy ditë para se si gjyqtar të shpallja vendimin përkatës që daton 14.02.2019.

Çështja referon në ankesën e Ministrisë së Drejtësisë dhe Sigurisë së Holandës kundër një shtetasi shqiptar dhe për sa rezulton, për të mundësuar ekstradimin e këtij të fundit nga Holanda për në Republikën e Shqipërisë, si procedurë e refuzuar nga gjykata e shkallës së parë në këtë shtet.

Tërheq vëmendjen, në përmbajtje të kësaj vendimmarrjeje, qëndrimi i Ministrisë së Drejtësisë dhe Sigurisë të Holandës, i reklamuar nga gjykata si: “Shteti pranon se neni 65 i Kodit Penal ka ndryshuar në këtë drejtim, por argumenton se kjo dispozitë në pajtim me nenin 3, paragrafi i tretë i Kodit Penal, nuk aplikohet për shtetasin shqiptar. Shtetasi shqiptar u dënua me burgim të përjetshëm për vrasjen e një polici, që dënohet me nenin 79/b të Kodit Penal. Nëse neni 65 i Kodit Penal, në versionin e tij aktual, aplikohet ndaj tij, ai nuk do të jetë i legjitimuar për lirim nga burgu. Është e qartë se neni i ri 65 i Kodit Penal, kërkesat e vendosura nga KEDNJ mbi rivlerësimin e një të dënuari të përjetshëm i shpërfill në mënyrë flagrante. Jo vetëm që është periudha, pas së cilës një vlerësim i tillë duhet të behet për 10 vjet më shumë se periudha maksimale në të cilën GJEDNJ quan si parim (jam munduar ta përkthej sa më korrektësisht, por aq kam mundur)... Shteti ka argumentuar se neni 65 i Kodit Penal është ndryshuar me ligjin nr.36/2017 të 30 marsit 2017 dhe se aplikohet versioni i vjetër i nenit 65, pasi vrasja për të cilën shtetasi shqiptar është dënuar është kryer në “x” datë . Shteti bazohet në nenin 3, paragrafi i 3-të të Kodit Penal, i cili parashikon: “Kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale”.

Gjykata nuk është e bindur se neni 3, paragrafi i 3-të i Kodit Penal në fjalë, vërtet nënkupton se versioni i vjetër i nenit 65 të Kodit Penal duhet të aplikohet për gjendjen e shtetasit shqiptar. Ky është një nen 3, paragraf i 3-të i Kodit Penal dhe jo një dispozitë kalimtare, që në mënyrë specifike i referohet ligjit të 30 marsit 2017, as ndonjë dispozitë që në mënyrë eksplicite i referohet ekzekutimit të dënimit, tashme të dhënë nga gjykata. Ky është një parim i përgjithshëm i së drejtës penale, e cila nuk ilustron që të ekzistojë,

apo të zbatohet për ekzekutimin e dënimit të përjetshëm. Juridiksioni që mund të konfirmonte qëndrimin e shtetit nuk u ngrit. Ishte momenti që shteti të paraqiste për të treguar pozicionin e tij se ligji kalimtar është i saktë. Tani versioni i ri i nenit 65 të Kodit Penal, përbën një shkelje flagrante të nenit 3 të KEDNJ-së dhe baza e vetme kundër të cilit shteti mund të bazohet për ekstradimin e shtetasit shqiptar është mjaft i qartë se do të aplikohet vetëm me versionin e vjetër ndaj tij nga autoriteti kompetent për rivlerësim.

Tani në përmbajtje të kësaj vendimmarrjeje, vjen pjesa më e rëndësishme, që lidhet drejtpërsëdrejti me besueshmërinë e ankesës së Ministrit të Drejtësisë dhe vetë ligjshmërisë së këtij procedimi disiplinor sipas këndvështrimit të ILD-së, e artikuluar nga Gjykata e Apelit të Hagës, Holandë si: “Thjesht Deklarata e autoriteteve shqiptare se versioni i vjetër i nenit 65 të Kodit Penal është në pajtim me nenin 3, paragrafi i 3-të të Kodit Penal dhe duhet të aplikohet, është në çdo rast e pamjaftueshme. Tani për Shqipërinë, neni më i fundit 65 i Kodit Penal është ndryshuar në një mënyrë që është në kundërshtim flagrant me nenin 3 të Konventës, pra ajo mund të bazohet vetëm në princip”.

Përveç kësaj, në vijim, autoritetet shqiptare, duke përfshirë argumentat e vëna në letrën e datës 22 maj 2018 (etj., etj. nuk po e citoj vendimin të plotë)... Por për sa u parashtrua, tërheq vëmendjen, se letra e datës 22 maj 2018 rezulton qëndrimi i shtetit shqiptar i reklamuar pranë gjykatës së një juridiksioni të huaj, duke garantuar se për rastet e lirimit me kusht të të dënuarve me burgim të përjetshëm do të aplikohet (e lexova të gjithën, është shumë e rëndësishme sepse gjithçka kam argumentuar dhe në përmbajtje të vendimmarrjes time për rastin objekt procedimi disiplinor, pa njohur aspak këtë lloj argumenti të bërë nga gjykata e huaj, pasi s’kisha nga ta dija)... pra edhe një herë, për sa u parashtrua, letra e datës 22 maj 2018 rezulton qëndrimi i shtetit shqiptar i reklamuar pranë gjykatës së një juridiksioni të huaj, duke garantuar se për rastet e lirimit me kusht të të dënuarve me burgim të përjetshëm do të aplikohet versioni i vjetër i nenin 65 të Kodit Penal, i cili parashikonte plotësimin e kriterit ligjor prej 25 vjet dënim, për të paraqitur i dënuari kërkesën për lirim me kusht dhe se nuk do aplikohet versioni i ri i këtij neni, për këtë kriter në masën 35 vjet.

Pra ky ka qenë qëndrimi i shtetit shqiptar që para dhënies së vendimit nga ana ime si gjyqtar, i cili daton 14 shkurt 2019.

Në këtë rast, shteti shqiptar ka qenë i mirinformuar se garancitë e tij për aplikimin e dispozitës së vjetër të nenit 65 të Kodit Penal, me argumentat përkatës, nuk janë marrë parasysh nga gjykata.

Në vijim, referuar përmbajtjes arsyetuese dhe argumentave të paraqitura nga ana ime si gjyqtar, në vendimmarrjen e datës 14 shkurt 2019, objekt vlerësimi disiplinor, në raport me ankesën e Ministrit të Drejtësisë drejtuar Inspektoratit për këtë vendimmarrje, konstatohet lehtësisht se ky qëndrimi shtetit shqiptar dhe garancitë e dhëna për aplikimin e versionit të para ndryshuar të nenit 65 të Kodit Penal, para një gjykate të huaj, vijnë në të kundërt të këtij qëndrimi zyrtar.

Rezulton se vendimmarrja e marrë nga Gjykata e Apelit të Hagës, sipas aktgjykimit të datës 12 shkurt 2019 të sipërcituar është bërë procedurë rivlerësuese edhe njëherë nga gjykata, tashmë mbi ankimin e shtetasit shqiptar, për sa rezulton pasi me urdhrin e datës 27 shkurt 2019, Ministri i Drejtësisë dhe Sigurisë së Holandës, pasi ka marrë informacione të mëtejshme nga autoritetet shqiptare, ka autorizuar edhe njëherë ekstradimin e këtij shtetasi në Shqipëri.

Vendimmarrja e Gjykatës së Hagës, i referohet aktgjykimit të datës 15 maj 2019, e cila po referohet nga ana ime si magjistrat nën kërkim për fillimin e procedimit disiplinor, pasi i jep zgjidhje çdo shtet dhe insinuate të reklamuar nga ILD në përmbajtje të Raportit të hetimit të vendosur në dispozicion të këtij Këshilli të nderuar.

Gjykata e Hagës arsyeton, si:

4 Vlerësimi i mosmarrëveshjes -

4.1. Rasti aktual ka të bëjë me procedurën e dytë përmbledhëse pas kërkesës së autoriteteve shqiptare për ekstradimin e shtetasit shqiptar. Procedura e parë u zhvillua në dy seanca, në shkallë të parë, gjyqtari i seancës paraprake ndaloi ekstradimin e shtetasit shqiptar sepse kjo do të çonte në një shkelje (përfundimtare) të nenit 3 KEDNJ, pasi kriteret për lirimin e një personi të dënuar me burgim të përjetshëm në Shqipëri janë shumë të paqarta për t'u pajtuar me kërkesat e vendosura ndaj tyre sipas praktikës Gjyqësore të GJEDNJ dhe Gjykatës Supreme (i referohet Gjykatës në Holandë). Ky vendim u mbështet në apel. Sipas gjykatës së apelit ekzistojnë tre arsye:

-është e paqartë nëse versioni i vjetër i nenit 65 të Kodit Penal shqiptar, i ndryshuar në 2017, do të zbatohet për ekzekutimin e dënimit të përjetshëm të vendosur ndaj shtetasit shqiptar;

-kriteret e përdorura në Shqipëri për rivlerësimin e dënimeve të përjetshme nuk njihen sa duhet;

-nuk mund të konkludohet se ekziston një mekanizëm në Shqipëri që vlerëson aftësinë e personave të dënuar me burgim të përjetshëm për lirim.

Sipas mendimit të Gjykatës, mbi këtë bazë, duhet të konkludohet (përkohësisht) se ligjet dhe rregulloret shqiptare nuk plotësojnë kërkesat e nenit 3 të GJEDNJ-së. Gjykata shton se për secilën nga tre arsyt është e mjaftueshme ndalimi i ekstradimit të shtetasit respektiv shqiptar.

Në vlerësimin e procedurës përmbledhëse të tanishme (të dytë), së pari do të vlerësohet nëse këto tre kundërshtime - të gjykuara nga gjykata e apelit - për ekstradimin e shtetasit shqiptar tani janë zgjidhur. Sipas shtetit, kjo është çështja; në fakt, vendimi i Ministrit i 27 shkurtit 2019 bazohet vetëm në këtë. E kundërshton këtë dhe e bazon atë në bazë të kërkesës së tij siç përmendet në paragrafin 3.2 sipas pikës 1 më lart. Konsideratat kryesore të gjykatës, të cilat për këtë arsye e udhëheqin këtë bazim, janë si më poshtë:

Neni 65 i Kodit Penal shqiptar deri së fundmi pohon (në përkthimin në anglisht):

"I dënuari që vuan burgim të përjetshëm nuk lejohet të lirohet me kusht, vetëm në rrethana të jashtëzakonshme i dënuari që vuan dënim in me burg të përjetshëm lirohet me kusht, nëse: Ai ka vuajtur jo më pak se njëzet e pesë vjet burg dhe gjatë periudhës së vuajtjes së tij subjekti ka treguar sjellje të shkëlqyeshme dhe vlerësohet se është arritur qëllimi edukativ i subjektit.

Shtetasi shqiptar ka theksuar se neni 65 K.Penal është ndryshuar kohët e fundit dhe tani citon si më poshtë:

"I dënuari që vuan burgim të përjetshëm nuk lejohet të lirohet me kusht, vetëm në rrethana të jashtëzakonshme i dënuari që vuan dënimin me burg të përjetshëm... dhe citohet neni, që mos e përsëris.

Shteti e pranon se neni 65 i K.Penal është ndryshuar në këtë kuptim, por argumenton se kjo dispozitë kërkohet sipas nenit 3 paragrafi 3 i K.Penal dhe nuk vlen për pretendimit të shtetasit shqiptar që thotë po u ekstradova duhet të ... 35 vjet.

Shtetasi shqiptar është dënuar me burgim të përjetshëm për vrasjen e një oficeri policie, që është një veprë penale sipas nenit 79/b të K.Penal, nëse neni 65 K.Penal i aplikohet atij në versionin e tij aktual. Kështu, që ai nuk do të kishte të drejtë për lirim.

Është e qartë se neni i ri 65 i K.Penal injoron në mënyrë flagrante kërkesat që GJEDNJ vendos për rivlerësimin e një personi të dënuar i cili është dënuar me burgim të përjetshëm. Jo vetëm që periudha pas së cilës një vlerësim i tillë bëhet 10 vjet më e gjatë se periudha maksimale e parimit të GJEDNJ-së, por gjithashtu nuk është e mundur të lirohen kategori të caktuara të krimeve, përfshirë krimin për të cilin shtetasi shqiptar është dënuar. Shteti ka argumentuar sipas nenit 65 të K.Penal që është ndryshuar me Ligjin nr.36/2017 të 30 marsit 2017 dhe se tani aplikohet me versionin e vjetër të nenit 65, pasi vrasja për të cilën shtetasi shqiptar është dënuar është kryer në datën __ (po referoj vetëm vitin 2013). Shteti e bazon veten në nenin 3, paragrafi 3 të K.Penal që parashikon:

"Nëse ligji në fuqi në kohën kur është kryer vepra penale dhe ligji pasues janë të ndryshëm, do të zbatohet ligji, dispozitat e të cilit janë me të favorshme për personin që ka kryer veprën penale".

Megjithatë, -thotë Gjykata e Hagës, gjykata nuk është e bindur që neni i përmendur 3 paragrafi 3 i K.Penal me të vërtetë do të thotë se versioni i vjetër i nenit 65 K.Penal do të zbatohet për situatën e shtetasit shqiptar. Ka të bëjë me nenin 3, paragrafi 3 të K.Penal jo për një dispozitë kalimtare që lidhet posaçërisht me Ligjin e 30 marsit 2017, as për një dispozitë që ka të bëjë në mënyrë të qartë në ekzekutimin e një dënimi të vendosur tashmë nga gjykata.

Ky është një parim i përgjithshëm i ligjit penal që nuk është gjetur të jetë ose duhet të zbatohet për ekzekutimin e një dënimi të përjetshëm. Ligji gjyqësor që mund të konfirmojë pozicionin e shtetit nuk nevojitet. Do të kishte qenë në sjelljen e shtetit të demonstroi se pozicioni i tij në lidhje me ligjin kalimtar është i saktë, tani që versioni i ri i nenit 65 e K.Penal është një shkelje e qartë e nenit 3 të KEDNJ, do të thotë, dhe në këtë sfond, shteti mund të bashkëpunojë vetëm në ekstradimin e shtetasit shqiptar nëse është mjaftueshëm e qartë paraprakisht që autoriteti kompetent për rivlerësim do të aplikojë vetëm versionin e vjetër për të. Ky nuk është rasti me gjendjen aktuale të situatës. Njoftim i thjeshtë nga autoritetet shqiptare, se versioni i vjetër i nenit 65 të K.Penal do të zbatohet në përputhje me nenin 3, paragrafi 3 të K.Penal është në çdo rast i

pamjaftueshëm. Shqipëria shumë afër kohët e fundit ka ndryshuar nenin 65 të K.Penal në një mënyrë që është në shkelje të qartë të nenit 3 të GJEDNJ, parimi i mbrojtjes së legjitimitetit.

Për më tepër, sa vijon, në letrën e lartpërmendur të 22 majit 2018, autoritetet shqiptare sqaruan, ndër të tjera, kriteret e përdorura për të vlerësuar nëse 'sjellja shembullore' (ose sjellje e shkëlqyer) në kuptimin e nenit 65 të K.Penal. Nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme të 5 korrikut 2016 (shiko çështjen Vinter kundër Mbretëria e Bashkuar – provat e paraqitura) ndërsa duhet të jetë mjaft e qartë për të dënuarin në kohën e dënimit të përjetshëm se kriteret objektive do të zbatohen në rivlerësim në mënyrë që ai të dijë se cilat kërkesa do të duhet të plotësohen dhe të kualifikohet për këtë (në këtë rast i referohet çështjes Trabelsi kundër Belgjikës) ku kërkohet: “Një mekanizëm rishikimi që kërkon nga autoritetet kombëtare të konstatojnë, mbi bazën e kriterëve objektive, të paracaktuara të të cilave i burgosuri kishte njohje të saktë në kohën e shpalljes të dënimit me burgim të përjetshëm, nëse gjatë vuajtjes së dënimit i burgosuri ka ndryshuar dhe përparuar në një masë të tillë që paraburgimi i vazhdueshëm nuk mund të justifikohet më mbi baza legjitime penologjike. Nuk ka asnjë provë që kriteret e përcaktuara në letrën e 22 majit 2018 janë shpallur në atë mënyrë që të sigurojnë që personat e dënuar me burgim të përjetshëm, siç është shtetasi shqiptar të mund të njihen me to, as nuk është deklaruar ose treguar se dhe në çfarë mënyrë shtetasi shqiptar ishte në gjendje të njohjes së bindjes se tij. Në çdo rast, nuk është e mjaftueshme të përcaktohen kriteret që do të përdoren në një letër që paraqitet si produkt në këtë çështje, në të cilën nuk është në asnjë mënyrë e mundur të kontrollohet nëse këto janë me të vërtetë rregulla zyrtare (politike) zbatuar në Republikën e Shqipërisë për nenin 65 të K. Penal.

Më në fund, neni 3 GJEDNJ që opsioni i privimit është i disponueshëm për një person të dënuar me burgim të përjetshëm. Informacioni statistikor në lidhje me ... Nuk po i lexoj më tepër dhe po jap vetëm pikën që më 25 shkurt 2019, shteti kërkoi informacione të mëtejshme nga autoritetet shqiptare (atë që thashë që po i rikthehem në vëmendje) në përgjigje të vendimit të gjykatës. Ata u përgjigjën si më poshtë në 27 shkurt 2019: (Pra, vetëm 13 ditë pasi unë si gjyqtar kisha shpallur vendimin për lirim me kusht dhe, vetëm 7 ditë pasi Ministri i Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë e konsideroi këtë vendimmarrje si të paligjshme etj.)

Përmbajtja e Letrës është kjo:

"Në lidhje me rastin e ekstradimit nga Holanda në Shqipëri të shtetasit "x", Ministria shqiptare e Drejtësisë komunikon me këtë se është informuar për vendimin e Gjykatës së Apelit të Hagës për të mos lejuar ekstradimin e shtetasit shqiptar për shkak se në referencë të praktikës gjyqësore të KEDNJ-së, që dënimi i përjetshëm të përputhet me çështjet gjyqësore të GJEDNJ-së, ai duhet të jetë i reduktueshëm si 'de jure' ashtu edhe 'de fakto' dhe se kriteri për vlerësimin e një kërkesë për lirim të parakohshëm ose lirim me kusht duhet të jetë objektiv, i qartë dhe i njohur për personin e dënuar.

Si më lart, duke e konsideruar si të padrejtë dhe paragjykes vendimin për të mos e dhënë ekstradimin e tij, kjo Ministri ju informon si më poshtë:

Me letrën nr. 1294/4, datë 21.03.2019, Ministria shqiptare e Drejtësisë ju ka përcjellë informacionin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë dhe me letrën nr. 1294/17, datë 30.08.2018 është rikonfirmuar të njëjtin qëndrim autoriteteve shqiptare në lidhje me zbatimin e nenit 65 të Kodit Penal shqiptar për lirimin me kusht.

Lidhur me pyetjen tuaj në lidhje me çdo shpallje për lirimin me kusht, ne transmetojmë që aktualisht ekziston një Vendim unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës Supreme, vendimi nr. 2, datë 25.05.2015, i cili përbën një precedent gjyqësor detyrues për t'u referuar nga gjykatat në Republikën e Shqipërisë, i cili shpjegon, në interpretimin e nenit 64 të Kodit Penal, se cilat përbejnë raste të veçanta që duhet të vlerësohen nga gjykata.

Ky vendim sqaron se çfarë do të thotë raste të veçanta dhe këto raste kanë të bëjnë me punën dhe sjelljen e personit të dënuar gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, por edhe duke pasur parasysh kushtet e tij familjare ose rehabilitimin e riedukimin (është mendimi i Ministres së Drejtësisë). Ky vendim mund të shërbejë si referencë edhe në interpretimin dhe kuptimin e rasteve të jashtëzakonshme kur liria me kusht mund të zbatohet, parashikuar nga neni 65.

Në lidhje me pyetjen tuaj nëse ka raste të aplikimit të lirit me kusht të personave të dënuar me burgim të përjetshëm, vendosim në dispozicion Vendimin nr. 41-2019, datë 14.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Korçë mbi personin e dënuar "x", me të cilin gjykata ka pranuar kërkesën e këtij personi të dënuar për lirim me kusht.

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë shfrytëzon këtë mundësi për të rinovuar në Ministrinë së Sigurisë dhe Drejtësisë të Mbretërisë së Holandës, sigurimin e vlerësimit të saj më të lartë.

Në vijim gjykata e Hagës vazhdon arsyetimin, si:

Përgjigja e autoriteteve shqiptare të përmendur sipas pikës 1 ka të bëjë vetëm me një referencë për deklaratat që ata kanë bërë më parë në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 65 të K.Penal të vjetër për ekzekutimin e dënimit të përjetshëm të vendosur ndaj shtetasit 'x'. Në atë masë, kjo përgjigje nuk mund të konsiderohet në vetvete si një rrethanë e re të cilën gjykata nuk e kishte marrë parasysh në atë kohë. Kjo e fundit gjithashtu zbatohet përderisa autoritetet shqiptare i referohen në paragrafin 2 të Vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës Supreme, vendimi nr. 2, datë 25.05.2015. Në përgjigje të kësaj kërkesë shtetasi shqiptar ka argumentuar se kjo nënkupton një vendim të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës Supreme të 25 majit 2015, i cili përfshiu gjykatën në aktgjykimin e tij të 12 shkurtit 2019. Shteti nuk e ka kontestuar këtë dhe në fakt madje e pranoi. Në funksion të kësaj, korrektësia e këtij pretendimi nga shtetasi shqiptar do të supozohet, për me tepër nga paragrafi 2.8 - në bashkëpunim me provat 18 dhe 20 të paraqitura nga shteti - është e qartë se gjykata në atë kohë e konsideronte përmbajtjen dhe qëllimin e këtij vendimi të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës Supreme.

Kjo do të thotë se në fakt, gjithë sa argumentova...

Naureda Llagami: Të lutem, mund ta mbarojmë, se kemi mbi 1 orë që dëgjojmë.

Ilir Toska: Ju lutem, ju keni më shumë se 90 minuta. Tani keni filluar të merreni me Bold News-in, me ministren, me Gjykatën e Hagës.

Ju jeni këtu për procedimin disiplinor të filluar ndaj jush, jo çfarë thonë të tjerët, dhe ju t'i merrni t'i hiqni një pjesë dhe thoni që këta kanë bërë gabim tani.

Ju e përmbledhët të gjithë mbrojtjen tuaj dhe parashtruat se pse nuk jeni dakord me procedimin. Pjesën tjetër, unë vërtet nuk e kuptoj. Ju lutem, përmbledheni!

{...}: I nderuar, do bëj ç'është e mundur ta përmbledh.

Do bëj ç'është e mundur ta përmbledh. Por do ju theksoja diçka.

Naureda Llagami: Të lutem, edhe 5 minuta kohë që ta përmbledhni sepse nuk mundemi dot ta zgjasim. Kemi mbi 1 orë.

{...}: Edhe në këtë tuajën, unë kam 2 vjet që nuk po flas.

Gjithkush ka folur. Vetëm unë nuk kam folur.

Kjo është e vetmja mundësi që unë të flas.

Ilir Toska: E keni mundësinë, por ju lutem përqendrohuni tek procedimi juaj disiplinor. Ju thashë, ju i parashtruar të gjitha argumentet tuaja se pse nuk jeni dakord me procedimin...

{...}: Po kaloj. E keni të paraqitur si provë.

Të mirëkuptoj i nderuar.

E keni si provë. Besoj dhe kam garancinë që jeni njohur me përmbajtjen e saj.

Atëherë, të nderuar anëtarë, në këtë rast dua t'ju tërheq vëmendjen se ministri i Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, për sa rezulton ankues dhe iniciues i këtij procedimi disiplinor ndaj meje si magjistrat, në përmbajtje të ankesës, që para periudhës së paraqitjes së saj si dhe për periudhën në vijim, pas paraqitjes së saj, ka mbajtur qëndrimin se ndaj të dënuarve me burgim të përjetshëm në Republikën e Shqipërisë, janë të detyruara të zbatojnë nenin 65, për përmbajtjen e vjetër të para- ndryshimit të tij në vitin 2017.

Jo vetëm kaq, por Ministri i Drejtësisë në emër të shtetit shqiptar, ka dalë garant për këtë mënyrë sjelljeje të detyrueshme për gjykatat në Shqipëri.

I tronditur, pas njohjes me këtë fakt dhe qëndrim zyrtar të Ministrit të Drejtësisë, i cili në formë dhe në përmbajtje vjen plotësisht në të kundërt të këtij qëndrimi, referuar faktit dhe argumentit të parashtruar në përmbajtje të ankesës drejtuar veprimtarisë të personit tim në detyrë, lidhur me një vendimmarrje gjyqësore konkrete, si dhe me një qëndrim zyrtar publik dhe mediatik në denigrim të veprimtarisë sime gjyqësore dhe integritetit tim si gjyqtar, gjatë gjithë kësaj kohe i kam shtruar pyetjen vetes si individ dhe jo si magjistrat, se çfarë po më ndodh dhe përse po ndodh?!

Përgjigja e kësaj pyetjeje rezulton thelbësore dhe ekzistenciale së pari për mua si individ dhe familjen time zoti Toska në vijim, dhe për me tepër si gjyqtar i Republikës së Shqipërisë.

Nëse dikush nuk do të besojë se veprimtaria ime gjyqësore në zgjidhje të rastit objekt kërkimi nga ILD për fillim të këtij procedimi disiplinor ndaj meje si magjistrat është korrekte dhe e zhvilluar me integritet të plotë në përmbushje të detyrave funksionale, atëherë së paku t'i referohet përmbajtjes së këtyre dy aktgjykimeve të gjykatave respektive të huaja, të cilat mbështesin ligjërisht atë zgjidhje dhe koncept trajtues në arritjen e saj si zgjidhje.

Nëse dikush apo çdokush, që është i prirur të anatemojë dhe intimidojë integritetin e gjykatës dhe ligjshmërinë e zgjidhjes së rastit objekt kërkimor për lirim me kusht, atëherë le të provojë, apo guxojë të artikulojë se edhe këto gjykata të huaja paraqesin mungesë profesionalizmi dhe integriteti.

Nëse dikush, apo çdokush mendon se argumenti dhe qëndrimi mbi këtë argument i Ministrisë të Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë kundër veprimtarisë time gjyqësore në zgjidhje të një çështjeje konkrete është absolut dhe duhet marrë i mirëqenë, duke qenë i bindur se unë si magjistrat duhet të ndëshkohem, atëherë është i lutur nga ana ime si individ të mos vazhdojë të iniciojë apo bëjë shfaqje të tilla publike vetëm për efekte procedurale që dikton ligja.

Nuk jam në dijeni dhe nuk besoj të këtë ndodhur, që gjyqtarët e huaj, që kanë dhënë këto vendime, në raport me rëndësinë e zgjidhjes së çështjes së ekstradimit të një shtetasi shqiptar për të vuajtur dënimin me burgim të përjetshëm në Shqipëri, i gjendur apo etiketuar ligjërisht si vrasës ekzekutor i një punonjësi të lartë të policisë së shtetit në Republikën e Shqipërisë, për sa rezulton e kërkuar me insistim dhe me shumë seriozitet nga Ministri i Drejtësisë dhe Sigurisë së shtetit të Holandës për këtë zgjidhje, të kenë përfunduar në procedim disiplinor mbi kërkesën e këtij të fundit ose jo.

Çështja paraqitet edhe më serioze për sqarimin e qëllimit të veprimtarisë zyrtare të Ministrisë të Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, kundër personit tim në detyrë, për sa kohë provoj se në gjykimin që ka përfunduar me aktgjykimin e Gjykatës së Hagës së datës 15 maj 2019, e vetmja provë që i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor nga kjo gjykatë, për të mbështetur ekstradimin e shtetasit shqiptar nga Holanda për në Republikën

e Shqipërisë, e mbajtur proceduralisht në proces dhe e përdorur nga Ministri i Drejtësisë dhe Sigurisë së këtij shteti të huaj, rezulton vendimmarrja ime si gjyqtar nën këtë procedim disiplinor dhe për këtë vendimmarrje.

Provohet se ky Ministër, në emër të shtetit të Holandës, ka tërhequr të gjitha pretendimet dhe qëndrimet e mbajtura deri në atë moment për gjykatën dhe është mbështetur vetëm në argumentat e trajtuara nga ana ime si gjyqtar në përmbajtje të vendimit që më ka sjellë këtu para Jush në kuadër të këtij procedimi disiplinor.

Arsyeja e ekzistencës së këtij fakti, për këdo që nuk paraqet mjaftueshëm dëshirën për profesionalizëm apo mungesë serioziteti në trajtimin korrekt të çështjes, ka një domethënie të madhe, pasi garancia e dhënë për Gjykatën e Hagës nga shteti shqiptar, përfaqësuar nga qëndrimi zyrtar i Ministrit të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë, është juridikisht e metë dhe nuk ka asnjë mbështetje ligjore për referencën që prezanton nisur nga aplikimi i sanksionit të nenit 3, paragrafi i 3-të i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, siç relatohet edhe nga ILD-ja.

Arsyet për këtë konkluzion, janë shprehur qartazi në përmbajtje të vendimmarrjes time si gjyqtar, pa qenë aspak i njohur apo i ndikuar nga këto argumenta dhe qëndrime gjyqësore përfundimtare të Gjykatës së Hagës, për sa kohë si unë si gjyqtar në kuadër të gjykatës shqiptare, ashtu edhe së paku dy gjyqtarëve të Gjykatës së Hagës, për sa rezulton kemi patur detyrimin të respektojmë të njëjtin legjislacion, duke arritur në të njëjtat konkluzione.

Si dhe kam parashtruar i detyruar në mënyrë të zgjeruar në kuadër të kësaj mbrojtje, zgjidhja e çështjes konkrete, referon në aplikimin e KEDNJ-së për aspekte të trajtimit dhe vlerësimit zgjidhës ligjor, që nuk kanë lidhje me nenin 3, paragrafi i 3-të të Kodit Penal shqiptar, por me një tërësi aspektesh juridike të posaçëm të trajtuara dhe të detyrueshme për t'u mbajtur parasysh jo vetëm nga gjykatat shqiptare për zbatim, të cilat janë dhe shumë specifike për t'i identifikuar dhe aplikuar, sipas praktikës së GJEDNJ-së.

Vendimmarrja objekt procedimi disiplinor për këtë veprimtari timen gjyqësore. rezulton siç është certifikuar për ligjshmërinë e saj nga një gjykatë e huaj, e cila për shkak të karakterit të procesit, si e vetmja provë e drejtpërdrejtë për shqyrtim në atë proces, nuk rezulton të jetë kontestuar, por është trajtuar dhe specifikuar si rast pozitiv, por që nuk ka mjaftuar të bindë gjykatën. Arsyet janë edhe më domethënëse, por do i trajtoj në vijim.

Nëse ankuesi apo iniciuesi i këtij procedimi disiplinor, përfshirë dhe rolin e ILD-së në këtë drejtim, për sa është parashtruar specifikisht në këtë mbrojtje, nuk kanë njohje mjaftueshëm të këtij legjislacioni, apo qëllimisht, si dhe rezulton e provuar kjo situatë, shmangin trajtimin e rastit disiplinor nga ky këndvështrim zgjidhës, për sa është proceduar nga ana ime si magjistrat, kjo nuk është dhe nuk mund të jetë “faji” i imi si gjyqtar.

Nëse “gabimi” im është se i kam qëndruar besnik Konventës dhe GJEDNJ-së si dhe Kushtetutës së atdheut tim, kjo nuk është rrethanë që duhet pazgjidhshmërisht të çojë tek ndëshkimi im për këtë veprimtari ligjore, pasi ka indicje të mjaftueshme dhe thelbësore për të evidentuar se ndëshkimi që kërkohet të me jepet, dukshëm nuk ka lidhje me këtë argument ligjor në zbatim të këtij legjislacioni, por vetëm me zgjidhjen konkrete të çështjes.

Në këtë drejtim, nëse dikush, apo çdokush që mund të këtë qenë i interesuar që shtetasi i dënuar “x” të mos përfitonte nga lirimi me kusht (pra në rastin tim në gjykim) edhe pse mund të ishin kushtet ligjore për këtë zgjidhje, arsyeja referon vetëm në interesa personale meskine, për të cilat nuk kam qenë dhe nuk jam në dijeni dhe për çdo rast nuk mund të isha në shërbim të tyre.

Ne fakt i qëndroj konkluzionit se kjo mënyrë e zgjidhjes së çështjes, duhej pazgjidhshmërisht të rrëzohej si jo ligjore nëpërmjet Gjykatës së Apelit Korçë, edhe pse jashtë realitetit juridik të trajtuar nga gjykata e faktit, si dhe në vijim, qoftë edhe në mënyrë indirekte, nëpërmjet ndëshkimit tim disiplinor, duke krijuar shtratin për të tentuar dhe garantuar një rezultat pozitiv edhe para Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.

Se çfarë fshihet pas kësaj në këto momente, vetëm mund të aludohet.

Për sa rezulton e provuar nga përmbajtja e vendimmarrjes gjyqësore specifike, kam mbajtur thellësisht nën vëmendje të veprimtarisë sime gjyqësore, që të mos jem paragjykses jashtë detyrimit ligjor që me diktonte përmbushja e detyrës dhe, për sa rezulton, e kam ekzekutuar më së miri proceduralisht këtë aspekt kundrejt të dënuarit, si dhe në mënyrë shumë specifike e kam trajtuar rastin për gjykim po proceduralisht dhe në përmbajtje në respekt të plotë dhe pa asnjë paragjykim fyes ndaj kujtimit të viktimave nga veprat penale për të cilat ky i dënuar paraqitej i dënuar, duke garantuar për secilën

palë një trajtim dinjitoz ligjor dhe procedural në raport me çdo zgjidhje të mundshme që do definonte nga shqyrtimi gjyqësor në mënyrë të ndërsjellët dhe të balancuar për këtë aspekt, ndonëse për sa rezulton "dikush" ka bërë çdo përpjekje të mundshme personalisht, apo nëpërmjet levave të veta, për të mundësuar cenimin e integritetit tim jo vetëm moral, por edhe fizik si individ dhe si gjyqtar, duke e prezantuar veprimtarinë time gjyqësore në zgjidhje të rastit qëllimisht si jo ligjore dhe si shkelje flagrante e ligjit, duke formuar po qëllimisht, për sa rezulton personalisht dhe/ose nëpërmjet mediave të shkruara dhe kryesisht atyre elektronike, një opinion plotësisht negativ, në kundërshtim me këtë realitet të prezantuar nga ana ime për ju si Këshill i Lartë Gjyqësor, për të provokuar me akuza të pabaza dhe dëshiruar, për sa rezulton në fakt të shumë dëshiruara. ardhjen e kësaj pasoje.

Për të faktuar këtë situatë, por pa e trajtuar të plotë atë dhe pa u sjellë si viktimë, pasi e kam provuar më shumë se një herë se e kam të pamundur të qëndroj në këtë pozicion, sjell nën vëmendjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor se ndonëse ka kaluar plot një vit nga momenti kur u tentua vendosja e lëndës plasëse në automjetin në posedim të familjes time, e ekspozuar në datë 15 tetor 2019 dhe vetëm një ditë më pas, në datë 16 tetor 2019 një i dënuar për vrasje dhe vuajtës i dënimit me burgim në sektorin e sigurisë së lartë pranë IEVP Drenovë Korçë, i përdorur në këtë mekanizëm ngjarjeje, që fatmirësisht Zotit dhe intuitës e vigjilencës time nuk u mundësua, u lejua të kryente për rreth 20 minuta dy intervista në rrugë telefonike të transmetuara direkt nga dy televizione të ndryshëm, duke më kërcënuar me jetë në mënyrën më monstruoze të mundshme, përmbajtja e të cilave ngriti në këmbë gjithë opinionin publik shqiptar, por jo strukturat drejtuese të këtij institucioni penitenciar, procedimi penal në ngarkim të këtij shtetasi ende nuk ka përfunduar dhe ndodhet në fazën e hetimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Prokuroria as që ka guxuar dhe as ka për të guxuar të përfundojë këtë procedim penal, qoftë edhe për veprën penale "Kanosja për shkak të detyrës" të parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal, ndonëse fakti i parashtruar nga ana ime si gjyqtar plotëson elementet e veprës penale "Kanosja për kryerjen e veprave për qëllime terroriste", të parashikuar nga neni 232/b të Kodit Penal dhe më e pakta të veprës penale "Vrasja e

funksionareve publike", kryer në bashkëpunim dhe e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 79/a i po këtij Kodi.

Prokuroria as që guxoi t'i përcillte për kompetencë gjykimi këtë çështje ish-Gjykatës së Shkalles së Parë për Krime të Renda Tiranë dhe as që vijon të guxojë ta kryejë këtë veprim të detyrueshëm për kompetencë të Prokurorisë Speciale SPAK.

Ndërkohë që përballë fakteve të relatuara nga ana ime si magjistrat nuk rezulton të jetë kryer asnjë veprim hetimor, qoftë edhe duke më thirrur për të më kërkuar sqarime të mëtejshme, por edhe në këtë rast mungon guximi.

Për raportin gjyqtar-prokuror, ky i fundit nuk do të kishte guxuar kurrë të paraqitej me mospërbushje të detyrave ligjore, përveçse dhënies së garancive për të mos proceduar, pavarësisht se fakti i kundërligjshëm është aq i fortë sa nuk po procedohet dot as me përfundimin e hetimeve për atë vepër penale që është regjistruar ky procedim penal dhe kjo kundrejt një shtetasi të dënuar, veprimtaria e kundërligjshme e të cilit është e faktuar botërisht .

Në dosjen që disponon Komisioni për Mbrojtjen e Gjyqtareve, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka material të plotë sqarues për gjithë sa parashtrova dhe gjeta kurajën të parashtroj, që përbën dhe arsyen për të cilën kam kërkuar të bëhet pjesë e provave të mia në kuadër të kësaj mbrojtjeje, për t'ju dhënë mundësinë të kuptoni se cila është ngjarja dhe përse ka ndodhur ajo, përfshirë dhe identifikimin e bashkëpunëtoreve në këtë ngjarje, por në mënyrë të posaçme dua të ekspozoj rolin tepër pasiv të Ministrisë së Drejtësisë në trajtimin e saj si ngjarje dhe mungesës së plotë të vullnetit për të marrë masa mbrojtëse ndaj një gjyqtari të Republikës së Shqipërisë, qëndrim ky që e ka një shpjegim dhe qellim, si dhe ai që parashtrova.

Naureda Llagami: Të lutem, përmbliidheni.

{...}: Nuk kam asgjë e nderuar Kryetare, por më mirë më ndërprisni fjalën dhe mos më lejoni të flas. Unë nuk kam kur flas. Unë kam edhe maksimumi 10 minuta kohë.

Naureda Llagami: Gjërat që janë, të fakteve që ju i keni parashtruar aty, ju lutem përmbliidheni dhe kaloni në pjesën që ka të bëjë me procedimin.

{...}: Unë e kam parashtruar por parashtrësia ime nuk është në dispozicionin tuaj.

Naureda Llagami: Dakord! Përmbliidheni në përfundim tani.

{...}: Nuk kam çfarë i përmbledh të përmbledhurës, kështu që ose më lejoni të vijoj, do përpiqem brenda 10 minutash ta përfundoj ose vendosni ju, ju e dini.

Naureda Llagami: Atëherë, 10 minuta ju lutem.

{...}: Faleminderit!

Gjithashtu rezultoi se IEVP Drenovë Korçë nuk mori asnjë masë ndëshkuese disiplinore ndaj këtij të dënuari, si dhe Ministria e Drejtësisë nuk mori asnjë masë disiplinore ndaj strukturave në varësi të saj për këtë ngjarje (kam paraqitur dokument të plotë provues).

Pak e çuditshme për një mendje normale, por aspak e çuditshme për këto që po parashtroj.

Si paraqiten këto zhvillime dhe qëndrime edhe në kuadër të këtij procedimi disiplinor kundër personit tim në detyrë, po i bëj publike këto rrethana, për të garantuar mocimin e integritetit tim fizik si individ dhe gjyqtar në detyrë dhe për të adresuar problematiken në rast ngjarjeje të këtij lloji.

Në këtë drejtim shembujt nuk mungojnë, vijnë të mbeten në të njëjtin kërcënim.

Lidhur me shkeljen e pretenduar, të formuluar nga përmbajtja e pikës 14 të Raportit të hetimit disiplinor, si: "... nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor nuk janë zbatuar kërkesat mbi plotësimin e kriterëve ligjore me natyrë subjektive, siç janë "arsyet e veçanta", apo "rastet e jashtëzakonshme", ILD ka parashtruar se kjo bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 64 dhe 65 të Kodit Penal, si dhe Vendimit Unifikues nr.2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Kam parashtruar se neni 64 dhe neni 65 i Kodit Penal, janë norma penale autonome, nuk ka lidhje aplikimi i nenit 64, 65 dhe as vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë. Po kaloj shkurt.

Lidhur me shkeljen e pretenduar, të formuluar nga përmbajtja e pikës 14.1. të Raportit të hetimit disiplinor, se: "Ndryshe nga sa udhëzon Gjykata e Lartë në këtë Vendim Unifikues nr.2/2015, rezultoi se në rastin konkret nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor nuk janë mbajtur në konsideratë... (kam argumentuar specifikisht sa më sipër).

Në vijim lidhur me sa specifikon ILD, disa rrethana shkeljes në përmbajtje të kësaj pike të Raportit të hetimit... Mund t'i deponoj t'i shikoni dhe të them vetëm thelbin?

Ilir Toska: Patjetër që do t'i depononi ato.

Ju thoni ato që doni që të na tërhiqni vëmendjen, kryesoret.

{...}: Të gjitha kryesoret janë.

Ilir Toska: Parashtresat do i marrim.

{...}: Të gjitha kryesoret janë, i nderuar!

Ilir Toska: Okej, vazhdo!

{...}: Kështu ILD relatton si: "Në lidhje me veprat penale ai është pyetur vetëm një herë nga Gjykata e Shkallës së Parë Korçë, mbasi nuk merrte pjesë në gjykim.

Mënyra e formulimit të këtij, le të themi, konstatimi, është tendencioze dhe ka për qëllim të shprehë një ndjenjë negative për të dënuarin, pa patur parasysh se çfarë dhe përse po thuhet. Prezenca ose jo në gjykatë e të dënuarit është situatë proceduralisht ligjore në proces gjyqësor. I dënuari si subjekt procedural ka të drejtë të jetë prezent në gjykim, ose të përfaqësohet nga një mbrojtës në mungesë të tij. Proceduralisht pala konsiderohet ligjërisht prezente. Instituti i lirimimit me kusht dhe rregullat procedurale që mbështesin atë, bazohet mbi parimet e përgjithshme të procesit gjyqësor, por nuk evidentohet asnjë rrethanë detyruese për prezencën e subjektit në këtë lloj gjykimi, apo që kjo mosprezencë të konsiderohet ligjërisht në trajtim si negative për të dënuarin në raport me këtë proces gjyqësor.

Në këtë drejtim përse kjo situatë procedural e formulohet si: "nuk merrte pjesë në gjykim"?! Mënyra se si është formuluar kjo shprehje apo konstatim nuk ka lidhje logjike, pasi nuk është e vërtetë se është pyetur vetëm një herë nga gjykata ngaqë nuk merrte pjesë në gjykim. Gjykata një herë e çmoi të nevojshme ta pyeste dhe një herë e ka pyetur. Po të lindte e nevojshme ta pyeste disa herë, disa herë do e kishte pyetur.

Por kjo provon se strategjia shqyrtuese, si model investigativ i gjykatës, megjithëse është shprehur qartazi për këtë taktikë sjelljeje procedurale në përmbajtje të vendimit dhe qëllimit të kësaj sjelljeje në përmbushje të detyrave gjyqësore, as që është

identifikuar nga çdo lexues i interesuar i kësaj vendimmarrjeje, për sa kohë bën përcaktime të tilla.

Ndërkohë, nuk jam në gjendje të kuptoj se çfarë lidhje ka kjo me Vendimin Unifikues nr.2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, qoftë edhe brenda bindjes së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për këtë aspekt.

Për sa është parashtruar në mënyrë specifike, mungon specifikimi ose relatimi i faktit të dyshuar dhe/ose vlefshmëria dhe analiza e tij në përmbajtje të raportit të hetimit dhe për rrjedhojë nuk jam në gjendje të çmoj elemente të ligjshmërisë së procesit hetimor disiplinor apo nëse është respektuar ose jo, apo do respektohet ose jo neni 6 i KEDNJ-së, procesi i rregullt ligjor.

Rezervoj të shprehem, vetëm pasi nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka miratuar si të vlefshme dhe ligjore këtë shkelje të pretenduar, të më jepen sqarimet e nevojshme dhe ato specifike të parashtruara nga ana ime për sqarim dhe përgjigje, me referencat përkatëse.

ILD relatton si: “Por edhe kur është pyetur ka qenë i dyzuar për pranimin e veprave penale, duke fajësuar kryesisht moshën e tij shumë të re në kryerjen e veprave penale”.

Nuk rezulton ky fakt. Kujt i referohet dhe ku është mbështetur Inspektori i Lartë i Drejtësisë për këtë përcaktim?!

Realiteti objektiv dhe ai procedural në çështje pasqyron tjetër qëndrim të të dënuarit. Mjafton t’i referohesh pyetjes vetëm një herë nga gjykata, ku rezulton se i dënuari është shprehur si: “Nuk kam justifikime që kam qenë i ri. ...”

Për asnjë rast, i dënuari nuk ka qenë i dyzuar dhe nuk ka fajësuar asnjëherë moshën e tij shumë të re në kryerjen e veprave penale, nga ky këndvështrim i relatuar nga ILD. Por edhe në qoftë kështu, nuk jam në gjendje të kuptoj se çfarë lidhje ka me vendimin unifikues nr.2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, qoftë edhe brenda bindjes që ka Inspektorati i Lartë të Drejtësisë për këtë aspekt. Apo, perse është përdorur ky fakt për të argumentuar çfarë dhe mbi cilën analizë, pasi kjo e fundit mungon tërësisht si në këndvështrimin metafizik të faktit, ashtu edhe në atë zhvillimor dinamik të tij?

Për sa është parashtruar edhe në këtë rast rezervoj të shprehem, vetëm pasi nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka miratuar si të vlefshme dhe ligjore këtë shkelje të pretenduar, të më jepen sqarimet e nevojshme dhe ato specifike të parashtruara nga ana ime për sqarim dhe përgjigje, me referencat përkatëse.

ILD relacionon si: “Po nuk ka treguar ndonjë pendim të thellë për veprat penale të kryera dhe pasojat që kanë ardhur prej tyre”.

Edhe në këtë rast mungon analiza e këtij konstatimi. Ky konstatim nuk ka referencë mbështetëse me realitetin objektiv procedural dhe material në çështje; fakti procedural është krejtësisht i kundërt me këtë konstatim të Gjykatës së Apelit, të mbështetur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është i lutur të më specifikojë si magjistrat referencën në akte dhe në vendim për këtë përcaktim.

ILD relacionon si: “Në rastin konkret, nuk evidentohen përpjekje që ka bërë i dënuari, për shuarjen e pasojave nga vepra penale. Gjykata ka administruar një deklaratë noteriale të shtetasit A.P, vëlla i viktimës B.P., të cilit i ka marrë dëshmi në seancë gjyqësore, në këtë rast duke mos bërë asnjë referencë për përmbajtjen dhe thelbin e dëshmisë, pra duke e anashkaluar në mënyrë të qëllimshme faktin mbi të cilin është mbështetur analiza e gjykatës, duke e përgjithësuar qëndrimin e tij dhe për viktimën N.Z., në këtë rast duke mos mbajtur parasysh faktin se ky dëshmitar është në lidhje të afërt gjaku edhe me këtë viktimë dhe njëkohësisht për të gjithë familjarët e të dy viktimave, ndërkohë që nëna dhe motra e viktimës N.Z. rezultojnë të zhdukura dhe nuk ka informacion për fatin e tyre, duke anashkaluar tërësisht dhe qëllimisht faktin që gjykata ka bërë të gjitha përpjekjet për të siguruar familjarët e këtij shtetasi për t’i pyetur në seancë gjyqësore, por nuk janë gjetur trashëgimtarë të drejtpërdrejtë; duke relatuar faktin historik pa asnjë lidhje konceptuale me këtë çështje.

Po shmang një pjesë të të thënave në lidhje me rastin. I keni të specifikuar.

Nuk mund të jem në këndvështrim nën akuzë të shkeljes së nenit 9, 10 dhe 11 të ligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, pasi neni 9, 10 dhe 11 i ligjit përmban detyra funksionale të punonjësve të IEVP-së. Nuk kam si të shkel unë detyrat funksionale të dikujt tjetër, për sa kohë nuk jam në atë proces.

Nga ana tjetër, -po i bie shumë shkurt e nderuar Kryetare, - thuhet që jam në shkelje të VKM-së 437, datë 20.05.2015 (që ka miratuar rregulloren e përgjithshme të

burgjeve) për argumentin se nga dokumentacionet e plotësuara të IEVP-së dhe të .. në dosje, janë formale, janë të vakëta, dhe i dënuari nuk ka qenë asnjëherë pjesë e planeve për përgatitje për lirim.

Ju lutem, neni përkatës, pika 5, 51 e kësaj rregulloreje, nuk përcakton në asnjë rrethanë që i dënuari me burgim të përjetshëm të jetë pjesë e planeve për përgatitjen për lirim.

Ku e ka gjetur Gjykata e Apelit që ka vendosur këtë? Dhe nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë e ka verifikuar këtë përcaktim të Gjykatës së Apelit, që është rrethanë që është konstatuar në të gjitha, është problematikë në të gjitha konstatimet, unë nuk e di, por unë nuk kam pse të jem përgjegjës për një situatë të tillë.

Duke depozituar raportin lidhur me përmbajtjen dhe duke patur mirëbesim që ato do shikohen nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në qoftë se më lejohet, kam disa vërejtje lidhur me procesin e rregullt ligjor.

Janë shumë shkurt.

Atëherë, në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, Komisioni disiplinor pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka patur të gjitha mundësitë për të perceptuar se zgjidhja e çështjes nga gjykata e faktit, referon në një trajtim të një natyre ligjore tërësisht të paeksponuar, çmuar dhe kundërshtuar nga Gjykata e Apelit Korçë, tërësisht të paeksponuar dhe çmuar nga ankuesi, tërësisht të paeksponuar dhe trajtuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Në rrethana të tilla, vlerësoj se mjaftonte vetëm ky fakt i prekshëm, që ky Komision, referuar sanksionit të nenit 19 të Rregullores "Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor", si dhe nenit 30, pika 3 të saj, duhej ta kishte gjetur kërkesën e ILD-së në kundërshtim me sanksionin e nenit 133 të Ligjit 96/2016 për Statusin dhe duhej ti kishte lënë afat për plotësimin e të metës, që rezulton thelbësore në drejtim të mungesës së veprimeve hetimore, mungesës së përfshirjes së magjistratit në hetim, mungesën e shkaqeve për të filluar hetimin disiplinor, mungesën tërësore të deklaratave të magjistratit mbi faktet objekt hetimi disiplinor dhe mungesën e parashtrimit të fakteve si të pranuar, apo të papranuar nga ana e magjistratit.

Gjithashtu ky Komision duhej të kishte konstatuar se Inspektori i Lartë i Drejtësisë, kishte tejkalluar në hetim objektin e shkeljes se referuar nga ankuesi, ndërkohë

që si në përmbajtje të Vendimit për fillimin e hetimit disiplinor, ashtu edhe në Raportin mbi këtë hetim, për asnjë rrethane Inspektori nuk ka paraqitur argumentin se mbi cilat dyshime apo rrethana të kërkuar nga ligji, kishte iniciuar një sërë veprimesh shtesë hetimore, përfshirë dhe shqyrtimin e veprimtarisë time gjyqësore për gjithë gjykimet e zhvilluara për lirim me kusht.

Kjo veprimtari e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk mbështet në ligj dhe provon se rasti ka qenë plotësisht i paragjykuar, procesi hetimor po i tillë, që konkretizon në formë dhe në përmbajtje qëllimore gjithë sa është parashtruar në kundërshtim të plotë të parimeve të sanksionuara nga neni 100, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit 96/2016.

Në këto drejtime Komisioni Disiplinor duhej të kishte konstatuar faktin se hetimet ishin kryer tërësisht në mënyrë të njëanshme, duke shmangur pa asnjë arsye apo shpjegim magjistratin nga ky proces, përveçse nëse Komisioni Disiplinor dhe Relatori kanë marrë të mirëqenë deklarin e ILD-së se ka marrë në shqyrtim pretendimet e mija. ndërkohë që gjithë sa kam kërkuar të qartësohem dhe sqarohem në përmbajtje të aktit me nr. 102 prot., datë 24 prill 2020 drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, provohet se nuk ka asnjë lidhje konceptuale dhe faktike me termin “Parashtrim” apo “Qëndrim” timin si magjistrat kundrejt çdo pretendimi për shkelje disiplinore në përmbajtje të Vendimit për fillimin e hetimit disiplinor. Ndërkohë që vetë ILD reklamon në përmbajtje të raportit të hetimit se më ka kthyer përgjigje, por një rrethanë e tillë është fiktive dhe nuk mund të provohet se ka ndodhur nga Inspektorati, për sa kohë provat e vëna në dispozicion për këtë Këshill nga vetë ILD-ja provojnë të kundërtën e këtij qëndrimi. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për transparencë dhe provueshmëri është i lutur të më provoje të kundërtën.

Në vijim ky Komision Disiplinor, me referencë nenin 31, pika 1, germa a) të Rregullores, duhej t’i kishte propozuar Mbledhjes Plenare të Këshillit mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, sipas nenit 139 të Ligjit për Statusin, referuar specifikisht pikës 1, germa ç) të këtij neni, si raport hetimi i depozituar i paarsyetuar ose për çdo rast vlerësimi të situatës procedurale në ngjarje, kryerjen e veprimeve të mëtejshme nga ILD, duke specifikuar elementet që mungojnë dhe afatin.

Për çdo rast, mbaj qëndrimin se, Komisioni Disiplinor dhe Relatori, në mbështetje të rregullit të parashikuar nga neni 33 i Rregullores, duhej të kishte ezauruar apo zgjidhur të gjitha ankesat dhe kërkesat e magjistratit nën procedimin disiplinor, si dhe këto të

relatuara për mosveprim, përkthim dhe për administrim provash, si dhe pranimin ose jo të kërimit për thirrjen e dëshmitarit, që në fazën paraprake të procesit. Asnjë nga këto nuk keni ezauruar si Këshill i Lartë Gjyqësor.

Kjo për sa kohë përgatitja e Relacionit paraprak për çështjen, i identifikuar si proces për këtë fazë në germën dh) të pikës 2 të Rregullores, renditet pas kryerjes së një sërë veprimesh si dhe këto të sipërcituara dhe, në çdo rast i përket fazës së kryerjes së veprimeve paraprake, para zhvillimit të seancës dëgjimore.

Rezulton se ndodhemi në seancë dëgjimore dhe deri në këto momente Mbledhja Plenare e Këshillit, nuk është shprehur për kriteret e përcaktuara në pikën 2, germën ç) të nenit 33 të Rregullores, përfshirë pranueshmërinë e provave të paraqitura nga ana ime si magjistrat, thirrjen dhe angazhimin e ekspertëve me cilësinë e përkthyesve, thirrjen e dëshmitarit sipas kërkesës time specifike, të riparashtruara në seancën dëgjimore të datës 2 tetor 2020, etj., kompetenca këto evidentuese dhe proceduese si ato të sipërcituara, që duheshin të ekspozoheshin kryesisht për zgjidhje nga vetë Komisioni Disiplinor dhe Relatori drejtuar Mbledhjes Plenare të Këshillit dhe jo Këshillit të Lartë Gjyqësor në kuadër të seancës dëgjimore.

Gjithë sa më sipër konstatoj se nuk është në përputhje me parimin e një procesi të rregullt ligjor dhe mund të këtë pasoja të padëshiruara të karakterit të pavlefshmërisë së vetë këtij procesi disiplinor, pavarësisht çdo rezultati në zgjidhje të tij.

Konstatoj se në këto aspekte nuk mund të rikuperohen në seancë dëgjimore dhe gjithçka ndikon seriozisht në cilësinë dhe pranueshmërinë e mbrojtjes time si magjistrat.

Referuar ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, sanksionohet në nenin 94 me nëntitull “Objekti i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” se: “Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore edhe ndaj, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Ndërkohë rezulton se në baze të nenit 204 të po këtij Ligji, pika 1 e tij, se: “Në zbatim të funksioneve të tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ushtron kompetencat e mëposhtme: a) përfaqëson Zyrën e Inspektorit në marrëdhëniet me të tretet; b) siguron bashkëpunimin e Zyrës së Inspektorit me organet e tjera publike dhe subjektet private në ushtrim të funksioneve të tij”.

Në bazë të Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 142 të tij, pika 3, germa a) sanksionohet se: “Në seancë dëgjimore para Këshillit: Inspektori i Lartë i Drejtësisë paraqet argumentet që shkelja disiplinore është kryer dhe propozon masat disiplinore që duhet të merren”.

Për sa rezulton nga Ligji është vetë Inspektori i Lartë i Drejtësisë që përfaqëson këtë Institucion para Këshillit të Lartë Gjyqësor duke relatuar argumentet që shkelja disiplinore është kryer dhe propozon masat disiplinore që duhet të merren, në një kohë që Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kompetencën e fillimit të procedurës disiplinore ndaj çdo anëtari të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndonëse nuk është përgjegjësi e këtij Këshilli të nderuar, por e vetë ligjit, në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, jam i detyruar të parashtoj se kjo kompetencë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor është antikushtetuese pasi cenon në mënyrë thelbësore parimin e barazisë para ligjit dhe parimin e sigurisë juridike të magjistratit në procedim disiplinor.

Për të ilustruar drejtpërsëdrejti këtë natyrë antikushtetuese është potencialisht e mundur që magjistrati nën procedim disiplinor të paraqesë ankesë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi veprimtarinë e çdo anëtari të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si në kuadër të Mbledhjes Plenare, ashtu edhe të seancës dëgjimore.

Ankesa e karakterit disiplinor, në këtë rast, mund të lidhet me veprimtarinë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet specifike të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në drejtim të sjelljes të anëtarit ndaj magjistratit ose tejkalimit të kompetencave ndërvepruese për veprime apo mosveprime, materiale ose procedurale që mbështesin qëndrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Duke mbajtur parasysh se Inspektorit të Lartë i Drejtësisë, kjo veprimtari e anëtarit të Këshillit i vlen dhe shkon në një drejtim me interesin e tij që mbështet argumentin se shkelja disiplinore është kryer, atëherë nuk do të këtë asnjë kuptim dhe asnjë shans procedural dhe ligjor, që ankesa e magjistratit të gjejë zgjidhje pozitive edhe pse mund të jetë plotësisht e ligjshme.

Si magjistrat në procedim disiplinor, kam konstatuar se Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka të gjitha mundësitë për të kontaktuar Këshillin e Lartë Gjyqësor për çdo

arsye, gjatë kohës dhe procedurës së zhvillimit të Mbledhjes Plenare të Këshillit, apo seancës dëgjimore, apo të diskutojë lidhur me njehsimin e procedurave të ndërveprimit faktik dhe konceptual të realizimit të tyre, me gjasë për garantimin e një procesi të rregullt ligjor si dhe ka ndodhur.

Në përmbushje të detyrave të veta funksionale, rezulton se mund të marrë në çdo moment kontakt me Këshillin e Lartë Gjyqësor, për nevoja të bashkëpunimit ndërinstytucional, parimor ose për çështje konkrete.

Në analizë të fundit edhe pse është palë në një proces disiplinor që duhet të shqyrtohet korrektësisht nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor me paanësi, për gjithë sa u parashtrua, paraqitet me një pozitë procedurale shumë të avantazhuar ndaj magjistratit në procedim disiplinor, i cili nuk ka asnjë mundësi të realizojë kontakte të tilla, bile si ndalohet kjo mundësi, përfshirë dhe paraqitjen e vërejtjeve, sqarimeve, ankesave dhe kërkesave drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të njëjtat karakteristika nevojë të kontaktit me këtë Këshill si dhe Inspektori, por që në këtë rast magjistrati detyrohet me ligj të komunikojë në rrugë postare dhe/ose elektronike, kurse Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundësohet, si dhe i është mundësuar kontakti i drejtpërdrejtë.

Këtë veprimtari të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë e konsideroj të papranueshme dhe shumë të disfavorshme kundrejt meje si subjekt në këtë procedim disiplinor në kuptimin se Këshilli ose duhet ta trajtojë si palë në proces disiplinor, njëlloj si magjistratin ose nuk e di se çfarë duhet të mendoj apo ekzekutoj në këtë drejtim për të mundësuar balancat e nevojshme dhe garantimin e parimit të “barazisë së armeve”.

Në drejtimet e mësipërme të faktit, procesi i rregullt ligjor nuk mund të konsiderohet si i tillë.

Në vijim të argumenteve për garantimin dhe zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, bazuar në sanksionin e nenit 100, pika 2 të Ligjit 96/2016 për Statusin sanksionohet se:

“Në balancimin e parimit të drejtësisë së hapur, parimit të konfidencialitetit, të drejtës për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat duhet të marrin parasysh veçanërisht: a) faktin që të garantohet mbrojtja e integritetit dhe figura e magjistratit nga akuzat e pabaza; b) rëndësinë që ka

informimi i publikut në lidhje me akuzat e provuara në funksion të administrimit të drejtësisë”.

Është fakt i njohur publikisht se së paku redaksia e formatit televiziv shqip “Zëri i Amerikës”, ka transmetuar një kronikë televizive në datën 14 gusht 2020, e cila është pasuar në transmetim nga media të tjera vizive, apo të shkruara. të po kësaj datë, ku janë evidentuar pjesë të Raportit të hetimit të ILD-së, mbi llojin dhe karakteristikat e shkeljeve drejtuar magjistratit në kuadër të këtij procedimi disiplinor.

Në këtë rast rezulton e provuar se Raporti i hetimit ka qenë në dispozicion të mediave dhe e gjitha kjo kur unë si magjistrat nuk kisha asnjë dijeni lidhur me përmbajtjen e tij, situatë kjo e trajtuar në seancën dëgjimore të datës 2 tetor 2020 para këtij Këshilli, ndërkohë që isha duke parashtruar kërkesa dhe ankesa që ky komunikim Akti të ezaurohej.

Pasi kam paraqitur ankesë ndaj këtij transmetimi, ankesë të cilën e kam paraqitur si provë para këtij Këshilli të nderuar, drejtuar redaksisë së formatit shqip të “Zërit të Amerikës”, jam kontaktuar nga kjo redaksi duke më konfirmuar se disponon Raportin e plotë të hetimit, të vendosur në dispozicion nga ILD dhe për sa rezultonte, jo nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Në këtë rast, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për këtë veprimtari gjendet në kundërshtim flagrant të ligjit të sipërcituar, duke më tërhequr vëmendjen qëndrimi i mbajtur në seancën dëgjimore pararendëse, i artikuluar prej tij, se ligji nuk e detyronte të komunikonte Raportin e hetimit magjistratit, ndërkohë që edhe pse ligji e detyronte të mos vendoste në dispozicion të mediave këtë akt, kjo nuk e ka penguar të veproje në kundërshtim me këtë përcaktim ligjor.

Për sa parashtrova dhe në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, mbaj qëndrimin se transmetimi i njëanshëm i informacionit nuk përbën lajm dhe as nuk i shërben procesit dhe informimit korrekt të publikut, përveçse mbështet paligjshmërinë e procesit dhe një interes i aspak normal dhe dukshëm jo procedural ligjor, si dhe kam parashtruar specifikisht këtë aspekt, për të dëmtuar sa të jetë e mundur në çdo drejtim magjistratin.

Kam vendosur nën vërejtjen e KLGJ-së dhe strukturave specifike në ndjekje procedurale të rastit objekt hetimi disiplinor se, si magjistrat e kam të ndaluar të sqaroj

opinionin publik nëpërmjet mediave në kuadër të barazisë së armëve, për sa kohë çështja gjyqësore është ende në procedurë gjykimi në Gjykatën e Lartë.

Për këtë qëndrim i referohem ligjit nr.96/2016 për Statusin, neni 102, pika 1, rregull ky që nuk është mbajtur parasysh nga ana e ILD-së, kjo në mënyrë abuzive me qëllime negative.

Qëllimi i ILD-së dhe më tej dukshëm është të vendosë magjistratin si dhe e ka vendosur në një "përballje publike" negative dhe kjo për sa rezulton, vetëm mbi konkluzione të njëanshme të arritura nga ky institucion, të ekspozuara për median, por jo për magjistratin, i cili, e theksoj, deri në momentin e lajmit, nuk kishte asnjë dijeni se për cilat fakte dhe rrethana ndodhej në procedim disiplinor.

Në këtë drejtim, situata procedurale dhe materiale në çështjen objekt hetimi disiplinor, për sa është parashtruar nga ana ime si magjistrat është tërësisht e ndryshme nga ajo që propagandohet. Provat dhe aktet zyrtare të referuara provojnë të kundërtën e kësaj propagande të pasqyruar nëpërmjet mediave nga ana e ILD-së.

Në kuptimin e masës së propozuar, po vendos në vërejtjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, se në kohën e kryerjes së shkeljes, siç jeni në dijeni të gjithë, nuk ka pasur ligj që të përcaktonte shkeljen.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë – po shkëputem nga shkrimi – i është referuar drejtpërsëdrejti Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Konstatohet se neni përkatës i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka qenë i njëjtë dhe nuk ka ndryshuar me ndryshimet e mëvonshme kushtetuese, ndërkohë që për asnjë rast nuk ka ekzistuar si shkelje disiplinore fillimi i hetimit disiplinor për shkak të apo procedimi i gjyqtarit për shkak të prishjes së një vendimi nga Gjykata e Lartë apo siç ka qenë, gjykata e apelit.

Aktualisht kjo rrethanë është vendosur në ligjin për Statusin dhe është rrethanë e re dhe unë ndodhem në këtë procedim.

Duke qenë se është pikërisht Kushtetuta që thotë “mban përgjegjësi disiplinore gjyqtari para rasteve të përcaktuara në ligj”, dhe në këtë rast ligj nuk kemi. Është shumë e rëndësishme për të gjithë situata që kam parashtruar dhe pres përgjigje nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, të sqarojë në mënyrë konkrete se cila është shkelja që pretendon; ku bazohet ajo shkelje; pse ka atë formulim ajo shkelje; dhe kjo gjithçka në raport me

vendimin edhe të Gjykatës Kushtetuese që ka shfuqizuar normat përkatëse të Kushtetutës. Kjo është shumë e rëndësishme pasi nuk mund të jepet një masë disiplinore në këto rrethana, në rast se do të jepet, mbështetur vetëm mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, pasi situata është njësoj sikur, meqenëse në Kushtetutë parashikohet që e drejta e jetës është e garantuar me ligj, unë si gjyqtar, në mungesë të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, ta aplikojë për dënimin e shtetasit drejtpërsëdrejti në këtë parim kushtetues, ose për vepër penale “plagosje e lehtë” “plagosje e rëndë” apo “vrasje”, ligji mungon. Pra, në çdo rast duhet ligji. Edhe në këtë rast, shkeljet e trajtuara nuk janë korrekte dhe nuk i përkasin rëndësisë, për më tepër nuk ekzistojnë fare si shkelje në trajtimin e vendimit.

Ju lutem shumë mbani parasysh si vërejtje faktin që zgjidhja që i kam dhënë çështjes si gjyqtar, nuk ka lidhje fare me shkakun për të cilin vendimi është cenuar dhe me asnjë nga rrethanat të cilat paraqiten në këtë procedim disiplinor.

Arsyen nuk e di. Mbetet në vlerësim të këtij Këshilli që të ezaurojë.

Megjithatë, lidhur me mediat do thosha vetëm një shprehje të Kryetarit të Tribunalit të Parisit i cili thotë: “Sot gjyqtarët kanë humbur një pjesë të mirë të frymës dhe të kredibilitetit të tyre në një opinion publik të nënshtruar, të shqetësuar dhe shpeshherë të çorientuar nga media. Në kulturën e viktimizimit mbizotëruese sot, çdo vendim i pafavorshëm i ngjan një vendimi të keq. Ai nxit tek palët ndonjëherë pakënaqësi dhe zhgënjim dhe tek gjyqtari sindromën e duarve që dridhen.

Jam nën akuzë në shkelje që kam vepruar me dashje. Nuk gjej asnjë element që të paktën qoftë edhe parimisht të kem vepruar me dashje. Normalisht, unë vendimin e kam dhënë me dashje dhe në rast se do ndodhem përsëri para të njëjtës situatë, në qoftë se ky Këshill i nderuar më mundëson vijimin e detyrës, unë përsëri do veproja në të njëjtat kushte.

Ndërkohë më tërheq vëmendjen, dhe po e mbyll, përcaktimet, mbështetja e opinionit publik në përcaktimin e integritetit tim gjyqësor apo të cenimit të besimit të drejtësisë tek publiku, vetëm në portalet. Ju lutem, kjo është - nuk arrij dot ta kuptoj dhe ta perceptim – për mua (pi i bie shkurt) kjo është gjenocid.

Ndërsa, përcaktimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në kuadër të masave të ndonjë rrezikut të shkaktuar nga shkelja disiplinore, në raport me faktet e provuara në

këtë hetim të procedimit disiplinor, rezulton se sjellja e papërshtatshme e magjistratit subjekt i hetimit disiplinor nuk është shtrirë vetëm tek magjistrati subjekt i hetimit disiplinor por ka krijuar terren për sjellje të papërshtatshme edhe në raste të tjera të ngjashme, standardet e gabuara të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë mund të aplikohen edhe nga magjistratët e tjerë si dhe njëkohësisht mund të shërbejë si praktikë edhe për shumë të dënuar të tjerë me rrezikshmëri shumë të lartë shoqërore...

Naureda Llagami: Ju lutem, tejkaloi koha.

{...}: E mbylla.

Kjo në këtë rast është inkuizicion.

ILD e pranon që vendimi ka argument. Vendimi në fakt nuk mund të shërbejë si praktikë gjyqësore dhe unë s'kam pse të kem asnjë përgjegjësi pse përdoret vendimi nga të tjerët.

Po ky është inkuizicion.

Edhe në përmbajtje të vendimit, megjithëse është shqyrtuar veprimtaria ime 3-vjeçare për lirimin me kusht nuk është gjetur asnjë shkelje, përveç kësaj që reklamohet. Është makth i çdo gjyqtari të Republikës së Shqipërisë t'i kontrollosh një vendimmarrje, jo 3 vjet, lirimin me kusht.

Unë kam arritur një standard të caktuar. E respektoj standardin. Nëse ky standard nuk është i aplikueshëm, nuk e vendos as ILD, as unë, as ky Këshill i nderuar, këtë e vendos Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë.

Duke dashur që të thosha shumë e shumë gjëra të tjera, por nuk mu dha mundësia, nga reagimi i Këshillit, po e mbyll fjalën dhe ju falënderoj për vëmendjen.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, do doja t'ia jepja fjalën Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëse ka ndonjë pyetje apo do vazhdojë t'i qëndrojë kërkesës dhe provat që ka administruar pranë Këshillit.

Artur Metani: Mbas 2 orësh raport, unë nuk gjeta asgjë të re që të më vërë në situatë të paqartë apo të diskutueshme për raportin që kam paraqitur, aq më tepër për provat. Doja të eidentoja gjatë fjalës së magjistratit që shpeshherë cedoï duke bërë edhe fyerje për moralin e inspektimit dhe intimidimin e inspektimit, por nuk ndërhyra sepse i kuptoj emocionet dhe ngarkesën në një situatë të tillë.

Përfundimisht i qëndroj raportit, provave dhe gjetjeve që kam në raport.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, ndonjë pyetje nga kolegët?

Brunilda Kadi: Kam unë një pyetje.

Dua ta shpreh këtë që nuk mund të lejoj që ju keni gjëra për të thënë dhe s'u lejuat që t'i thoni. Unë do kërkoja që t'ju jepeshe leja ta thoni atë që keni për të thënë dhe që vlerësoni ju të rëndësishme dhe tjetra, kjo që thatë, i keni me shkrim dhe ne do na vihen në dispozicion.

{...}: I kam bërë kopje, sipas rregullit.

Brunilda Kadi: Edhe ato gjëra që donit t'i thonit edhe nuk arritët dot t'i thonit.

{...}: Po! Atë që desha ta thosha e keni këtu.

Brunilda Kadi: Unë personalisht si anëtare jam dakord që t'ju jepet koha e plotë që t'i thoni të gjitha ato që doni t'i thoni, që të mos cenohet procesi i rregullt. Në qoftë se ju e vlerësoni vet që mund të ecnim sepse ato që doni të thoni i keni edhe me shkrim, atëherë kjo është zgjedhja juaj.

{...}: Natyrisht e nderuar anëtare, procesi i të folurit shoqërohet edhe me gjuhën e trupit. Megjithatë, përballë situatës në të cilën e shoh, ose më lejoni të vijoj, por shoh që Inspektori është lodhur, pasi më dëgjoi 2 orë.

Artur Metani: Ju lutem, me këto gjetje domethënë.

Ku e patë që Inspektori është lodhur?

Unë s'fola fare për këtë çështje. Kështu që vazhdoni me mbrojtjen tuaj.

Ju lutem Kryetare, se kjo është një situatë që nuk...

Naureda Llagami: Atëherë, ju pranuat që do i administroni pranë Këshillit të gjithë diskutimet që keni dhe parashtresën që bëtë. Prova të tjera...?

{...}: Unë e shikoj, Këshilli u lodh. Nuk mund të vijojë të më dëgjojë. Po i depozitoj me shkrim, në të kundërt vijoj.

Naureda Llagami: Atëherë, Këshilli nuk u lodh dhe gjithmonë ju tërhoqi vëmendjen që juve të shkurtonit dhe të fokusoheshit tek shkeljet e pretenduara dhe brenda objektit të procedimit tuaj. Kjo ishte kërkesa që ju bëri Këshilli. Nëse juve mendoni që ka të dhëna dhe ka fakte të cilat besoni që nuk janë të sqaruara, doni t'i sqaroni dhe t'i lexoni, kjo është një gjë tjetër. Në momentin që ju do e depozitoni këtë, Këshilli do jetë në dijeni të do elementi të parashtresës tuaj.

Brunilda Kadi: Dua të saktësoj unë dika Kryetare.

Atëherë, për t'u qartësuar, nuk ishte Këshilli që i tërhoqi vëmendjen, ishte Kryetari i Këshillit dhe njëri nga anëtarët ose disa, kështu që ju Kryetare, kur i tërhoqët vëmendjen dhe i kërkuat që të përqendroheshë dhe të përmblihdeshë, thatë mendimin tuaj, jo të Këshillit, se nuk e hodhët në diskutim tek Këshilli.

Unë e shpreha mendimin tim si anëtar, që në qoftë se gjyqtari kërkon më shumë kohë dhe do të shprehet, t'i jepet kjo mundësi. Nëse ai vet thotë që s'ka problem sepse unë i kam me shkrim, kjo është tjetër gjë.

Naureda Llagami: Sapo e konfirmoi që i ka me shkrim.

Brunilda Kadi: Besoj që gjyqtari ka atë aftësi që të përgjigjet vet.

{...}: Jo! –unë nuk konfirmoj që i kam me shkrim.

Thashë që është më e rëndësishme t'i them.

Dhe pikërisht këtë që u bë si vërejtje, thashë që në qoftë se është mendimi i Këshillit të ndaloj, e ndaloj. Në qoftë se nuk është i Këshillit...

Ilir Toska: Meqenëse zonja Kadi kishte qejf të të dëgjonte dhe komentoi se çfarë ne thamë pak më përpara, unë ju tërhoqa vëmendjen që të koncentronit të gjithë

mbrojtjen tuaj dhe të thonit gjërat kryesore dhe jo të filloni të lexoni shkresa apo Bold News apo portale apo ku di unë. Thashë, përqendrohu tek gjërat kryesore.

Ta përsërita kërkesën “përqendrohu tek gjërat kryesore që ju doni t’ia thoni këtij Këshilli dhe doni t’ia tërhiqni vëmendjen atij”. Detajet mund t’i lini me shkrim dhe ne do t’i lexojmë ato me shkrim. Kryesoret përpikuni që t’i thoni. Ju është mohuar kjo e drejtë që t’i thoni?

{...}: Po!

Ilir Toska: Atëherë, pse s’i thoni?

Ju lamë një herë 5 minuta. Thatë më lini 10.

{...}: Një marrëveshje dhe një lloj etike...

Ilir Toska: Po ju lutem, thojeni.

Unë nuk e kuptoj këtë gjë.

Erjon Muharremaj: Ju lutem, respektoni kolegun.

{...}: Kërkoj shumë ndjesë.

Unë vlerësoj ta ndërpres por duke thënë edhe diçka lidhur me paragrafin që sapo lexova të përdorimit të vendimit. Të mbahet parasysh nga ky Këshill i nderuar, që vendimi është përdorur edhe nga ana e Ministres së Drejtësisë, nën kontekstin e shkeljes disiplinore që përmban ajo. Faleminderit për dëgjuesën.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kërkesa të tjera kemi?

{...}: Më falni që po ju ndërpres. Po e depozitoj me shkrim.

Naureda Llagami: Atëherë, për vijimin e seancës, ftoj palët që të largohen.

Brikena Ukperaj: Kam edhe diçka.

Referuat që keni bërë disa kërkesa procedurale që në mbledhjen e kaluar ne thamë që do merren në shqyrtim pasi të dëgjojmë parashtrimet që do bëjë Inspektori, parashtrimet juaja.

Referuat në shpjegimet tuaja që keni paraqitur disa prova dhe i cituat edhe provat që kërkoni që të shqyrtohen nga Këshilli. Cilat janë këto prova, për të ecur proceduralisht dhe që të shprehemi lidhur me to. Sepse e drejta për të kërkuar prova është e juaja, vendimmarrja është e Këshillit. Këshilli nuk mund të marrë apriori vendim pa ju dëgjuar, për të pranuar një ose disa prova.

Dritan Hallunaj: Atëherë, më fal, nëse mund të ndërhyj në këtë moment Kryetare?

Më shkurt, i qëndroni kërkesës për provat që keni paraqitur? –se ky është momenti. Pavarësisht se relatuat pse nuk është thënë më përpara nga Komisioni apo nga Këshilli.

{...}: Po! – i qëndroj.

Dritan Hallunaj: I qëndroni kërkesave.

{...}: Po! –i qëndroj.

Brunilda Kadi: Edhe unë kisha diçka për të sqaruar gjyqtarin.

Në seancën e kaluar ju bëtë disa kërkesa dhe e para ishte që t’ju jepeshe kohë dhe nuk ka kuptim që të shqyrtoheshin kërkesat e tjera pa ju dhënë kohë. Tani, jemi të gjithë gjyqtarë dhe e dimë.

{...}: Mundem?

Brunilda Kadi: Dhe kjo është arsyeja pse u shty seanca e kaluar, që t’ju jepeshe kohë dhe pastaj mbas këtij momenti ju kishit të drejtë t’i thoshit kërkesat që në fillim ose edhe tani, kështu që nuk është ezauruar ai si proces. Thjesht seancën e kaluar ne pranuan kërkesën tuaj që të t’ju jepnim kohë. Se s’ka kuptim të shqyrtonim kërkesat e tjera pa ju dhënë kohë që ju të sillnit parashtrimin tuaj. Thjesht për të sqaruar dhe për të rikujtuar të gjithë se çfarë ndodhi seancën e kaluar.

Markelain {...}: Unë mbetem, i qëndroj provave. I shoh shumë të rëndësishme administrimin dhe shqyrtimin e tyre në mënyrën si i kam kërkuar, përfshirë edhe dëshmitarin.

Naureda Llagami: Dakord. Këshilli do ta vlerësojë, kështu që do tërhiqet Këshilli për të vlerësuar kërkesën tuaj për provat që keni kërkuar.

(Dalin nga salla e mbledhjes magistrati, z. {...} bashkë me avokaten znj. Marçela {...}, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani dhe Këshilltari pranë Kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Perian Teta. Vijohet diskutimi vetëm në prezencë të anëtarëve. Pas diskutimeve nga anëtarët, rihyjnë në sallën e mbledhjes palët.)

Naureda Llagami: Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në lidhje me kërkesat procedurale të parashtruara nga magistrati vendosi: I. Mospranimin e kërkesës për caktimin e përkthyesve për përkthimin e vendimeve të GJEDNJ-së të listuara, pasi qëndrimet e GJEDNJ-së përbëjnë jurisprudencë e cila është e njohur nga të gjitha organet që përbëjnë rendin e brendshëm juridik të një shteti palë të konventës, dhe për rrjedhojë mund të referohen në çdo rast nga palët por nuk përbëjnë provë në kuadër të procedimit.

II. Mospranimin e kërkesës për thirrjen në cilësinë e dëshmitares të shtetases znj. Etilda Gjonaj me detyrë Ministër i Drejtësisë, pasi thirrja e saj në cilësinë e dëshmitares është e panevojshme në lidhje me objektin e procedimit disiplinor.

III. Mospranimin e kërkesës për administrimin e plotë të dosjes së Komisionit të Mbrojtjes së Gjyqtarëve, pasi ky dokumentacion i kërkuar është i panevojshëm në lidhje me objektin e procedimit disiplinor.

Nga ana tjetër, Këshilli vendosi: Shtyrjen e seancës dëgjimore në datë 21 tetor 2020, ora 11:00, pasi konsideron të nevojshëm të njihet me parastresat me shkrim të magistratit të proceduar si dhe për të vendosur për vijueshmërinë e mëtejshme të procesit.

Me kaq seanca e sotshme është e mbyllur.

Faleminderit!

(Dalin nga salla e mbledhjes magistrati, z. {...} bashkë me avokaten znj. Marçela {...}, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani dhe Këshilltari pranë Kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Perian Teta.)

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

2.1 “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}”;

2.2 “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Shkodër”;

2.3 “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}”;

2.4 “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:32.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |

- | | |
|-----------------------------|------------------|
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 11. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:
 - 2.1 “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}”;
 - 2.2 “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Shkodër”;
 - 2.3 “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}”;
 - 2.4 “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Naureda Llagami: Atëherë, vijojmë me rendin e ditës.

Përpara se të vijojmë me rendin e ditës bëjmë 5 minuta pushim, për t’u rikthyer prapë në shqyrtimin e çështjeve që kemi sot.

Rifillon Mbledhja Plenare pas pushimit disa minutash.

Naureda Llagami: Fillojmë seancën. E kemi lënë tek çështja e dytë e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës: “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}” si dhe “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Shkodër”. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur një projektvendim “Për komandimin në skemën e delegimit të z. {...}”. Bashkëlidhur projektvendimit është edhe relacioni shpjegues.

Shkurtimisht mund t’ju them se më datë 08.10.2020, gjyqtari {...} ka paraqitur një kërkesë për shprehje interesi para Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke dhënë pëlqimin për të shërbyer në skemën e delegimit në çdo gjykatë të Republikës.

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtari {...} është diplomuar magjistrat në vitin 2012 dhe ka filluar detyrën me Dekretin nr. 7155, datë 10.11.2011, të Presidentit të Republikës, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Më pas, me Dekretin nr. 8467, datë 23.01.2014, të Presidentit të Republikës, ai është emëruar gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, ku vijon edhe sot.

Neni 45 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcakton rregullimin ligjor lidhur me organizimin dhe funksionimin e skemës së delegimit, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen nga magjistratët për t’u pranuar në këtë skemë si dhe detyrimin e Këshillit për të miratuar rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e magjistratëve si dhe kohën e shërbimit për skemën e delegimit. Referuar kësaj dispozite, Këshilli ka miratuar me vendimin nr. 22, datë 07.02.2019, Rregulloren për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit. Referuar pikës 4 parashikohet se:

“Në skemën e delegimit kandidon çdo gjyqtar që plotëson këto kriteret:

- a. Të ketë dhënë pëlqimin për t’u komanduar në skemën e delegimit;
- b. Të ketë jo më pak se 1 vit përvojë në funksion;

c. Të mos jetë nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të përfshirjes në skemën e delegimit;

d. Të mos ushtrojë funksionin e Kryetarit apo Zëvendëskryetarit;

e. Të mos jetë i caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi cenon funksionalitetin e saj;

f. Të mos jetë duke ushtruar funksionin e tij si gjyqtar në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim”.

Referuar këtyre kritereve është bërë verifikimi sa i përket gjyqtarit {...}, dhe rezulton se nuk përmban asnjë nga kriteret ndaluese dhe plotëson pozitivisht kriteret e tjera.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Pranimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...} dhe gjyqtari {...} të komandohet në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave. Përfundimin e gjyqtarit z. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Gjyqtari i skemës së delegimit, z. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, për të cilat ka përfunduar apo është në përfundim hetimi gjyqësor. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Keni ndonjë diskutim mbi projekt-aktin?

Ndryshe kalojmë në votim.

Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Propozimi tjetër që lidhet po me zotin {...} është për caktimin e tij në Gjykatën e Apelit Shkodër, tashmë si gjyqtar i skemës së delegimit.

Në kushtet kur propozimi i parë për komandimin në skemën e delegimit të z. {...} u miratua nga ana e Këshillit, propozimi vijues është që ai të caktohet në Gjykatën e Apelit Shkodër, referuar situatës që gjendet kjo gjykatë e cila aktualisht është me një numër të kufizuar gjyqtarësh, ku në detyrë janë vetëm 3 gjyqtarë, ndërsa organika e saj është 10 gjyqtarë, një numër ky i pamjaftueshëm duke mbajtur në konsideratë ngarkesën e çështjeve të regjistruara dhe në pritje për t'u gjykuar në këtë gjykatë, ndërkohë që ajo në vijimësi ka paraqitur nevojë, për një numër të lartë çështjesh, për caktim gjyqtarësh nga gjykatat e tjera të apelit sipas Vendimit të Këshillit nr.30/2019.

Në këto kushte kemi propozuar që gjyqtari skemës së delegimit z. {...} të caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për periudhën deri më datë 14.10.2021 (pra që është periudha 1-vjeçare që pranuan në skemën e delegimit).

Disponimi tjetër që kemi propozuar është që gjyqtari në skemën e delegimit z. {...} përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën e Apelit Shkodër, për periudhën deri më datë 30.10.2020 me qëllim për t'i dhënë mundësi për të përfunduar çështjet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, sikurse vendosëm në rastin e pranimit në skemën e delegimit. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit, ndërsa efektet financiare të përballohen nga Gjykata e Apelit Shkodër, mënyrë kjo që do të na jepte më pas për të plotësuar edhe vakancën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, ndërkohë që efektet financiare mund të përballohen nga Gjykata e Apelit Shkodër ndërsa ka dy pozicione të lira të përhershme. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kemi ndonjë diskutim lidhur me propozimin?

Nëse jo, kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimi e propozimit caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktet e radhës që ka të bëjë me komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z.{...} dhe caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Korçë. Sërish fjalën e ka zoti Toska.

Ilir Toska: Edhe z. {...} është në të njëjtën situatë si të zotit {...} që miratua pak më parë vendimin. Ai ka paraqitur më datë 9 tetor 2020 një kërkesë për shprehje interesi nëpërmjet të cilës ka dhënë pëlqimin për të shërbyer në skemën e delegimit. Zoti {...} ka filluar detyrën me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 7783, datë 10.10.2012 ku është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8375, datë 23.01.2014, ai është emëruar përfundimisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, pra ka mbi 8 vjet përvojë në profesion. Zoti {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Zoti {...} plotëson kriteret që kërkohen nga ligji të miratuara nga Këshilli sa i përket komandimit në skemë delegimi, ndërsa nuk është në asnjë prej kushteve ndaluese.

Në këto kushte Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit pranimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...}; Komandimin e gjyqtarit z. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave; Përrjashtimin e gjyqtarit z. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; Gjyqtari i skemës së delegimit, z. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në

Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, për të cilat ka përfunduar apo është në përfundim hetimi gjyqësor; Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Nëse s'kemi diskutime, atëherë kalojmë në votim të projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi Komandimin në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...}.

Kalojmë tek projekt-akti tjetër.

Ilir Toska: Projekt-akti tjetër ka të bëjë me caktimin e gjyqtarit tashmë të skemës së delegimit z. {...} në Gjykatën e Apelit Korçë. Propozojmë që të caktohet në Gjykatën e Apelit Korçë, në kushtet kur Gjykata e Apelit Korçë aktualisht ka vetëm 1 gjyqtar që është caktuar në mënyrë të përhershme, ndërsa pak më herët në muajin shtator, në datën 16, ne caktuam në Gjykatën e Apelit Korçë gjyqtaren {...}, të cilën po atë ditë e kemi caktuar në skemë delegimi. Aktualisht ka vetëm këta dy gjyqtarë Gjykata e Apelit Korçë, pra nuk formojnë dot një trup gjykues. Në këto kushte është emergjencë për të bërë funksionale qoftë me një trup gjykues, prandaj kemi propozuar që zoti {...} të caktohet për në Gjykatën e Apelit Korçë si gjyqtar i skemës së delegimit.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse s'kemi ndonjë diskutim, kalojmë në votim të projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Korçë, sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

- 3.1 “Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë”;
- 3.2 “Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë”;
- 3.3 “Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë”;
- 3.4 “Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:32.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

- 3.1 “Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë”;
- 3.2 “Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë”;
- 3.3 “Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë”;
- 3.4 “Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë”.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, për komandimin e katër magjistratëve si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë. Për më shumë detaje, fjalën ia jap sërish zotit Toska.

Ilir Toska: Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur 4 projektvendime përmes të cilave i propozohet Këshillit Komandimi i znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}, si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë. Afati i komandimit për të katër magjistratët është 3 vjet dhe fillon nga data 20 tetor 2020.

Komandimi ndërpritet në rastin e verifikimit të ndonjë prej kushteve ndaluese të komandimit dhe urdhërohet përjashtimi i menjëhershëm i të katër gjyqtareve nga procedurat e ndarjes me short të në gjykatat ku ato ushtrojnë aktualisht funksionin e gjyqtarit.

Për të katër projektvendimet është përgatitur një relacion ku është shtjelluar e gjithë procedura e ndjekur deri në këtë moment sa i përket komandimit të ndihmësmagjistrateve në Gjykatën e Lartë. Po ashtu, Këshilli me vendimin nr. 258, datë 23 korrik 2020 ka hapur procedurën e komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë. Brenda afatit kanë paraqitur kërkesë 8 magjistratë.

Këshilli me vendimet respektive të datës 24 shtator vendosi që vetëm 4 prej kandidatëve që kanë paraqitur kërkesë për t'u komanduar si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë, nuk cenojnë funksionalitetin e gjykatës, për t'ia përcjellë ndërkohë materialet që ato kishin depozituar Gjykatës së Lartë për të vlerësuar kriteret preferenciale që Gjykata e Lartë kishte konsideruar në momentin kur ka paraqitur kërkesë për komandim.

Gjykata e Lartë ka verifikuar edhe kriteret preferenciale, duke i kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor të komandojë katër magjistratet në Gjykatën e Lartë për një afat jo më të vogël se tre vjet.

Në kushte janë bërë edhe katër propozimet që ju përmenda pak më herët.

Naureda Llagami: Atëherë, kemi ndonjë diskutim mbi propozimet?

Nëse jo, atëherë t'i kalojmë një nga një?

Fillojmë me propozimin e parë për komandimin e zonjës {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë, jemi dakord sipas propozimit të bërë nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë, sipas propozimit të Komisionit.

Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me komandimin e zonjës {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë. Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord, me sqarimin që edhe pse kam votuar fillimisht kundër, derisa Këshilli vendosi me shumicë votash të komandohet, votoj pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë.

Kalojmë tek propozimi tjetër i Komisionit, për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord. Që mos të përsëritet. I njëjti arsyetim si edhe për magjistraten që sapo u votua.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë, sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë. Jemi dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë, sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

4.1 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”;

4.2 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”;

4.3 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”;

4.4 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:32.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)

- | | |
|-----------------------------|------------------|
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 11. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:
 - 4.1 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”;
 - 4.2 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”;
 - 4.3 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”;
 - 4.4 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

Naureda Llagami: Kalojmë më pas në shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura po nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës që kanë të bëjnë me rihapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për 4 pozicione të lira.

Ilir Toska: Faleminderit!

KZHK ka përgatitur 4 projektvendime për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në secilin rast, për një pozicion të lirë.

Ju sjell në kujtesë se fillimisht kemi hapur procedurat për ngritje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për 5 pozicione të lira në datën 26 shkurt 2020. Po në këto procedura ngritjeje në detyrë kandidoi vetëm një kandidat. Për këtë shkak ne kemi rihapur përsëri procedurat e ngritjes në detyrë. Më pas ka kandiduar vetëm një kandidat për një nga pozicionet e lira, shkak për të cilin ne kemi rihapur prapë procedurat e ngritjes në detyrë, përfshirë edhe vendin vakant që është krijuar më pas si rezultat e shkarkimit nga detyra të një prej gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Janë hapur procedurat në muajin korrik. Janë hapur përsëri procedurat në muajin shtator, por nuk ka pasur kandidatë. Në këto kushte, ndërsa vijojnë të ekzistojnë përsëri katër pozicione të lira pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si dhe nevoja imediate për plotësimin e tyre, Komisioni ka përgatitur përsëri katër projektvendime për rihapjen e procedurave në këtë gjykatë. Afati në këtë rast është përcaktuar deri në datë 30 tetor 2020. Është pak më tepër se 2 javë, ku i korrespondon fundit të javës data 30.

Ndërkohë përmbajtja është njësoj si në rastin e hapjes apo të rihapjes së procedurave në këtë gjykatë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit, nëse s’kemi diskutime, po e përmbledh “Për rihapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të

Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për katër pozicione të lira, me një afat kandidimi deri me datë 30.10.2020.

Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi rihapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për katër pozicione të lira, me afat kandidimi 30.10.2020.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2020)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

5.1 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”;

5.2 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:32.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:
- 5.1 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”;
- 5.2 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për dy pozicione të lira. Prapë fjalën ia jap zotit Toska.

Ilir Toska: Edhe sa i përket Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli në datë 26 shkurt 2020 ka hapur procedurat për ngritjen në detyrë për 5 pozicione të lira. Në këto procedura kanë kandiduar vetëm për 4 pozicione të lira, për të cilat Këshilli është në proces duke zhvilluar 4 procedurat. Për 1 procedurë nuk

pati kandidime. Ndërkohë më pas u hap edhe një vend tjetër i lirë në këtë gjykatë, si rezultat i shkarkimit të një prej gjyqtarëve të kësaj gjykate. Mbas kësaj, këshilli rihapi një procedurë dhe hapi një procedurë të re si rezultat i pasjes së dy pozicioneve të lira në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i ka rihapur këto më datë 27 maj; i ka rihapur përsëri për shkak se nuk pati kandidatë më datë 2 korrik; i ka rihapur përsëri edhe më datë 10 shtator 2020 për shkak të mospasjes të asnjë kandidature, por që jemi përsëri në të njëjtën situatë ku ekzistojnë dy pozicione të lira në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe nevoja për t'i plotësuar ato nëpërmjet ngritjes në detyrë të gjyqtarit, që është edhe shkak që kemi propozuar përsëri dy projektvendimet për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kemi ndonjë diskutim për këto dy projekt-aktet?

Nëse jo, kalojmë në votim të dy projekt-aktet që kanë të bëjnë me rihapjen e procedurave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për dy pozicione të lira.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi rihapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për dy pozicione të lira, me afat kandidimi 30.10.2020.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2020)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së mbarimit të statusit të magistratit, për z. {...}”.

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr. 5, datë 20.12.2018, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi caktimin me short të mandatit 3-vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtarë””.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:32.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Marçela Shehu (anëtare)

11. Erjon Muharremaj (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së mbarimit të statusit të magjistratit, për z. {...}”.
7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr. 5, datë 20.12.2018, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi caktimin me short të mandatit 3-vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtarë””.

Dy pikat e rendit të ditës janë shtyrë. Shih fillimin e procesverbalit të pikës së parë të rendit të ditës.

* * *

(Pika 6-7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.10.2020)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Opinion “Mbi kandidatin, që ka aplikuar për t’u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor” (kandidate {...}).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:32.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

8. Opinion “Mbi kandidatin, që ka aplikuar për t’u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor” (kandidate {...}).

Naureda Llagami: Kalojmë tek opinionin mbi kandidatin që ka aplikuar për t’u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, bëhet fjalë për kandidatin znj. {...}. Për më shumë detaje, fjalën sërish ia jap zotit Toska.

Ilir Toska: Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 400, datë 07.10.2020, ka shpallur kërkesën për kandidaturë nga radhët e gjyqtarëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, për një pozicion “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 5 (pesë) ditë nga e nesërmja e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Brenda afatit që ka përfunduar më datë 12.10.2020, është paraqitur vetëm një kërkesë.

Konkretisht, më datë 09.10.2020, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, nëpërmjet të cilës ka shfaqur interes për t’u komanduar në pozicionin e shpallur si “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve.

Duke qenë se Këshilli i Lartë Gjyqësor në rastin konkret, veç shpalljes së procedurës së komandimit është njëkohësisht dhe vetë institucioni që ka nevojë për gjyqtarin e komanduar, procedura e komandimit sipas Vendimit Nr.400, datë 07.10.2020, kalon në dy faza verifikimi:

Në fazën e parë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionet për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli vendos përjashtimin nga komandimi të kandidatit, komandimi i të cilit nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin apo kur për kandidatin verifikohet ndonjë prej kritereve të tjera ndaluese të komandimit.

Në fazën e dytë procedura e komandimit vijon me vlerësimin e kritereve preferenciale të kandidimit për të gjithë kandidatët që nuk janë përjashtuar nga kandidimi në fazën e parë. Ky vlerësim bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Vepimtarisë Profesionale, i cili kur çmon të nevojshme, mund të intervistojë kandidatin për verifikimin e kritereve të kandidimit.

Sa më sipër, në përgatitjen e këtij projekt-opinionit për kandidatin znj.{...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës verifikoi ekzistencën ose jo të ndonjë prej kritereve ndaluese, si dhe vlerësoi cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit të gjykatës ku kandidati ushtron detyrën e gjyqtarës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Kriteret apo kushtet e komandimit përcaktohen në nenin 53, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Po ashtu ato, krahas kritereve specifike, janë përcaktuar në pikën 4, të Kreut II, të Vendimit nr. 400, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Koncretisht, në këtë dispozitë parashikohet se: “Kriteret (Kushtet) e komandimit janë:

- a) Kandidati të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë si gjyqtar ;
- b) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;
- c) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;

- d) Kandidati të mos jetë i komanduar;
- e) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë:
 - i) të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;
 - ii) të mos ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës;
- f) Kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi”.

Në lidhje me kriteret/kushtet ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e gjyqtarit, rezulton se:

Kjo gjyqtare ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë prej datës 25.06.2010, pas emërimit me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 6622, datë 25.06.2010. Ajo ka një eksperiencë profesionale në punë mbi 5 vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar, nuk është dhe as ka qenë më parë e komanduar dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Në këto kushte, për këtë gjyqtare nuk ekziston asnjë kriter/kusht ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës ku kandidatja ushtron funksionin, nga informacioni i marrë më datë 13.10.2020, nëpërmjet postës elektronike, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe Opinioni i Kryetares së Gjykatës, rezulton se: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje ka në organikën e saj 5 gjyqtarë, të cilët janë efektivisht në detyrë. Këshilli i Lartë Gjyqësor është aktualisht në përfundim të procedurës së komandimit për gjyqtaren {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë.

Aktualisht ngarkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje është 470 çështje, ndërkohë që ngarkesa e gjyqtares {...} është 73 çështje.

Në opinionin e Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, sa i përket kandidimit të znj. {...}, ajo shprehet se në eventualitetin e komandimit nga Këshilli të dy gjyqtarëve të kësaj gjykate, si dhe ushtrimit nga ana e saj (Kryetares) edhe të detyrës së anëtares së Kolegjit Zgjedhor, në gjykatë mund të krijohet ngarkesë e lartë dhe, për pasojë, Këshilli do të duhej të merrte masa për plotësimin e trupës gjyqësore me qëllim vijimin e funksionimit normal të saj.

Vlen të përmendet se, Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të procedurave të verifikimit për kandidatët për magistratë, profili gjyqtar, të sapodiplomuar, në eventualitetin e krijimit të vendeve vakante pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, mbetet të ketë në vëmendje plotësimin e organikës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë me qëllim ruajtjen e funksionalitetit të saj.

Në rrethanat si më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se komandimi i znj. {...} në Njesisë së Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, përballë ngarkesës së çështjeve që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka aktualisht, sikundër edhe pritshmërisë pozitive për caktimin në këtë gjykatë të magistratëve të sapodiplomuar, nuk passjell cenim të interesave të larta të kësaj gjykate për sa kohë funksionaliteti i saj do të vijojë të ruhet.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor që të vendosë: Miratimin e opinionit për përfshirjen e kandidates znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në procedurat e komandimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kemi ndonjë diskutim, koment lidhur me opinionin e përgatitur nga Komisioni?

Nëse jo, atëherë kalojmë në votimin e opinionit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Miratimin e opinionit për përfshirjen e kandidatës znj.{...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në procedurat e komandimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas axhendës, kalojmë tek çështjet 9, 10 dhe 11, për të cilat ne i bëjmë me mbledhje të mbyllur. Kështu që unë do propozoja që të mbylлим regjistrimin.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor